- raporteve periodike për arkëtimin e të hyrave dhe prurjeve tjera dhe realizimin e shpenzimeve dhe daljeve tjera të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe buxhetete të komunave.

**II. PERSONI ZYRTAR PËR NDËRMJETËSIM ME INFORMATA****Personi zyrtar****Neni 8**

(1) Secili posedues i informatave për ndërmjetësim cakton një apo më shumë persona zyrtarë gjatë realizimit të të drejtës së qasjes së lirë te informatat.

(2) Poseduesit e informatave janë të detyruar të sigurojnë informimin e publikut për personin zyrtar për ndërmjetësim me informata.

(3) Personi zyrtar për ndërmjetësim me informata kontakton dhe i jep informatat e nevojshme dhe i ndihmon kërkuesit të informatave për çka mban evidence të veçantë për pranimin e kërkuesave për informata, ruajtjen dhe dhënien e informatave.

(4) Më shumë posedues të informatave munden së bashku të caktojnë një apo më shumë persona zyrtarë për ndërmjetësim gjatë realizimit të të drejtës së qasjes së lirë te informatat.

**III. DETYRIME TË POSEDUESVE TË INFORMATAVE****Listë e informatave****Neni 9**

Poseduesit e informatave janë të detyruar rregullisht të mbajnë dhe ta azhurnojnë listën e informatave me të cilat ato disponojnë dhe t'i publikojnë në mënyrë të arritshme për publikun (internet faqe, tabela e shpalljeve etj.).

**Ndërmjetësimi i informatave****Neni 10**

(1) Poseduesi i informatave është i detyruar ta njoftojë publikun nëpërmjet internet faqes së vet me publikimin e:

- të dhënavë nga kompetencat e veta të cilat i kryen, përkatësisht i janë përcaktuar me ligji,

- të dhënavë themelore për kontakt me poseduesin e informatës edhe atë: emrit, adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit, e-mail adresës dhe adresës së faqes së internetit,

- të dhënavë përfunkcionarin ose personin përgjegjës te poseduesi i informatës (biografi, të dhëna për kontakt etj.),

- të dhënavë themelore për kontakt me personin zyrtar për ndërmjetësim me informata, edhe atë: emri dhe mbiemri, e-mail adresë dhe numrit i telefonit,

- të dhënavë themelore për kontakt me personin e autorizuar për paraqitje të brendshme të mbrojtur, edhe atë: emrin dhe mbiemrin, e-mail adresën dhe numrin e telefonit,

- listës së personave të punësuar te poseduesi i informatës me pozitë, e-mailit zyrtar dhe telefonit zyrtar,

- ligjeve të cilat kanë të bëjnë me kompetencën e poseduesit të informatave, lidhur me regjistrin e rregullave të publikuara në gazetën zyrtare,

- rregullave që në kuadër të kompetencës së vet i miraton poseduesi i informatës në lloj të aktit nënligjor: rregullore për organizim të brendshëm, rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, rregullore

për paraqitje të brendshme të mbrojtur etj.), dekrete, urdhëresa, udhëzime, plane, programe, aktvendime dhe lloje tjera të akteve për realizimin e ligjeve dhe rregullave tjera, kur pët atë janë të autorizuar me ligj,

- organogramit për organizim të brendshëm,
- planeve strategjike dhe strategjive për punë të poseduesve të informatave,
- planeve vjetore dhe programeve për punë,
- Buxhetit vjetor dhe llogarisë përfundimtare,
- planeve vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programeve për realizimin e buxhetit,
- raportit të revizorit,
- llojeve të shërbimeve të cilat i japid poseduesit e informatave (informata për qasjen fizike për realizimin e shërbimeve dhe informatave për e-shërbimet, të dhënat për bazat ligjore, emrin e shërbimeve, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e secilit shërbim, mekanizmat për mbrojtje juridike dhe të dhëna tjera relevante),
- listave tarifore për kompensimet për lëshimin e akteve reale,

- mënyrën e parashtrimit të kérkesës për qasje te informatat (mënyra e parashtrimit e kérkesës me gojë dhe me shkrim për qasje te informatat, si dhe kérkesë e parashtruar në formë elektronike),

- dokumentacionit të plotë për prokurimet publike, për koncesionet dhe për marrëveshjet për partneritet privat-publik,

- propozim – programeve, programeve, qëndrimeve, mendimeve, studimeve dhe dokumenteve tjera të ngashme të cilat kanë të bëjnë me aktet nga kompetenca e poseduesit të informatave njoftimeve për publikun për punët e ndërmarrja nga internet faqja e tyre në pajtim me kompetencat ligjore, buletine informative, gazeta zyrtare nëse janë obligim në pajtim me ligj e të tjera,

- raporteve për punë të cilat i parashtrojnë te organet kompetente për zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes,

- të dhënavë statistikore për punën, si dhe informatave tjera, akteve dhe masave me të cilat ndikohet mbi jetën dhe punën e qytetarëve dhe të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatave dhe

- informatave tjera të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatës.

(2) Çdo posedues i informatave është i detyruar të mundësoj qasje falas te informatat nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 11

Personat përgjegjës te poseduesit e informatave për të siguruar qasje të lirë te informatat janë të detyruar që për kérkesës të sigurojnë lokale për vëzhgim në informatat e kérkuara, ndërsa personat zyrtarë për ndërmjetësim me informata janë të detyruar t'u ofrojnë ndihmë gjatë kérkimit të informatave në pajtim me këtë ligj dhe me ligj jetët.

#### IV. PROCEDURA PËR REALIZIMIN E TË DREJTËS SË QASJES SË LIRË TE INFORMATAT

##### Kérkesa me gojë ose me shkrim

###### Neni 12

(1) Kérkesi qasjen te informatata mund ta kérkojë me gojë, me shkrim ose me shkresë elektronike.

(2) Kérkesi është i detyruar në kérkesë të pranoncohet për mënyrën e komunikimit të mëtutjeshëm me poseduesin e informatës edhe atë me gojë, në formë të shkruar ose në formë elektronike.

(3) Çdo kérkues në bazë të kérkesës ka të drejtë për qasje te informatat nga poseduesi i informatave me të cilat disponon, edhe atë me këqyrje, kopje, fotokopje ose shkresë elektronike.

##### Kérkesa me gojë

###### Neni 13

(1) Nëse kérkuesi kérkon qasje te informata me kérkesë me gojë, poseduesi i informatës është i detyruar kérkuesit t'i mundësoj qasje te informata, në mënyrë me të cilën kérkuesi do të ketë kohë të mjaftueshme të njihet me përbajtjen e saj, me çka poseduesi i informatës përpilon procesverbal, përvèç nëse bëhet fjalë për informata nga neni 6 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Nëse poseduesi i informatës përgjigjet pozitivisht në kérkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej pesë ditësh nga dita e parashtrimit të kérkesës, mundëson njohje me përbajtjen e informatës së kérkuar në mënyrë që ia jep për këqyrje ose i siguron kopje, fotokopje ose shkressë elektronike nga informata e kérkuar.

(3) Nëse poseduesi i informatës përgjigjet në mënyrë negative për kérkesën, ose nuk mund t'i përgjigjet menjëherë kérkesës, si dhe nëse kérkuesi ka kundërshtim me gojë ose me shkrim për mënyrën e njohjes me informatën, personi zyrtar për ndërmjetësim me informata është i detyruar për kérkesën të përpilojë aktvendim në të cilin do të vendosë informata për kérkesin, datën e pranimit të kérkesës dhe ta njoftojë kérkuesin për kérkesën e veçantë, përkatesisht për informatën e kérkuar.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni, kérkuesi i informatës ka të drejtë për ankesë te Agjencia, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(5) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni procedura e mëtutjeshme me kérkesë me gojë vazhdon si kérkesë me shkrim në pajtim me këtë ligj.

##### Kérkesa me shkrim

###### Neni 14

(1) Për kérkesë me shkrim për qasje në informata vendos poseduesi i informatave në procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

(2) Për çështje të procedurës nga paragrafi (1) të këtij neni të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj, zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative.

##### Parashtrimi i kérkesës

###### Neni 15

(1) Kérkesën për qasje tek informatat e parashtron kérkuesi për poseduesin e informatat.

(2) Kérkesa nga paragrafi (1) i këtij neni e parashtruar në formë elektronike konsiderohet kérkesë me shkrim nga neni 14 i këtij ligji.

##### Përbajtja e kérkesës

###### Neni 16

(1) Formën e formularit të kérkesës për qasje tek informatat e përcakton drejtori i Agjencisë dhe poseduesi i informatës është i detyruar t'ia sigurojë formularin kérkuesit.

(2) Kérkesa ka të bëjë me formularin nga paragrafi (1) i këtij neni ose në formë tjetër dhe në mënyrë në pajtim me ninen 12 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Kérkesa përban emrin e poseduesit të informatës, emrin personal dhe mbiemrin e kérkuesit të informatës, të dhëna për procesverbalin e mundshëm ose personin e autorizuar, formën ose personin juridik.

(4) Në kérkesë kérkuesi është i detyruar ta theksojë informatën me të cilën do të njihet dhe në çfarë mënyre do të njihet me përbajtjen e informatës së kérkuar (këqyrje, përshkrim, fotokopje, shkresë elektronike).

(5) Кërкuesi nuk është i detyruar ta arsyetojë kërkesën, por është e nevojshme të theksojë se bëhet fjalë për kërkesë për qasje te informatat.

(6) Nëse sipas lëndës së kërkesës del se bëhet fjalë për kërkesë për qasje në informata në pajtim me këtë ligj, poseduesi i informatës detyrimisht e shqyrton kërkesën në pajtim me këtë ligj.

### Plotësimi i kërkesës

#### Neni 17

(1) Nëse kërkesa është e paplotësuar dhe për këtë shkak poseduesi i informatës nuk mund të veprojë, ai do të kërkoi nga kërkuesi i informatës ta plotësojë kërkesën, me sugjerim të pasojaqe nëse atë nuk e bën. Kërkuesi është i detyruar ta plotësojë kërkesën në afat prej tri ditësh nga dita e njofitimit për nevojn nga plotësimi i kërkesës, përkatësisht në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të njofitimit për nevojn nga plotësimi i kërkesës.

(2) Personi zyrtar i caktuar për ndërmjetësim me informata është i detyruar kërkuesit t'i jep ndihmë përkatëse gjatë plotësimit të kërkesës.

(3) Nëse kërkuesi nuk vepron në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, poseduesi i informatës me aktvendim do ta refuzojë kërkesën.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (3) i këtij neni kërkuesi ka të drejtë të ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Agjencinë.

(5) Nëse kërkesa edhe pas plotësimit nuk i plotëson kushtet nga neni 16 i këtij ligji dhe për shkak të asaj poseduesi i informatës nuk mund ta shqyrtojë kërkesën, poseduesi i informatës do të miratojë aktvendim me të cilin do ta hedhë poshtë kërkesën.

(6) Kundër aktvendimit për hedhje poshtë të kërkesës nga paragrafi 5 i këtij neni lejohet ankesë në Agjencinë afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

### Ridërgimi i kërkesës

#### Neni 18

(1) Nëse poseduesi i informatave që e ka pranuar kërkesën nuk posedon me informatat e kërkuara menjëherë, kurse më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, është i detyruar ta ridërgojë kërkesën te poseduesi i informatave i cili sipas përbajtjes së kërkesës është posedues i informatës dhe për atë të njoftojë kërkuesin.

(2) Afati përmarrje të informatës fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së kërkesës te poseduesi i informatës të cilit i është dërguar kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 19

Procedurën për kërkesën për qasje tek informatat te poseduesi i informatave e zbaton personi zyrtar nga neni 8 i këtij ligji.

### Veprimi për kërkesën

#### Neni 20

(1) Nëse poseduesi i informatave pozitivisht i përgjigjet kërkesës ose nëse kërkesën pjesërisht ose tërësisht e refuzon, për atë do të miratojë aktvendimin.

(2) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni, me të cilin kërkesa tërësisht ose plotësisht është refuzuar domosdoshmërisht përmban arsyetim për shkaqet për të cilat kërkesa është refuzuar dhe për rezultatet nga testi i realizuar i dëmtimit.

(3) Nëse poseduesi i informatës në afatin e përcaktuar në ninen 21 të këtij ligji nuk i mundëson kërkuesit qasje tek informata dhe nëse nuk miraton dhe nuk i dorëzon kërkuesit aktvendim konsiderohet se kërkesa është refuzuar me ç'rast kërkesi mund të parashtrojë ankesë te Agjencia në afat prej 15 ditësh.

### Neni 21

(1) Poseduesi i informatës është i detyruar menjëherë të përgjigjet pas kërkesës së kërkuesit, kurse më së voni në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Poseduesi i informatës, informatën e jep në formën e kërkuar, përvëç nëse informata e kërkuar tashmë ekziston në formë të paracaktuar paraprakisht dhe është në dispozicion për publikun dhe nëse është më e përshtatshme për kërkuesin informata të dorëzohet në formë më të ndryshme nga ajo e kërkuar, për të cilën poseduesi i informatës e arsyeton shkakun për mënyrën e tillë të dorëzimit.

### Vazhdimi i afatit për dorëzimin e informatës së kërkuar

#### Neni 22

(1) Në rast kur poseduesi i informatës duhet të mundësoj qasje të pjesshme te informata në pajtim me ninen 6 paragrafi (4) të këtij ligji ose për shkak të vëllimit të informatës së kërkuar i nevojitet kohë më e gjatë nga afati i përcaktuar në ninen 21 të këtij ligji, afati mund të vazhdohet më së shumti deri në 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

(2) Poseduesi i informatës për vazhdimin e afatit të paragrafit (1) të këtij neni është i detyruar në formë elektronike ta njoftojë kërkuesin menjëherë, kurse më së voni shtatë ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Nëse poseduesi i informatës nuk vepron në afatin e paragrafit (1) të këtij neni, kërkuesi i informatës mund të parashtrojë ankesë te Agjencia.

### Kërkesa të përgjigjura

#### Neni 23

Poseduesi i informatës është i detyruar ta njoftojë kërkuesin e informatës në lidhje me kërkesën për qasje tek informata nëse për kërkesën tashmë është përgjigjur pozitivisht me kërkesë të njëjtë ose të ngjashme të personit të njëjtë në afat prej tre muajve para ditës së pranimit të kërkesës.

### Dorëzimi i përgjigjes për informatën e kërkuar

#### Neni 24

(1) Nëse poseduesi i informatës i përgjigjet pozitivisht kërkesës, menjëherë i mundëson kërkuesit njohje me përbajtjen e informatës së kërkuar, edhe atë me këqyrje, përshkrim, fotokopje ose shkresë elektronike.

(2) Nëse kërkuesi kërkon t'i jepet informata në këqyrje, poseduesi i informatës është i detyruar t'i mundësojë kontroll në atë mënyrë që kërkuesi do të ketë kohë të mjaftueshme të nijhet me përbajtjen e saj.

(3) Nëse, si rezultat i informatës së marrë, del kërkesë për informatë plotësuese lidhur me dokumentet të cilat i posedon poseduesi i informatës, kërkuesi parashtron kërkesë të re, në pajtim me nenet 15 dhe 16 të këtij ligji, së bashku me përgjigjen që tashmë e ka marrë.

(4) Nëse kërkuesi konsideron se informata me të cilin është njohur nuk është informatë të cilën e ka parashtruar në kërkesë, mund të kërkojë nga poseduesi i informatës t'i mundësohet njohje me informatën që e ka theksuar në kërkesë më së voni në afat prej dhjetë ditësh pas pranimit të kërkesës së sérishme te poseduesi i informatës.

(5) Nëse poseduesi i informatës nuk i përgjigjet për kërkesën e sérishme kërkuesit të informatës, pas skadimit të afatit të përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni, kërkuesi i informatës mund të parashtrojë ankesë në Agjenci në afat prej 15 ditësh.

**Refuzimi****Neni 25**

Poseduesi i informatës me aktvendim mund tërësish ose pjesërisht ta refuzoj kërkesën, nëse konstaton se informata e kërkuar është informatë nga nen 6 paragrafi (1) të këtij ligji, duke pasur parasysh rezultatin nga testi i zbatuar për dëmshmérinë.

**E drejta e mbrojtjes juridike****Neni 26**

Të drejtë të mbrojtjes juridike në pajtim me këtë ligj ka kërkuersi i cili parashtron kërkesë për qasje te informata në pajtim me nenin 12 paragrin (1) të këtij ligji.

**Procedura për ankesë****Neni 27**

(1) Kundër aktvendimit me të cilin poseduesi i informatës e ka refuzuar ose e ka anuluar kërkesën, kërkuersi ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Agjencinë.

(2) Agjencia vendos për ankesën e kërkuersit në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(3) Nëse Agjencia në afatin nga paragafi (2) i këtij neni nuk miraton aktvendim pas ankesës së kërkuersit kundër aktvendimit të shkallës së parë, kurse nuk e miraton në afat prej shtatë ditësh pas kërkesës së sërishtme, kërkuersi mund të ngrejë kontest administrativ.

(4) Poseduesi i informatës është i detyruar ta zbatojë aktvendimin e Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij dhe për të njëjtën ta njoftojë Agjencinë.

**V. SHPENZIME PËR NDËRMJETËSIM TË INFORMATAVE****Neni 28**

(1) Këqyrja në informatën e kërkuar është falas.

(2) Kërkuersi i informatës për pëershkrimin e marrë, fotokopjen ose shkresën elektronike të informatës, paguan kompensim në lartësi të shpenzimeve materiale.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Ministrisë së Financave e përcakton lartësinë e kompensimit të shpenzimeve materiale për informatën e dhënë nga poseduesi i informatës.

(4) Poseduesi i informatës lartësinë e kompensimit nga paragafi (3) i

këtij neni e shpall në mënyrë përkatëse (në buletinin zyrtar të poseduesit të informatës, në faqen e internetit, tabelën e shpalljes dhe të njigashme) dhe ia jep në këqyrje çdo kërkuersi para parashtrimit të kërkesës.

(5) Nëse kërkesa ka të bëjë me informatë me vëllim më të madh, poseduesi i informatës mund të kërkojë kërkuersi ta japë paraprakisht kompensimin për mbulimin e shpenzimeve përmarrjen e informatës.

**VI. AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DREJTËS SË QASJES SË LIRË TE INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK****Statusi i Agjencisë****Neni 29**

(1) Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës së Qasjes së Lirë te Informatat me Karakter Publik është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur, i cili punon dhe miraton vendime në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj. (me të drejta, detyrime dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë ligj)

(2) Mjetet për punë të Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Selia e Agjencisë është në Shkup.

(3) Agjencia për punën e saj, për në vitin paraprak përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë te i cili parashtron për miratim raport vjetor më së voni deri më 31 mars në vitin rrjedhës.

(4) Agjencia e ka cilësinë e personit juridik.

**Kompetenca e Agjencisë****Neni 30**

Agjencia i kryen këto punë:

- mban procedurë administrative dhe vendos për ankesa kundër aktvendimit me të cilin poseduesi i informatës e ka refuzuar ose e ka hedhur poshtë kërkesën për qasje te informatas e kërkuesve,

- kujdeset për zbatimin e dispozitave të këtij ligji,

- përgatit dhe shpall listë të poseduesve të informatave,

- jep mendime për propozim-ligje me të cilët rregullohet qasja e lirë te informatat,

- zhvillon politika dhe jep drejtime në lidhje me realizimin e të drejtës së qasjes së lirë te informatat,

- mban procedurë kundërvajtëse përmes Komisionit Kundërvajtës i cili vendos për kundërvajtje në pajtim me ligj,

- merr aktivitetë në planin e edukimit të poseduesve të informatave për të drejtën e qasjes së lirë te informatat me të cilat ato disponojnë,

- bashkëpunon me poseduesit e informatave në lidhje me realizimin e të drejtës së qasjes te informatat;

- përgatit raport vjetor për punën e vet dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;

- kryen punë të bashkëpunimit ndërkombëtar të lidhura me realizimin e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrje në zbatimin e projekteve të organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunon me organet e vendeve të tjera dhe institucioneve nga sfera e qasjes së lirë te informatat me karakter publik,

- kryen promovim të së drejtës së qasjes së lirë te informatat me karakter publik dhe

- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe ligj tjetër.

**Udhëheqja me Agjencinë****Neni 31**

(1) Me Agjencinë udhëheq drejtori.

(2) Drejtori i Agjencisë ka zëvendës.

(3) Për punën e vet drejtori i Agjencisë dhe zëvendësi i tij përgjigjen para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

**Emërimi i drejtorit dhe i zëvendësit të tij****Neni 32**

(1) Drejtorin e Agjencisë dhe zëvendësin e tij i emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve për kohë prej gjashtë vjetësh, me të drejtë për një zgjedhje të sërishtme.

(2) Drejtori i Agjencisë dhe zëvendësi i tij emërohen në bazë të konkursit publik i cili shpallet në tri gazeta ditore të cilat botohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë përgatit propozim-listë të kandidatëve për drejtor të Agjencisë dhe zëvendësin e tij dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Drejtor i Agjencisë dhe zëvendës i tij emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) ёсhtë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) ka arsim të lartë me së paku 300 kredi të arritura sipas SETK-së ose shkallën VII/1 të arsimimit nga sfera e shkencave juridike;
- 3) ka së paku tetë vjet përvojë pune në sferën e informimit dhe shkencave juridike;
- 4) të mos ketë qenë ushtrues i funksionit në organ të partiё politike në dhjetë vitet e fundit;
- 5) me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ose sankcion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe
- 6) posedon një nga këto certifikata të njohura ndërkombëtarish ose vërtetetime për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
  - TOEFL IBT – së paku 74 pikë,
  - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
  - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku nivelin B2 (B2),
  - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
  - BULATS (BULATS) – së paku 60 pikë,
  - APTIS (APTIS) - së paku nivelin B2 (B2).

### **Ndërprerja e funksionit dhe shkarkimi i drejtorit dhe i zëvendësit të tij**

#### **Neni 33**

- (1) Drejtorit të Agjencisë, përkatësish të zëvendësit të tij i ndërprihet funksioni para skadimit të mandatit për të cilin janë emëruar:
- nëse përgjithmonë e humb aftësinë për ushtrim të funksionit, që e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë,
  - nëse paraqet dorëheqje,
  - me kërkesë personale,
  - për shkak të plotësimit të kushteve për pension të moshës të përcaktuara me ligj, me të drejtë të vazhdimit në pajtim me dispozitat përmarrëdhënies pune,
  - për shkak të vdekjes,
  - nëse me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës ose
  - nëse me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është dënuar me dënim me burg prej mbi gjashtë muaj.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni konstaton ndërprerje të funksionit.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e shkarkon drejtorin e Agjencisë, përkatësish zëvendësin e tij me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, nëse është plotësuar një nga këto kushte:

- nëse përcaktohet se nuk plotëson një nga kushtet e përcaktuara në nenin 32 paragrafin (3) të këtij ligji,
- nëse refuzon të parashtronë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesat në pajtim me ligjin ose të dhënët e përbajtura në deklaratë në pjesë të madhe janë të pavërteta,

- në mënyrë evidente i shkel rregullat për konflikt të interesave, përkatësish përashtim në situata në të cilat drejtori, përkatësish zëvendësi i tij, e ka ditur ose është dashur të dijë për ekzistimin e ndonjërs nga bazat e konfliktit të interesave, përkatësish përashtim të paraparë me ligj ose

- nëse pa shkaqe të arsyeshme nuk i respekton afatet përmarrjen e veprimeve të caktuara në pajtim me këtë ligj.

(4) Në rast të ndërprerjes së funksionit ose shkarkimin e drejtorit të Agjencisë, deri në zgjedhjen e drejtorit të ri të Agjencisë, funksionin e drejtorit të Agjencisë, e ushtron zëvendësrejtori, me të gjitha autorizimet të cilat i ka pasur drejtori.

(5) Në rast të shkarkimit, përkatësish pushimit të funksionit të drejtorit të Agjencisë, përkatësish zëvendësrejtorit, para skadimit të mandatit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më së voni në afat prej dhjetë ditësh fillon procedura për zgjedhje të drejtorit të ri të Agjencisë, përkatësish zëvendësrejtorit.

### **Kompetenca e drejtorit të Agjencisë**

#### **Neni 34**

##### **(1) Drejtori i Agjencisë:**

- e koordinon dhe organizon punën dhe udhëheq me punën e Agjencisë,
- e prezanton dhe e përfaqëson Agjencinë,
- ndërmerr veprimtarisë juridike në emër dhe për llogari të Agjencisë,
- përgjigjet për ligjshmëri në punën e Agjencisë,
- vendos për të drejtat dhe detyrimet e punës në Agjenci,
- miraton Udhëzim përmënyrë e zbatimit të këtij ligji,
- i miraton aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës të Agjencisë,
- miraton Plan vjetor për punësim,
- miraton planet financiare, planet strategjike dhe programin vjetor të punës së Agjencisë dhe organizon zbatimin e tyre,
- jep propozime përmjet e nevojshme për punën e Agjencisë gjatë përgatitjes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë,
- miraton akte që e rregullojnë mënyrën e punës dhe organizimin e Agjencisë,
- miraton akte të tjera për të cilat është i autorizuar,
- kujdeset përmjet e publicitetit e punës së Agjencisë dhe
- ndërmerr masa të tjera në kompetencë të Agjencisë, në përputhje me ligjin.

(2) Zëvendësrejtori e zëvendëson Drejtorin e Agjencisë, me të gjitha autorizimet dhe përgjegjësitë e tij në menaxhim, në rast të mungesës së tij ose kur për shkak të sëmundjes ose për arsyet të tjera nuk është në gjendje ta kryejë funksionin e tij.

(3) Zëvendësi në bashkëpunim me drejtorin e Agjencisë i kryen detyrat në kompetencë të Drejtorit që i njëjtë do t'ia besoje.

### **Të punësuarit në Agjenci**

#### **Neni 35**

(1) Të punësuarit në Agjenci, përveç personave ndihmës-teknikë kanë statusin e nëpunësve administrativë.

(2) Në Agjenci emërohet sekretari i përgjithshëm, që e emëron dhe e shkarkon drejtori i Agjencisë, në përputhje me Ligjin për nëpunësit administrativë.

### **VII. RAPORTI VJETOR**

#### **Neni 36**

(1) Personi zyrtar i posesuesit të informatave është i detyruar të përgatisë reportin vjetor për zbatimin e këtij ligji, t'a dorëzoi Agjencisë deri më 31 janar të vitit rrjedhës për vitin paraprak dhe ta publikojë atë në ueb faqen e posesuesit të informatave me karakter publik.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni përmban:

- të dhëna për personat zyrtarë të caktuar për ndërmjetësim me informatat te podesuesit e informatave,
- numrin e kërkesave të pranuara,
- numrin e kërkesave të përgjigjura pozitivisht,
- numrin e kërkesave të refuzuara dhe të anuluar me theksimin e arsyeve për çdo kërkesë të refuzuar ose të anuluar,
- numrin e kërkesave të papërgjigjura,

- numrin e ankesave të paraqitura kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendimet e poseduesve të informatave, me përshkrim të vendimit, si dhe përcaktimi i arsyeve për vendimin e marrë në rast të refuzimit të sërishtëm të informatës së kërkuar,

- numrin e ankesave të pranuara me vendim të Agjencisë,

- numrin e vendimeve të ridestinuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë,

- numrin e ankesave të refuzuara nga Agjencia dhe arsyet për refuzimin e tyre dhe

- numrin e ankesave të anuluara nga Agjencia dhe arsyet për anulimin e tyre.

(3) Agjencia përgatit raport të përbashkët për zbatimin e këtij ligji në bazë të të dhënave të marra nga raportet nga poseduesit e informatave dhe kompetencave të zbatuara dhe deri më 31 mars të vitit rrjedhës për vitin paraprak e dorëzon për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Raporti nga paragrafi (3) i këtij neni pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, do të publikohet në mjetet e informimit publik (buletin, faqe interneti).

### Neni 37

Lirohet nga përgjegjësia i punësuari te poseduesi i informatave i cili do të japë informatë të mbrojtur nëse është me rëndësi për zbulimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe sjelljes korruptive, si dhe për parandalimin e kërcenimeve serioze për shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe rrezikimin e mjesdit jetësor.

## VIII. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

### Neni 38

Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet funksionarit ose personit udhëheqës te poseduesi i informatave nëse nuk ka caktuar person zyrtar të caktuar për ndërmjetësim gjatë realizimit të të drejtës për qasje të lirë në informata dhe nuk ka ofruar informacion për publikun për personin zyrtar në përputhje me nenin 8 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

### Neni 39

Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet personit zyrtar te poseduesi i informatave nëse:

- vepron në kundërshtim në nenin 6 paragrafi (3) i këtij ligji,

- nuk e mban dhe përditëson rregullisht listën e informatave me të cilat disponon dhe nuk e publikon atë në mënyrë të përshtatshme, në dispozicion të kërkuesit, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji,

- nuk ofron ndihmë në kërkimin e informatave në pajtim me nenin 11 të këtij ligji,

- kërkon arsyetim nga kërkuesi i informatës në kundërshtim me nenin 16 paragrafi (5) të këtij ligji,

- në afatin e paraparë prej 20 ditësh, përkatesisht 30 ditësh, në mënyrë të pabazuar nuk mundëson qasje në informatë në përputhje me nenet 21 dhe 22 të këtij ligji,

- nuk mban evidencë në pajtim me nenet 8 paragrafi (3) dhe 36 paragrafi (2) të këtij ligji,

-arkëton qasje në informatën e kërkuar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi (3) të këtij ligji,

- nuk e zbaton aktvendimin e Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i tij në pajtim me nenin 27 paragrafin 4 të këtij ligji,

- nuk do të përgatisë raport vjetor për zbatimin e këtij ligji dhe nuk do ta dorëzojë në Agjenci në pajtim me nenin 36 të këtij ligji.

### Neni 40

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj procedurën për kundërvajtje udhëheq dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Komisioni i Kundërvajtjes në Agjenci.

(2) Anëtarët e Komisionit për Kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni janë të punësuar në Agjenci me shkallën dhe llojin e duhur të përgatitjes profesionale dhe përvojën e nevojshme të punës të përcaktuara me ligj, nga të cilat të paktën njëri nga anëtarët është jurist i diplomuar me provimin e jurisprudencës të dhënë.

(3) Para paraqitjes së kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje mbahet procedurë të barazmit me lëshimin e urdhërpagessës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(4) Personat zyrtarë janë të detyruar të mbajnë evidencë për urdhërpagessat e lëshuara për kundërvajtje dhe rezultatin e procedurave të ngritura.

(5) Në evidencën nga paragrafi (4) i këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatesisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimit ose vendqëndrimit, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagessës për kundërvajtje dhe rezultati i procedurës.

(6) Të dhënët nga paragrafi (4) i këtij neni mbahen për pesë vjet nga dita futjes në evidencë.

(7) Formën dhe përbajtjen e urdhërpagessës për kundërvajtje i përcakton Drejtori i Agjencisë.

## IX. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 41

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 60 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### Neni 42

Poseduesit e informatave do të caktojnë persona zyrtarë për ndërmjetësim me informatat nga nen 8 i këtij ligji në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

### Neni 43

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të shpallë konkurs publik për emërimin e drejtorit dhe zëvendëdrejtorit të Agjencisë.

(2) Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik pushon me punë me ditën e fillimit të punës së Agjencisë.

(3) Agjencia fillon me punë në ditën e emërit të drejtorit të Agjencisë.

(4) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, anëtarët ekzistues të Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik vazhdojnë të kryejnë funksionin deri në fillimin e punës së Agjencisë.

### Neni 44

(1) Të punësuarit nga Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdojnë të punojnë në Agjenci.

(2) Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, Agjencia i merr lëndët, arkivin, materialet, mjetet teknike, hapësinore dhe mjetet e tjera të punës të nevojshme për zbatimin e këtij ligji nga Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik.

(3) Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij Ligji do të përfundohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

## Neni 45

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji shfuqizohet Ligji pér qasje të lirë te informatat me karakter publik ("Gazeta Zyrta e Republikës së Maqedonisë" numër 13/2006, 86/2008, 6/10, 42/14, 148/15, 55/16 dhe 64/18).

## Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrta e Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**1262.**

Врз основа на членот 75, ставови 1, 2 и 3 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**УКАЗ****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА СУБВЕНЦИОНИРАЊЕ НА СТАНБЕН КРЕДИТ**

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за субвенционирање на станбен кредит, што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 16 мај 2019 година.

Бр. 08-2881/1  
16 мај 2019 година  
Скопје

Претседател на Република  
Северна Македонија,  
**Стево Пендаровски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Северна Македонија,  
м-р **Talat Xhaferi**, с.р.

**ЗАКОН  
ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ  
ЗА СУБВЕНЦИОНИРАЊЕ НА СТАНБЕН КРЕДИТ****Член 1**

Во Законот за субвенционирање на станбен кредит („Службен весник на Република Македонија“ број 158/11, 24/13, 43/14, 109/14 и 6/16), во членот 5 став (1) алинеја 3 се менува и гласи:

„- има во негова сопственост или во соопштвеност на брачниот другар, дел од стан/куќа или делови од повеќе станови/куќи кои се стекнати по основ на наследство или дар, а чија вкупна вредност не надминува 30.000 евра, во денарска противвредност пресметани по средниот курс на Народната банка на Република Македонија на денот на поднесувањето на барањето за субвенциониран станбен кредит;“.

Во алинејата 8 зборовите: „приход по основ на плата“ се заменуваат со зборовите: „вкупен приход“.

Во алинејата 9 зборовите: „приход по основ на плата“ се заменуваат со зборовите: „вкупен приход“, а сврзникот „и“ на крајот од алинејата се заменува со запирка.

Алинејата 10 се менува и гласи:

„-има дадено изјава заверена на нотар дека нема да ја издава, отуѓи и дополнително оптовари со хипотека станот/куќата купена или изградена со средства од субвенциониран станбен кредит од членот 9 став (1) алинеи 1, 2, 3 и 5 од овој закон во период од првите пет години од започнување со исплатата на кредитот, односно во период од првите 12 години од започнување со исплатата на кредитот во случајот од членот 9 став (1) алинеи 4 и 6 од овој закон, и“.

По алинејата 10 се додава нова алинеја 11, која гласи:

„-нема во негова сопственост, во соопштвеност или заедничка сопственост со брачниот другар или во соопштвеност, соопштвеност на брачниот другар недвижен имот кој вклучува: земјишта (земјоделски, градежни, шумски и пасишта), деловни згради и деловни простории, административни згради и административни простории, куќи и станови за одмор и рекреација, чија вкупна вредност е поголема од 30.000 евра во денарска противвредност пресметани по средниот курс на Народната банка на Република Македонија на денот на поднесувањето на барањето за субвенциониран станбен кредит. Во вкупната вредност не се засметува вредноста на градежното земјиште на кое барателот ќе гради со средства обезбедени со субвенциониран станбен кредит.“.

Во ставот (7) зборовите: „приходите по основ на плата“ се заменуваат со зборовите: „вкупните приходи“.

По ставот (8) се додава нов став (9), кој гласи:

„(9) Исполнувањето на условот од ставот (1) алинеи 3 и 10 на овој член, се потврдува од Решение за утврден данок на имот донесено од градоначалникот на општината, градоначалникот на општините во градот Скопје и градоначалникот на градот Скопје, не постар од една година или со проценка на вредноста на недвижниот имот од овластен проценувач каде е наведена вредноста на имотот.“.

**Член 2**

Во членот 6 став (3) зборот „нето“ се брише.

По ставот (3) се додаваат два нови става (4) и (5), кои гласат:

„(4) Субвенционирање на станбен кредит може да се користи за купување на нов стан, надградба/доградба на посебна станбена единица во рамки на постоечка куќа или изградба/купување на нова куќа чија корисна станбена површина не надминува 150 м<sup>2</sup>.

„(5) Субвенционирање на станбен кредит не може да се користи за купување на нов стан, изградба/купување на нова куќа или изградба на надградба/доградба на посебна станбена единица во рамки на постоечка куќа од физичко или правно лице инвеститор со чии основачи или сопственици, барателот или неговиот брачен другар е поврзано лице согласно со прописите со кои се уредува банкарското работење.“.

**Член 3**

Членот 9 се менува и гласи:

„(1) Кредитот што физичкото лице го зема од деловната банка се субвенционира со средства од Буџетот на Република Македонија, на начин што од буџетот на Министерството за финансии се плаќа:

- за купување на нов стан, 50% од месечниот ануитет во првите пет години од неговата отплата или 50% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит т.е. не повеќе од 6.250 евра во денарска противвредност,

- за физичко лице до и со наполнети 35 години возраст, односно физичко лице кое е во брачна заедница во која барем едниот брачен другар е на возраст до и со наполнети 35 години, за купување на нов стан, 70% од месечниот ануитет во првите пет години од неговата отплата или 70% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит т.е. не повеќе од 8.750 евра во денарска противвредност,

- за изградба/купување на нова куќа, 80% од месечниот ануитет во првите пет години од неговата отплата или 80% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит т.е. не повеќе од 10.000 евра во денарска противвредност,

- за физичко лице до и со наполнети 35 години возраст, односно физичко лице кое е во брачна заедница во која барем едниот брачен другар е на возраст до и со наполнети 35 години, за изградба/купување на нова куќа, 60% од месечниот ануитет во првите три години, 50% од месечниот ануитет во следните пет години и 40% во следните три години од неговата отплата или 100% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит, односно не повеќе од 12.500 евра во денарска противвредност,

- за изградба на надградба/доградба на посебна станбена единица во рамки на постоечка куќа, 75% од месечниот ануитет во првите пет години од неговата отплата или 75% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит т.е. не повеќе од 9.375 евра во денарска противвредност,

- за изградба на посебна станбена единица во рамки на постоечка куќа, 50% од месечниот ануитет во првите три години, 40% од месечниот ануитет во следните пет години и 30% во следните три години од неговата отплата или 100% од учеството кое не смее да надмине 25% од максималната субвенционирана вредност на станбениот кредит, односно не повеќе од 12.500 евра во денарска противвредност.

(2) Во случај кога две или повеќе лица аплицираат за добивање на субвенциониран станбен кредит за изградба/купување на поединечна станбена единица во рамки на една куќа во зависност од возраста на секој од барателите кои не се брачни другари се одобруваат субвенции согласно со ставот (1) алинеи 5 и 6 на овој член.

(3) Каматната стапка на кредитот од ставот (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 на овој член кај кој се субвенционира месечен ануитет, може да изнесува најмногу до 2,90% годишно во првите три години од отплатата на кредитот.

(4) Каматната стапка на кредитот од ставот (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 на овој член кај кој се субвенционира месечен ануитет, определена во ставот (3) на овој член по истекот на периодот од три години, во следните две години може да изнесува најмногу до 3,90% годишно.

(5) Каматната стапка на кредитот од ставот (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 на овој член кај кој се субвенционира учество во кредит, не може да е повисока од шестмесечен ЕУРИБОР + 4,0 процентни поени на годишно ниво, во текот на целото времетраење на отплатата на кредитот. Во случај кога шестмесечен ЕУРИБОР е негативен истиот не се засметува.

(6) Висината на каматната стапка од ставовите (3), (4) и (5) на овој член се утврдува во договорот од членот 8 став (4) од овој закон.

(7) Средствата за субвенциониран кредит од ставот (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 на овој член се неповратни во случај на редовна отплата на субвенционираниот кредит.

(8) Во случај на наплата на субвенционираниот кредит во постапка за присилна наплата, односно извршување, средствата за субвенциониран кредит од ставот (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 на овој член, доспеваат за наплатата заедно со субвенционираниот кредит и корисниците се должни да ги вратат веднаш на Министерството за финансии преку деловната банка.

(9) Во случај на предвремена доброволна отплата на субвенционираниот станбен кредит пред истекот на десеттата година од отплатата на кредитот, средствата за субвенциониран кредит од ставот (1) алинеи 1, 2, 3 и 5 на овој член, односно пред истекот на дванаесеттата година од отплатата на кредитот, средствата за субвенциониран кредит од ставот (1) алинеи 4 и 6 на овој член, достасуваат за наплатата заедно со субвенционираниот станбен кредит и корисниците се должни да ги вратат веднаш на Министерството за финансии преку деловната банка.

(10) По исклучок од ставот (7) на овој член, во случај на предвремена доброволна отплата на субвенционираниот станбен кредит по истекот на десеттата година од отплатата на кредитот во случаите од ставот (1) алинеи 1, 2, 3 и 5 на овој член, односно по истекот на дванаесеттата година од отплатата на кредитот во случајот од ставот (1) алинеи 4 и 6 на овој член, средства за субвенциониран кредит се неповратни и корисниците не ги враќаат на Министерството за финансии преку деловната банка.

(11) По истекот на петтата година од отплатата на кредитот во случаите од ставот (1) алинеи 1, 2, 3 и 5 на овој член, односно по истекот на единасеттата година од отплатата на кредитот во случајот од ставот (1) алинеи 4 и 6 на овој член, корисникот на субвенциониран станбен кредит има право да изврши еднократна делумна отплата со сопствени средства, но не повеќе од 20% од преостанатата главница од кредитот.

(12) Доколку во период од десет години од добивањето на субвенција од ставот (1) на овој член, семејството на корисникот на субвенциониран станбен кредит се зголеми со раѓање на живородено дете или со посвојување на дете, има право на продолжување на периодот на субвенционирање во случајот кога се субвенционира дел од месечниот ануитет во период од една година во висина од 30% од месечниот ануитет за секое дете, односно кога се субвенционира дел од учеството има право на едногодишна субвенција во висина од 30% од месечниот ануитет за секое дете.“.

#### Член 4

Во член 10 ставовите (9), (10), (11), (12) и (13) се менуваат и гласат:

„(9) Деловната банка е должна одлуката за пред одобрување на барањето и образецот за потврда на исполнетост на условите од членот 5 од овој закон да ги достави до Комисијата за евалуација на барања за субвенционирани станбени кредити формирана од министерот за финансии (во натамошниот текст: Комисија за евалуација), во рок од три дена од денот на донесувањето на одлуката од ставот (6) на овој член.

(10) Комисијата за евалуација спроведува постапка за избор на корисници за субвенциониран станбен кредит преку електронски систем за избор најмалку еднаш во период од 35 дена за сите добиени одлуки за пред одобрување на субвенционирани станбени кредит доставени најмалку еден ден пред денот на спроведувањето на постапката за избор.

(11) Критериуми за избор на корисниците на кредитите се висината на вкупните приходи на барателот, односно вкупните приходи на барателот и неговиот брачен другар и висината на бараниот кредит, при што предност имаат барателите со пониски приходи и барањата на помал износ на кредит.

(12) Врз основа на резултатите од електронскиот систем за избор на корисници на субвенциониран станбен кредит, Комисијата за евалуација одлучува за одобрување на субвенција, го определува видот на субвенцијата, износот кој се субвенционира и динамиката на неговата исплата.

(13) Начинот и постапувањето за избор на корисници на субвенциониран станбен кредит ги пропишува министерот за финансии, а Комисијата за евалуација за начинот на својата работа донесува Деловник за работа.“.

По ставот (13) се даваат три нови става (14), (15) и (16), кои гласат:

„(14) Комисијата за евалуација од ставот (9) на овој член се состои од 13 члена од кои десет од Министерството за финансии и по еден од Министерството за транспорт и врски, Управата за јавни приходи и Агенцијата за катастар на недвижности.

(15) За вршење на административно-технички работи на Комисијата, министерот за финансии определува лице од вработените на Министерството за финансии.

(16) На претседателот и членовите на Комисијата им следува надоместок кој го определува министерот за финансии со посебен акт.“.

#### Член 5

Во членот 11 став (2) алинеите 1 и 2 се менуваат и гласат:

„- за случаите каде се субвенционира месечниот ануитет согласно со членот 9 став (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 и ставот (12) од овој закон годишно однапред, по доставена документација од деловните банки за склучен договор за субвенционирање на станбен кредит,

- за случаите каде се субвенционира учеството согласно со членот 9 став (1) алинеи 1, 2, 3, 4, 5 и 6 од овој закон по доставена документација од деловните банки за склучен договор за субвенционирање на станбен кредит.“.

#### Член 6

Во членот 13 став (1) алинејата 5 се менува и гласи:

„- забрана за корисникот на кредитот да го отуѓи станаг/куќата купена или изградена со средства од субвенциониран станбен кредит од членот 9 став (1) алинеи 1, 2, 3 и 5 од овој закон во период од првите пет години од започнување со исплата на кредитот, односно во период од првите 12 години од започнување со исплата на кредитот во случај од членот 9 став (1) алинеи 4 и 6 од овој закон.“.

#### Член 7

Одредбите од членот 2 од Законот за изменување на Законот за субвенционирање на станбен кредит („Службен весник на Република Македонија“ број 109/14), нема да се применуваат за субвенционираните станбени кредити кои ќе се одобруваат согласно со овој закон.

#### Член 8

Постапките по барањата за добивање на субвенциониран станбен кредит поднесени до деловните банки до денот на влегувањето во сила на овој закон, за кои одлуките за пред одобрување на барањето од деловните банки и образецот за потврда на исполнетост на условите ќе пристигнат во Министерството за финансии во рок од 45 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон, ќе се завршат согласно со одредбите од законот по кој се започнати.

#### Член 9

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

## L I GJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SUBVENCIONIMIN E KREDISË BANESORE

### Neni 1

Në Ligjin për subvencionimin e kredisë banesore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 158/11, 24/13, 43/14, 109/14 dhe 06/16) në nenin 5 paragrafi (1) alineja 3 ndryshohet si vijon:

“- ka në bashkëpronësi të tij ose në bashkëpronësi të bashkëshortit, pjesë tē banesës / shtëpisë ose pjesëve tē më tepër banesave / shtëpive që janë marrë në bazë tē trashëgimisë ose dhuratës, vlera e përgjithshme e së cilës nuk tejkalon 30.000 euro, në kundërvlerë me denarë tē llogaritur sipas kursit tē mesëm tē Bankës Popullore tē Republikës së Maqedonisë në ditën e parashtrimit tē kërkesës për kreditin e subvencionuar banesore.“.

Në alinenë 8 fjalët: “të ardhurat në bazë tē rrogës” ndryshohen me fjalët: “të ardhurat e përgjithshme”.

Në alinenë 9 fjalët: “të ardhurat në bazë tē rrogës” ndryshohen me fjalët: “të ardhurat e përgjithshme”, ndërsa shkronja “dhe” në fund tē alinesë zëvendësohet me presje.

Alineja 10 ndryshohet si vijon:

(3) Subjektet nga paragrafi (2) i këtij neni, e kanë për obligim të ndërmarrin masa ose veprime për promovimin dhe avancimin e barazisë dhe parandalimit nga diskriminimi.

(4) Të gjitha subjektet të cilat me ligj janë të detyruara të grumbullojnë, evidentojnë dhe përpunojnë të dhëna, e kanë për obligim që këto të dhëna t'i paraqesin sipas bazave diskriminuese nga neni 5 i këtij ligji, relevante në sferën, e me qëllim të promovimit dhe avancimit të barazisë dhe parandalimit nga diskriminimi.

#### Neni 4 Lista e nocioneve

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin në vijim:

1. Barazi eshtë parimi sipas të cilit të gjithë njerëzit janë të barabartë, përkatësisht të barazuar në gjëzimin dhe realizimin e të gjithë të drejtave dhe lirive;

2. Person eshtë secili person fizik ose juridik;

3. Person me pengesë eshtë personi i cili ka pamundësi afatgjate fizike, intelektuale, mentale ose senzore, që në interaksion me barrierat e ndryshme shoqërore mund ta pengojë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqërinë në bazë të barabartë me të tjerët;

4. Përshtatje përkatëse eshtë ndryshimi dhe përshtatja e domosdoshme dhe përkatëse e nevojshme në rast të caktuar, që nuk shkakton ngarkesë joproporcionale ose të panevojshme, e me qëllim të sigurimit të gjëzimit ose realizimit të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive të personave me pengesë, në bazë të barabartë me të tjerët. Pamundësimi i përshtatjes përkatëse eshtë diskriminimi;

5. Qasja te infrastruktura, të mirat dhe shërbimet nënkuption ndërmarrjen e masave përkatëse që sigurojnë se personat me pengesë kanë qasje, në bazë të barabartë me të tjerët, te rrathi fizik, transporti, informatat dhe komunikimi, duke përfshirë teknologji informatike dhe komunikuese dhe sisteme, te objektet tjera publike dhe shërbimet në zonat urbane dhe rurale. Pamundësimi i qasjes dhe arritshmërisë në infrastrukturë, të mira dhe shërbime eshtë diskriminimi;

6. Grup i marginilizuar eshtë grup individësh të cilët i bashkon pozita specifike në shoqëri, që janë objekt i paragjykimeve, që kanë karakteristika të veçanta që i bëjnë që t'i ekspozohen diskriminit dhe/ose dhunës dhe mundësii më të vogël për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive;

7. Qëllimi i arsyetuar legjitim dhe objektiv eshtë qëllimi për realizimin e të cilët mjetet duhet të përpushten me nevojat reale në rast konkret, që janë të definuara saktësisht paraprakisht, të janë të domosdoshme për realizimin e atij qëllimi, si dhe të janë proporcionale me efektit që duhet të arrihen;

8. Diskriminim sipas asociacionit eshtë çdo dallim, përjashtim ose kufizim i një personi për shkak të lidhjes me person ose grup tjeter në cilëndo bazë diskriminuese;

9. Diskriminim sipas perceptimit eshtë çdo dallim, përjashtim ose kufizim i një personi për shkak të përkatësisë së supozuar ndaj grupit të caktuar në cilëndo bazë diskriminuese;

10. Diskriminim i shumëfishtë eshtë diskriminimi i kryer ndaj një personi ose grupi në më shumë baza diskriminuese;

11. Diskriminim i përsëritur eshtë diskriminimi i kryer ndaj një personi ose grupi më shumë herë, në baza të njëjtë diskriminuese;

12. Diskriminim i vazhduar eshtë diskriminimi që eshtë kryer mbi një person ose grup pa ndërpërje, në periudhë më të gjatë kohore, në baza diskriminuese;

13. Diskriminim interseksional eshtë secili diskriminim në dy ose më shumë baza diskriminuese që janë të lidhura njëkohësisht dhe në mënyrë të pandashme;

14. Testim i situatës paraqet metodë për dëshmimin e diskriminimit nepërmjet inkluadimit të testerëve të organizuar që vihen në situatë krahasimtare që të hulumtohet paraqitura e diskriminimit në lëndë, procese dhe sfera të ndryshme në cilëndo bazë diskriminuese.

#### Neni 5 Baza diskriminuese

Ndalohet çdo diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, originës, përkatësisë nationale ose etnike, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginilizuar, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, arsimit, religjonit ose bindjes fetare, bindjes politike, bindjes tjetër, pengesës, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqërorë ose në cilëndo bazë tjetër (në tekstin e mëtutjeshëm: bazë diskriminuese).

#### Neni 6 Përkufizimi i diskriminimit

Diskriminim eshtë çdo dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie e përparësisë që bazohet në bazë diskriminuese, me bërje ose mosbërtje, që kanë për qëllim ose rezultat parandalimin, kufizimin, pranimin, gjëzimin ose realizimin e të drejtave dhe lirive të personit ose grupit të caktuar në bazë të barabartë me tjerë. Kjo i përfshin të gjitha format e diskriminimit duke përfshirë edhe pamundësimin e përshtatjes adekuate dhe pamundësimin e qasjes dhe arritshmërisë së infrastrukturës, të mirave dhe shërbimeve.

#### Neni 7 Masa dhe veprime që nuk paraqesin diskriminim

(1) Nuk do të konsiderohen si diskriminim masat dhe veprimet që merren me një qëllim të vetëm të mënjanohet gjëzimi i pabarabartë i të drejtave dhe lirive të njeriut derisa nuk arritet barazia faktike e personit apo grupit, nëse dallimi eshtë i arsyeshëm dhe objektiv, ndërsa mjetet për arritjen e atij qëllimi janë proporcionale, përkatësisht adekuate dhe të domosdoshme.

(2) Masat dhe veprimet nga paragrafi (1) i këtij neni janë të kufizuara në kohë dhe zbatohen deri në arritjen e barazisë faktike të personave ose grupit gjatë gjëzimit të të drejtave të tyre.

(3) Nuk do të konsiderohet si diskriminim:

1) Trajtimi i ndryshëm i personave të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa të cilët në mënyrë të drejtëpërdrejtë dalin nga shtetësia e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2) Trajtimi i ndryshëm i personave në ndonjë nga bazat diskriminuese për shkak të natyrës së profesionit ose aktivitetit ose për shkak të kushteve në të cilat zhvillohet ai profesioni, ndërsa që paraqet kërkësë esenciale dhe vendimmarrëse, qëllimi eshtë legitim, ndërsa kushti nuk e tekalon nivelin e nevojshëm për realizimin e tij;

## II. FORMAT DHE LLOJET E DISKRIMINIMIT

Neni 8

### Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë

(1) Diskriminimi i drejtpërdrejtë ekziston kur me një person ose me grup veprohet, është vepruar ose do të veprohej në mënyrë më të pavolitshme në lidhje me një person ose grup tjetër në situatë faktike ose të mundshme krahasuese ose të ngjashme, në bazë diskriminuese.

(2) Diskriminim i tërthortë ekziston kur ndonjë person ose grup vihet në pozitë më të pavolitshme në krahasim me persona tjerë ose grup personash, nëpërmjet gjoja rregullave neutrale, dispozitive, kriterive, programeve ose praktikave, përvç kur dalin nga qëllimi legitim, ndërsa mjetet për arritjen e atij qëllimi janë proporcionale, përkatësisht janë adekuate dhe të domosdoshme.

Neni 9

### Thirrja, nxitja dhe instruksioni për diskriminim

Thirrje, nxitje dhe instruksion për diskriminim është secili aktivitet me të cilin në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë thirret, inkurajohet, jep udhëzime ose nxit që të kryhet diskriminim në bazë diskriminuese.

Neni 10  
Shqetësimi

(1) Shqetësimi paraqet veprim të padëshiruar ndaj personit ose grupit të personave ndaj bazave diskriminuese që ka për qëllim ose pasojë, shkeljen e dinjitetit ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, nënëmues ose të frikshëm, qasjes ose praktikës.

(2) Shqetësimi seksual është çfarëdo forme e veprimit të padëshiruar verbal, jovertical ose fizik të natyrës seksuale, që ka për qëllim ose pasojë, shkeljen e dinjitetit ose krijimin e mjedisit kërcënues, armiqësor, nënëmues ose të frikshëm, qasjes ose praktikës.

Neni 11  
Viktinizimi

Viktinizimi paraqet vuajtje të pasojave të dëmshme nga ana e personit për shkak të marrjes së veprimeve për mbrojtje nga diskriminimi, përkatësisht ka paraqitur diskriminimi, ka filluar procedurë për mbrojtje nga diskriminimi, ka dëshmuar gjatë procedurës ose në mënyrë tjetër ka marrë pjesë në procedurë për mbrojtje nga diskriminimi.

Neni 12  
Segregacioni

Segregacion është ndarje fizike e personit ose grupit të personave në bazë diskriminuese pa qëllim të arsyetueshëm legitim ose objektiv.

Neni 13  
Forma më të rëndë të diskriminimit

Si formë më e rëndë e diskriminimit, në kuptim të këtij ligji, llogaritet diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi interseksional, diskriminimi i përsëritur dhe diskriminimi i vazhduar.

## III. KOMISIONI PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

Neni 14  
Subjektiviteti juridik i Komisionit

(1) Komisioni për Parandalim dhe Mbrotje nga Diskriminimi është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i cili punon në pajtim me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj (në tekstin e mëtejmë: Komisioni).

- (2) Komisioni ka cilësi të personit juridik.
- (3) Selia e Komisionit është në Shkup.

Neni 15  
Buxheti i Komisionit

(1) Mjetet për punë të Komisionit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë dhe mjetet për astësim përkatës për personat me pengesa.

(2) Mjetet për punë të Komisionit i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Komisionit.

(3) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut veçmas e voton ndarjen e dedikuar për Komisionin në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Me shfrytëzimin, shpërndarjen dhe dedikimin e mjeteve për punë të siguruara në ndarjen e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuar për Komisionin, Komisioni disponon në mënyrë të pavarur.

(5) Komisioni mund të sigurojë mjete edhe nga burime të tjera siç janë donacionet, grantet dhe të tjera.

Neni 16  
Përbërja e Komisionit

(1) Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Anëtarët e Komisionit zgjidhen me mandat prej pesë vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes.

(3) Gjatë zgjedhjes së përbërjes së parë të Komisionit katër anëtarë zgjidhen me mandat prej pesë vjetësh, kurse tre anëtarë me mandat prej tre vjetësh, me të drejtë të rizgjedhjes.

(4) Nga radhët e anëtarëve të zgjedhur në paragrafin (2) të këtij nenit, Komisioni zgjedh kryetar me mandat prej një viti, pa të drejtë të rizgjedhjes.

(5) Anëtarët e Komisionit duhet ta pasqyrojnë përbërjen e shoqërisë në tërësi dhe gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit zbatohen parimet përfaqësimi adekuat të të gjitha grupeve shoqërore, parimin e përfaqësimi adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive dhe pjesëmarrjen gjinore të balancuar.

Neni 17  
Kushtet për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit

Anëtar i Komisionit mund të zgjidhet personi i cili i plotëson këto kushte:

1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

2) të ketë marrë 240 kredi sipas sistemit SETK ose shkallë VII/1 të arsimit dhe ka minimum shtatë vjet përvjoje pune nga sfera e të drejtave të njeriut nga të cilat pesë vjet në sferën e barazisë dhe mosdiskriminimit;

3) në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim me burg mbi gjashtë muaj ose ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

4) të mos jetë bartës i funksionit në parti politike.

Neni 18

**Procedura pér zgjedhje të anëtarëve të Komisionit**

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik pér zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit në së paku dy gazeta ditore që botohen në tèrë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra prej gazetave që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase. Konkursi detyrimisht publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", dhe në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e internetit të Komisionit në të gjitha gjuhët e bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Konkursi nga paragrafi (1) i këtij neni, zgjat 30 ditë nga dita e shpalljes së tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Komisioni pér Çështje të Zgjedhjeve dhe Emëri me i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përcakton propozim-listë të kandidatëve të paraqitur, pas debatit publik të kryer paraprakisht, dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shtojcë me materialin nga të gjitha kërkesat e dorëzuar dhe raport nga debati publik i kryer.

Neni 19

**Statusi i anëtarëve të Komisionit**

(1) Anëtarët e Komisionit kanë status të personave të emëruar që funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale dhe ajo është e papërpunshme me ushtrimin e funksionit jetër publik, profesionit apo funksionit në parti politike. Anëtarit të Komisionit i pushon funksionin publik. Nëse anëtarit i Komisionit para emërimit ka qenë në marrëdhënie pune, marrëdhënia e punës i pezullohet.

(2) Anëtarit të Komisionit të cilit i ka kaluar mandati do ta ushtrojë funksionin deri në emërimin e anëtarit të ri, por jo më gjatë se tre muaj.

(3) Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë të rrogës dhe kompensime të tjera në pajtim me Ligjin pér rroga dhe kompensime të tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar.

Neni 20

**Shkarkimi dhe pushimi i funksionit të anëtarit të Komisionit**

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut e shkarkon anëtarin e Komisionit para pushimit të mandatit ne propozim të Komisionit pér Çështje të Zgjedhjeve dhe Emëri me, nëse:

1) me vendim të plotfuqishëm i është shqiptuar ndalim pér ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

2) me vendim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar me dënim me burg mbi gjashtë muaj;

3) përgjithmonë e ka humbur aftësinë psikofizike pér ushtrim të funksionit në pajtim me Ligjin dhe

4) në mënyrë jo profesionale, të njëjanshme dhe të pandërgjegjshme e ushtron funksionin.

(2) Anëtarit të Komisionit i pushon mandati:

1) nëse vetë e kërkon atë;

2) pér shkak të vdekjes;

3) me plotësimin e kushteve pér pension të pleqërisë.

(3) Përbushjen e kushteve pér shkarkim nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton Komisioni pér Çështje të Zgjedhjeve dhe Emëri me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve pas debatit publik të zhvilluar paraprakisht dhe paraqet iniciativë pér shkarkimin e anëtarit të Komisionit pér Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimit të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shtojcë me reportin nga debati publik i zhvilluar.

(4) Kur anëtar i Komisionit shkarkohet ose i pushon funksioni në pajtim me dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs pér emërimin e anëtarit të Komisionit me mandat në kohëzgjatje deri në përfundimin e mandatit të anëtarit i cili ndryshohet.

**Neni 21  
Kompetencat e Komisionit**

(1) Kompetencat e Komisionit:

1) ndërmerr aktivitete pér promovim, mbrojtje dhe preventivë pér barazi, të drejtat e njeriut dhe jodiskriminim;

2) e ndjek zbatimin e këtij ligji dhe jep mendime dhe rekomandime;

3) i promovon parimin e barazisë, të drejtën e jodiskriminimit dhe menaxhimin e të gjitha formave të diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijes publike, informimit dhe edukimit;

4) kontribuojn gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programeve dhe materialeve nga sfera e arsimit formal dhe joformal;

5) përgatit dhe publikon raporte të posaçme dhe tematike pér çështje të caktuara nga sfera e barazisë dhe jodiskriminimit;

6) jep rekomandime të përgjithshme pér çështje të caktuara nga sfera e barazisë dhe jodiskriminimit dhe e ndjek zbatimin e tyre;

7) angazhohet pér ratifikimin e marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare nga sfera e të drejtave të njeriut ose pér qasje në to dhe e ndjek zbatimin e tyre;

8) kontribuojn gjatë përgatitjes së raporteve që shtet është i detyruar t'ua paraqesë trupave ndërkombëtarë dhe rajonalë pér të drejtë të njeriut dhe kontribuojn pér zbatimin e rekomandimeve të tyre;

9) promovon dhe propozon harmonizimin e legjislacionit nacional, dispozitave dhe praktikave me instrumente ndërkombëtare dhe rajonale pér të drejtat e njeriut;

10) iniciacion ndryshim të dispozitave pér shkak të zbatimit dhe përparimit të mbrojtjes nga diskriminimi;

11) jep mendim sipas propozimeve të ligjeve pér parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi;

12) vendos bashkëpunim me persona fizikë dhe juridikë, si dhe me shoqata, fondacione dhe partnerë socialë pér realizimin e parimit të barazisë dhe promovimin e parandalimit dhe mbrojtës nga diskriminimi;

13) bashkëpunon me trupa përkatës nacionalë të shteteve të tjera, si dhe me organizata ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;

14) vepron sipas parashtresave, miraton mendime, rekomandime dhe konkluzione pér raste konkrete të diskriminimit;

15) ngre procedurë pér mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare;

16) jep informata pér personin e interesuar pér të drejtat e tij ose të saj dhe mundësi pér ngritjen e procedurës gjyqësore ose tjetër pér mbrojtje nga diskriminimi;

17) e ndjek realizimin e mendimeve dhe rekomandimeve pér rastet konkrete të diskriminimit deri në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Komisioni;

18) iniciacion dhe paraqitet si ndërryrës në procedura gjyqësore pér mbrojtje nga diskriminimi;

19) me kërkësë të palëve ose me iniciativë personale mund të parashtrojë kërkësë që gjykata t'i mundësojë të veprojë si mik i gjykatës (amicus curiae);

20) çdo tre muaj e informon publikun pér rastet e diskriminimit, në mënyrë të përcaktuar me akt të komisionit;

21) i ndan mendimet e veta, konstatimet dhe rekomandimet dhe i drejtohet publikut nëpërmjet cilësdo medie;

22) miraton rregullore për punë, plan vjetor dhe program për punë dhe akte të tjera në lidhje me punën e tij;

23) mund të formojë trupa këshillëdhënës nga ekspertë për çështje specifike të caktuara të lidhura me përparimin, parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;

24) grumbullon dhe publikon të dhëna statistikore dhe të dhëna tjera dhe formon baza të të dhënavët në lidhje me diskriminimin;

25) paraqet në shqyrtim raport vjetor për punën e vet për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 31 mars në vitin paraprak për vitin e ardhshëm;

26) të gjitha raportet, duke përfshirë dhe reportin financiar, i publikon në faqen e internetit të Komisionit.

(2) Komisioni siguron qasje gjatë zbatimit të kompetencave nga paragrafi 1 i këtij nenit.

### Neni 22 Shërbimi profesional i Komisionit

(1) Për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit formohet shërbim profesional.

(2) Komisioni miraton akte të posaçme me të cilat përcaktohet organizimi i brendshëm dhe sistematizimi për punën e shërbimit profesional.

(3) Të punësuarit në shërbimin profesional të Komisionit kanë status të nëpunësve administrativë dhe për to zbatohen dispozitat në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

### IV. PROCEDURA PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI PARA KOMISIONIT PËR PARANDALIM DHE MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

#### Neni 23 Veprimi i Komisionit

(1) Personat të cilët konsiderojnë se kanë pësuar diskriminim mund të parashtrojnë prashtresë te Komisioni, me procesverbal me shkrim ose me gojë, pa obligim për pagesë të taksojnë dëshmi të kompensim tjetër.

(2) Personi i cili konsideron se është diskriminuar para Komisionit mund të përfaqësohet nga shoqata, fondacioni ose sindikata me pëlqim të dhënë paraprakisht.

(3) Shoqatat, fondacionet, sindikatat ose organizatat tjera të shoqërisë civile dhe institucionet, që kanë interes të arsyeshëm për mbrojtje të interesave të një grupi të caktuar ose në korniza të veprimit të tyre merren me mbrojtje nga diskriminimi, mund të paraqesin parashtresë, nëse e bëjnë të besueshme se me veprimin e personit të caktuar fizik ose juridik janë diskriminuar një numër më i madh personave.

(4) Komisioni ngrë procedurë sipas detyrës zyrtare nëse nga rrethanat dhe faktet, si dhe nga informata e marrë pas informatës së arritur, në mënyrë bazë del se nga organet nga neni 3 paragrafi (2) të këtij ligji është kryer diskriminim në pajtim me bazat diskriminuese.

#### Neni 24 Elementet, gjuha dhe afatet e parashtresës

(1) Parashresa duhet t'i përfshijë këto elemente: të dhënat për paraqitësin, të dhënat për personin kundër të cilët është paraqitur parashresa, rrethanat dhe faktet mbi të cilat bazohet parashresa, të dhënat mbi veprimet juridike që paraprakisht i ka investuar paraqitësi, nëse i ka, dhe nënshkrimi i paraqitësit.

(2) Nëse parashresa nuk i përbën elementet nga paragrafi (1) i këtij neni ose është e paqartë, Komisioni do ta ngarkojë parashtruesin ta rregullojë në mënyrë plotësuese në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të parashtresës.

(3) Në procedurë para Komisionit zbatohen dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Në komunikimin e drejtëpërdrejtë me Komisionin mund të përdoret dhe gjuhja e shenjave.

(4) Palët të cilat nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik kanë të drejtë përkthyes.

(5) Parashresa mund të parashtrohet më voni në afat prej gjashëtë muajsh pas zbulimit të aktit të diskriminimit ose më së voni një vit nga dita kur ka ndodhur shkelja e kryer.

(6) Komisioni mund të ngrejë procedurë edhe pas kalimit të afatit nëse konsideron se bëhet fjalë për rast që përfshin grup më të madh personash ose kur pasoja zgjat ose prek interesin publik.

(7) Komisioni e dorëzon parashtresën për personin kundër të cilët është paraqitur në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të parashtresës dhe ajo mund të deklarohet për dëshmitë në parashtresë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të saj.

#### Neni 25 Parandalimi i konfliktit të interesave

Anëtarë i Komisionit do të përjashtohet nga puna në lëndën me kërkesë personale ose me shumicë votash të Komisionit, nëse:

1) në lëndën në të cilin është zhvilluar procedura paraprakisht ka qenë i përfshirë ose ka qenë ose është palë, bashkëpronar, përkatësisht bashkëdetyrës, dëshmitar, ekspert, autorizues ose përfaqësues ligjor i palës;

2) me palën, me përfaqësuesin ose me autorizuesin e palës është farefis i gjakut në brezin e parë, kurse në vijë anësore përfshirë deri në shkallën e katërt, bashkëshort/e ose i afërm i bashkëshortit/es deri në shkallën e dytë dhe atëherë kur martesa ka pushuar dhe / ose

3) me palën, me përfaqësuesin ose me autorizuesin e palës është në marrëdhënie të kujdestarit, birësuesit, të birësuarit, ushqyesit ose të ushqyerit.

#### Neni 26 Barra e dëshmimit

Paraqitësi i parashtresës i cili pohon se është në pajtim me dispozitat e këtij ligji është kryer diskriminim është i detyruar t'i dëshmojë të gjitha faktet që e bëjnë pohimin të sigurt. Nëse Komisioni konstaton se pohimi është i sigurt, atëherë barra e dëshmimit kalon te personi kundër të cilët është paraqitur parashresa.

#### Neni 27 Vendimet e Komisionit

(1) Komisioni jep mendim në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së parashtresës dhe e ia dorëzon paraqitësit dhe personit kundër të cilët është paraqitur parashresa.

(2) Me mendim me shkrim nga paragrafi (1) i këtij neni, kurse pas përcaktimit të diskriminimit, Komisioni rekomandon mënyrë të mënjanimit të shkeljes së të drejtës.

(3) Personi të cilët i është ofruar rekomandimi është i detyruar të veprojë sipas rekomandimit dhe ta mënjanjojë shkeljen e të drejtës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të rekomandimit ose në afat më të gjatë nëse ekzistojnë shkaqe veçanërisht të arsyeshme, por jo më gjatë se gjashtë muaj, si dhe për këtë ta njoftojë Komisionin.

(4) Нёсе personi тё cilit i ёште drejtuar rekomandimi nuk vepron sipas rekomandimit нё pajtim me paragrafin (3) тё këtij neni, Komisioni parashtron kérkesë pér ngritjen e procedurës kundërvajtëse нё gjykatën kompetente pér kundërvajtje.

(5) Komisioni miraton konkluzion pér mosveprim ose pér ndërprerje tё procedurës sipas parashtresës nё rast kur procedura нё gjykatë pér tё njëjtën punë tashmë ёште ngritur ose ngritet gjatë procedurës ose ёште e përfunduar nё mënyrë tё plotfuqishme dhe pér këtë e njofton paraqitësin e parashtresës.

(6) Komisioni miraton konkluzion pér mosngritje tё procedurës pér parashtresë pér tё cilën tashmë ka vepruar, kurse nuk janë ofruar fakte dhe rrethana tё reja dhe pér këtë e njofton parashtruesin.

(7) Komisioni miraton konkluzion pér mosngritje ose pér ndërprerje tё procedurës nёse parashtruesi vendos ta térheq parashtresën gjatë kohës së veprimit.

(8) Komisioni miraton konkluzion pér mosngritje ose pér ndërprerje tё procedurës nёse gjatë procedurës paraqitësi i parashtesës ka vdekur, përvëç nёse pasardhësit nuk kérkojnë vazhdim tё procedurës së filluar.

#### Neni 28

#### **Rekomandim i përgjithshëm pér mbrojtje nga diskriminimi**

Komisioni me iniciativë personale i dërgon rekomandim tё përgjithshëm nё rast tё diskriminimit numrit më tё madh tё personave.

#### Neni 29

#### **Kryerja e kontrollit nё dokumentacion dhe nё lokale**

(1) Nё zbatimin e punëve nga kompetenca e vet Komisioni mund tё kryejë kontroll tё drejtëpërdrejtë nё dokumentacionin dhe nё lokalitet dhe tё kérkojë tё grumbulloj kopje nga dokumentet tё lidhura me rastin e caktuar tё lëndës nga tё gjithë personat juridikë, organet shtetërore, organet e njësive tё vëtëadministrimit lokal, organe tё tjera dhe organizata tё cilat bëjnë autorizime publike dhe institucionet dhe shërbimet publike tё cilat disponojnë me tё dhëna dhe informata pér raste dhe praktika tё përgjithshme tё diskriminimit, duke respektuar tё drejtën e privatësisë.

(2) Anëtarët e Komisionit dhe tё punësuarit nё shërbimin profesional kanë legitimacion zyrtar. Formulari, përbajtja dhe mënyra e veprimit gjatë dhënieve, shfrytëzimit dhe marrjes së legitimacionit zyrtar janë përcaktuar me akt tё përgjithshëm nga Komisioni.

#### Neni 30

#### **Grumbullimi i tё dhënavës dhe informatave nga persona fizikë dhe juridikë**

(1) Tё gjithë personat fizikë dhe juridikë, organet shtetërore, organet e njësive tё vëtëqeverisjes lokale, organet dhe organizatat tjera tё cilat kryejnë autorizime publike dhe institucionet dhe shërbimet publike, janë tё detyruara me kérkesë tё Komisionit tё japid tё dhëna pér raste konkrete tё diskriminimit dhe rekomanime tё përgjithshme tё diskriminimit nё afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit tё kérkesës.

(2) Komisioni mund ta ftojë nё bisedë secilin person i cili mund tё japse informata tё caktuara pér raste tё diskriminimit.

#### Neni 31

#### **Bashkëpunimi me institucione që veprojnë sipas parashtresave pér mbrojtje nga diskriminimi dhe tё drejtat e njeriut**

(1) Nё kryerjen e punëve nga kompetenca e vet Komisioni bashkëpunon me institucione që veprojnë sipas parashtresave pér mbrojtje nga diskriminimi dhe tё drejtat e njeriut pér raste konkrete tё dëksriminimit.

(2) Komisioni e realizon bashkëpunimin nga paragraft (1) i këtij neni, nëpërmjet memorandumeve pér bashkëpunim që janë publikisht tё publikuara nё veb faqen e Komisionit.

#### V. MBROJTJA GJYQËSORE

#### Neni 32

#### **Kompetenca dhe procedura gjyqësore**

(1) Personi i cili mendon se ёshtë i diskriminuar mund tё parashtrojnë ankesë nё gjykatën civile kompétente.

(2) Nё procedurë nё mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga Ligji pér procedurë kontestimore, përvëç nёse me këtë ligj nuk ёshtë rregulluar ndryshe.

(3) Procedura ёshtë urgjente.

#### Neni 33

#### **Kompetenca vendore**

Nё procedurën pér mbrojtje nga diskriminimi vendi ёshtë kompetent, përvëç gjykatës me kompetencë gjyqësore tё vendit, dhe gjykata nё territorin nё tё cilin ёshtë vendbanimi, përkatësisht selia e paditësit.

#### Neni 34

#### **Padia**

Me padinë nga neni 32 paragrafi (1) tё këtij ligji, mund tё kérkohet:

1) tё përcaktohet se i padituri e ka shkelur tё drejtën e paditësit, përkatësisht veprimin që e ka marrë ose nuk e ka marrë paraqet diskriminimin;

2) tё ndalohet marrja e veprimit me tё cilin shkelet ose mund tё shkelet e drejtë e paditësit;

3) tё detyrohet i padituri tё marrë veprime me tё cilat mënjanohet diskriminimi ose pasojat e tij;

4) tё kompensohet dëmi material dhe jomaterial i shkaktuar me shkelje tё tё drejtave tё mbrojtura me këtë ligj dhe

5) tё publikohet nё medie diapozitivi i aktgjykit me tё cilin ёshtë përcaktuar diskriminimi nё format tё kapshëm nё shpenzim tё tё paditurit.

(2) Kérkesat nga paragraft (1) i këtij neni mund tё theksohen së bashku me kérkesat pér mbrojtje tё tё drejtave tjera pér tё cilat vendoset nё procedurë kontestimore, nёse tё gjitha kérkesat janë nё lidhje tё ndërsjellë dhe nёse gjykata e njëjtë ёshtë me kompetencë tё vërtetë dhe vendore pёr to.

(3) Vendimi me tё cilin urdhërohet shpallje nё medie e obligon botuesin e medies nё tё cilën duhet tё publikohet dispozitivi i aktgjykit, pa marrë parasyshë nёse ka qenë palë nё procedurë.

#### Neni 35

#### **Padia pér mbrojtjen nga diskriminimi me interes publik (actio popularis)**

(1) Shoqatat, fondacionet, sindikatet apo organizatat tjera tё shoqërisë civile, dhe grupet formale tё cilat kanë interes tё arsyeshëm pér mbrojtjen e interesave tё grupit tё caktuar apo nё kornizat e veprimitari së tyre merren me mbrojtjen nga diskriminimi, mund tё parashtrojnë padi, nёse e bëjnë tё besueshme se me veprimin e tё paditit janë diskriminuar numrë më i madh i personave.

(2) Në padinë nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të theksohet kërkesa:

1) të përcaktohet se i padituri ka kryer diskriminim mbi grupin interesat e të cilat i përfaqëson paditësi, përkatësisht veprimi që e ka marrë apo e ka lëshuar mund të shpie në diskriminimin e grupit;

2) të ndalohet marrja e veprimeve me të cilat diskriminohet grupi interesat e të cilat i përfaqëson paditësi;

3) të detyrohet i padituri të marrë veprime me të cilat mënjanohet diskriminimi apo pasojat e tij;

4) të publikohet në medie dispozitivi i aktgjykimit me të cilin përcaktohet diskriminimi në formatin e qasshëm në shpenzim të të paditurit.

### Neni 36 Masat për sigurim

Para fillimit apo gjatë procedurës me rastin e kërkesës së padisë gjykata, me propozim të palës, mund të caktojë masa për siguri dhe pa e dëgjuar palén e kundërt, për shkak të mënjanimit të rezikut urgjent nga dëmtimi i kundërligjshëm apo parandalimi i dhunës apo mënjanimit të dëmit të pakompensueshëm.

### Neni 37 Barra e dëshmimit

(1) Paditësi i cili pohon se në pajtim me dispozitat e këtij ligji është kryer diskriminim ka për detyrë t'i prononcojë faktet që e bëjnë pohimin të besueshëm dhe atëherë barra e dëshmimit i kalon të paditurit të dëshmojë se nuk ekziston diskriminimi.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk zbatohet në procedurë të kundërvajtjes dhe në procedurë penale.

### Neni 38 Dëshmitë

(1) Në procedurë gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi, krahas dëshmive të përcaktuara në Ligjin për procedurë kontestimore, si dëshmi mund të shfrytëzohen edhe të dhënat statistikore, dhe/ apo të dhënat e marra me testimini e situatës.

### Neni 39 Shpenzimet gjyqësore

1) Personat të cilët do të ngritin procedurë gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi janë të liruar nga pagesa e shpenzimeve përtaksë gjyqësore.

2) Shpenzimet përtaksë gjyqësore për personat nga paragrafi (1) i këtij neni, janë në ngarkim të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### Neni 40 Pjesëmarrja e personave të tretë

(1) Në seancën gjyqësore lidhur me padinë nga neni 34 i këtij ligji, si i përzier nga ana e personit i cili pohon se është i diskriminuar, mund të shoqërohet organi, organizata, institucioni, shoqëria, sindikata ose personi jetër i cili në kuadër të veprimtarisë së vet merret me mbrojtjen e të drejtave të barazisë dhe mosdiskriminimit përtë drejtat e të cilës vendoset në procedurë.

(2) Për pjesëmarrjen e personit të përzier vendos gjykata me zbatimin e dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore.

## VI. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

### Neni 41

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik përtë cilin është konstatuar se ka kryer diskriminim në pajtim me nenet 4, 8, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, funksionarit të organit shtetëror, kryetarit të komunës në njësinë e vetëqeverisjes lokale ose personit zyrtar të cilin i është besuar kryerja e autorizimeve publike.

(4) Gjobë në shumë prej 400 deri 800 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, personit fizik.

### Neni 42

(1) Gjobë në shumë prej 5.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik përtë cilin është konstatuar se ka kryer diskriminim në pajtim me nenen 13 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shume prej 700 deri 1.500 euro në kundërvlere me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni funksionarit të organit shtetëror, kryetarit të komunës në njësinë e vetëqeverisjes lokale ose personit zyrtar të cilin i është besuar kryerja e autorizimeve publike.

(4) Gjobë në shumë prej 800 deri 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit fizik.

### Neni 43

(1) Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili do të veprojë në kundërshtim me nenen 29 dhe 30 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik.

(3) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni funksionarit të organit shtetëror, kryetarit të komunës në njësinë e vetëqeverisjes lokale ose personit zyrtar të cilin i është besuar kryerja e autorizimeve publike.

(4) Gjobë në shumë prej 400 deri 800 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit fizik.

### Neni 44

Përcaktimi i lartësisë së gjobës për personin juridik kryhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

### Neni 45 Organi i kundërvajtjes

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksion të kundërvajtjes shqipton organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës (në tekstin e mëtejmë: organi i kundërvajtjes).

Neni 46

**Formimi dhe puna e Komisionit të Kundërvajtjes**

(1) Procedurën e kundërvajtjes nga neni 45 para organit të kundërvajtjes e mban Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje (në tekstin e mëtejmi: Komisioni i Kundërvajtjes) i formuar nga ana e ministrit që udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës.

(2) Komisioni për Kundërvajtje përbëhet prej personave të autorizuar zyrtarë të punësuar në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punës nga të cilët njëri e kryen funksionin kryetar i Komisionit për Kundërvajtje.

(3) Komisioni për Kundërvajtje përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët së paku një prej anëtarëve është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës, ndërsa tre anëtarët janë me përvojë pune prej minimum katër vitesh në sferën e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimi.

(4) Komisioni për Kundërvajtje zgjidhet në kohëzgjatje prej pesë vitesh me të drejtë të rizgjedhjes së anëtarëve.

(5) Anëtar i Komisionit për Kundërvajtje mund të shkarkohet:

- me skadimin e mandatit për të cilin është emëruar anëtar,
- me kërkesë të tij,
- me përbushje të kushteve për pension të pleqërisë në pajtim me ligji,
- nëse i konstatohet paaftësi e përhershme,
- nëse konstatohet shkelje e irregullave për mbajtje të procedurës për kundërvajtje me vendim të plotfuqishëm,
- nëse nuk i përbush obligimet që dalin nga puna në Komisionin për Kundërvajtje dhe
- nëse nuk ka paraqitur ekzistim të konfliktit të interesave për rast për të cilin vendos Komisioni për Kundërvajtje

(6) Komisioni për kundërvajtje ka të drejtë të nxjerr dëshmi dhe të mbledhë të dhëna të cilat janë të nevojshme për konstatimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punët tjera dhe ndërmarrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.

(7) Anëtarët e Komisionit për Kundërvajtje janë të mëvetësishëm dhe të pavarur në punën e Komisionit për Kundërvajtje dhe vendosin në bazë të njohurisë profesionale dhe bindjes së mëvetësishme.

(8) Komisioni për Kundërvajtje punon në këshill, ndërsa vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(9) Komisioni për Kundërvajtje miraton rregullore për punën e vet.

Neni 47

(1) Komisioni për Kundërvajtje e udhëheq procedurën për kundërvajtje në pajtim me dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

(2) Për gjithçka që nuk është rregulluar me këtë ligj në lidhje me udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje dhe shqiptimit të sanksionit për kundërvajtje do të zbatohen dispozitat e Ligjit për kundërvajtje.

**VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 48

(1) Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon mandati i anëtarëve të Komisionit për Mbrotje nga Diskriminimi, ndërsa vazhdojnë me punë deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, por jo më gjatë se tre muaj.

(2) Konkursi publik për zgjedhje të anëtarëve të Komisionit do të shpalljet në afat prej dy javësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 49

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 50

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj Komisioni do t'i miratojë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

Neni 51

Ligjet të cilat përbajnë dispozita që kanë të bëjnë me parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi do të duhet të harmonizohen me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi në afat prej dy vitesh nga dita hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 52

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi (“Gazeta Zyrare e Republikës së Maqedonisë”, numër 50/10, 44/14, 150/15, 31/16 dhe 21/18).

Neni 53

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në „Gazeten Zyrare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

**1269.**

Врз основа на членот 75, ставови 1, 2 и 3 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**У К А З****ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНАВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАДОЛЖИТЕЛНИ РЕЗЕРВИ НА НАФТА И НАФТЕНИ ДЕРИВАТИ**

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 16 мај 2019 година.

Бр. 08-2890/1  
16 мај 2019 година  
Скопје

Претседател на Република  
Северна Македонија,  
**Стево Пендаровски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Северна Македонија,  
м-р **Talat Xhaferi, с.р.**

**ЗАКОН****ЗА ИЗМЕНАВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАДОЛЖИТЕЛНИ РЕЗЕРВИ НА НАФТА И НАФТЕНИ ДЕРИВАТИ****Член 1**

Во Законот за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати („Службен весник на Република Македонија“ број 84/2008, 35/11, 84/12, 43/14 и 83/18), во членот 3-а ставот (1) се менува и гласи:

„(1) Одделните изрази употребени во овој закон го имаат следново значење:

1. „Билатерален договор“ е договор склучен меѓу Владата на Република Македонија и владата на која било земја членка на Европската Унија со кој се регулираат начинот и условите на чувањето на задолжителните резерви на Република Македонија во складишни капацитети на територија на државата со која се склучува договорот;

2. „Достапност на задолжителните резерви“ претставува физичка достапност и расположливост на залихите на задолжителните резерви во случај на итни потреби;

3. „Евапорација“ е испарување на нафтата и нафтени деривати;

4. „Евиденција на уплата на надоместокот за задолжителни резерви“ е систематски и континуиран процес со кој Дирекцијата за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати (во натамошниот текст: Дирекција) и обврзникот ги воведуваат податоците во единствен систем за обработка на податоци;

5. „Енергетски биланс“ е индикативен плански документ со кој Владата ги определува вкупните потреби од енергија и потребите на одредени видови на енергија, како и можностите за нивно задоволување од домашно производство и од увоз, за период од една година;

6. „Зановување“ е процес на замена на постојните залихи на задолжителни резерви со резерви од нафтени деривати со нови карактеристики и својства со цел за усогласување со важечките прописи за квалитет на течните горива во Република Македонија;

7. „Задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати (задолжителни резерви)“ се минимални резерви на нафта и нафтени деривати сопственост на Република Македонија, кои се чуваат од страна на Дирекцијата со цел за обезбедување на услови за интервентно снабдување на пазарот со нафта и нафтени деривати, во случај на нарушување на енергетската сигурност на државата предизвикана од нарушувања во снабдувањето од поголеми размери;

8. „Изјава за сообразност“ е документ со кој се потврдува квалитетот на нафтени деривати и горивата за транспорт, кој производителите, трговците на големо на дериватот или горивото за транспорт, трговци на мало со горива, како и потрошувачите кои набавуваат нафтени деривати, биогорива и горива за транспорт од странство ја обезбедуваат од правни лица акредитирани согласно со стандардот МКС ЕН ИСО/ИЕЦ 17020 врз основа на извештај за испитување на квалитетот на дериватот или горивото за транспорт од страна на лаборатории акредитирани согласно со стандардот МКС ЕН ИСО/ИЕЦ 17025;

9. „Контрола на квантитет на нафтени деривати“ е процес на физичко утврдување на количините на нафтени деривати, изразени во литри или килограми, со калибрирани инструменти;

10. „Контрола на квалитет на нафтени деривати“ е процес на утврдување на суштинските барања за граничните вредности на квалитативните својства на течните горива согласно со прописот за квалитет на течните горива во Република Македонија;

11. „Лиценца“ е акт издаден од страна на Регулаторната комисија за енергетика и водни услуги на Република Македонија (во натамошниот текст: Регулаторната комисија за енергетика) врз основа на која лицето на кое му е издадена може да врши енергетска дејност во Република Македонија;

12. „Нафтени деривати“ се производи добиени од сирова нафта вклучително полупроизводите, класифицирани во следниве категории:

- лесни дестилати или лесни нафтени деривати (течни нафтени гасови ТНГ- бутан, пропан и смеса од бутан и пропан, сите видови моторни бензини и авиобензини),

- средни дестилати или средни нафтени деривати (сите видови дизел за автомобили, гасно масло или екстра лесно масло за греење ЕЛ-1 и керозин) и

- тешки дестилати или тешки нафтени деривати (сите видови мазут) и друго (битумен и нафтен кокс);

13. „Нафтовород“ е цевковод со соодветни уреди и постројки за транспорт на сирова нафта;

14. „Ниво на задолжителни резерви“ е физичко реално ниво на пополнетост на дериватите изразено во денови, пресметано врз основа на внатрешната потрошувачка во претходната календарска година согласно со Енергетскиот биланс на Република Македонија;

15. „Објект за складирање на сирова нафта, нафтени деривати, биогорива, или горива за транспорт“ е техничко-технолошка и функционална целина наменета за складирање составена од резервоари и помошни постројки, кои треба да ги исполнува пропишните услови за изградба и одржување, како и минимално-техничките услови во поглед на заштита од пожари, заштита на животна средина, евидентирање на количините и употребениот капацитет;

16. „Обновување на нафтени деривати“ е процес со кој постојните залихи на нафтени деривати од задолжителните резерви се заменуваат со нови количини од истиот вид и квалитет, се со цел да се сочуват физичко-хемиските особини на истите;

17. „Правен промет“ е продажба, дистрибуција, складирање на нафтени деривати наменети за продажба и понуда за продажба или која било друга форма на пренос, независно дали преносот е бесплатен или не;

18. „Производител на нафтени деривати“ е вршител на енергетска дејност преработка на сирова нафта и производство на нафтени деривати и/или производство на горива наменети за транспорт со намешување на нафтени деривати и биогорива;

19. „Продуктовод“ е цевковод со соодветни уреди и постројки за транспорт на нафтени деривати или на горива за транспорт;

20. „Рандман“ е просечната нафтена добивка при преработка на сирова нафта;

21. „Регулаторна комисија за енергетика“ е самостојно, непрофитно регулаторно тело кое го регулира и контролира начинот на вршење на енергетските дејности согласно со Законот за енергетика и Законот за утврдување на цени на водните услуги;

22. „Референтна година“ е календарска година која е база на податоци за реализираната потрошувачка (согласно со Енергетскиот биланс на Република Македонија) и служи за пресметка на количините на задолжителни резерви кои треба да се складираат во даден временски период;

23. „Тикет“ е договор за опшиско купување на сирова нафта и/или нафтени деривати по однапред утврдени критериуми во утврден временски период;

24. „Трговец на големо со горива“ е вршител на енергетска дејност трговија на големо со сирова нафта, нафтени деривати, биогорива и горива за транспорт, кој купува сирова нафта, нафтени деривати, биогорива и горива за транспорт од производители, тргува со други трговци на големо со горива и ги снабдува трговци на мало со горива и потрошувачите;

25. „Трговско друштво - складиштар“ е трговско друштво кое поседува една или повеќе лиценци за: лиценца за вршење на енергетска дејност преработка на сирова нафта и производство на нафтени деривати; лиценца за вршење на енергетска дејност производство на горива наменети за транспорт со намешување на нафтени деривати и биогорива; лиценца за вршење на енергетска дејност трговија на големо со сирова нафта, нафтени деривати, биогорива и горива за транспорт, кое истовремено поседува и акцизна дозвола согласно со Законот за акцизите, а со кое Дирекцијата има склучено договор согласно со овој закон;

26. „Увозник на нафтени деривати“ е трговец на големо со горива;

27. „Формирање на задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати“ е процес на набавка на нафтени деривати со кој се обезбедуваат услови за интервентно снабдување на пазарот со нафтени деривати во случај на нарушување на енергетската сигурност на државата предизвикана од нарушувања во снабдувањето од големи размери и

28. „Чување на задолжителни резерви“ е обврска на трговските друштва – складиштари во своите резервоарски капацитети да складираат, чуваат и обновуваат нафта и/или нафтени деривати од задолжителните резерви.“

## Член 2

Во член 7 ставот (1) се менува и гласи:

„Задолжителните резерви се должни да ги чуваат трговските друштва кои поседуваат една или повеќе од следните лиценци: лиценца за вршење на енергетска дејност преработка на сирова нафта и производство на нафтени деривати, и/или лиценца за производство на горива наменети за транспорт со намешување на нафтени деривати и биогорива и/или лиценца за трговија на големо со сирова нафта, нафтени деривати, биогорива и горива за транспорт, а кои истовремено поседуваат и акцизна дозвола (во натамошниот текст: трговски друштва-складиштари).“

Во став (2) во алинејата 2 по зборот „сообраќај“ се додаваат зборовите: „,и/или нафтовород и/или продуктовород“.

Во алинејата 3 зборовите: „(освен за горивото за мазни мотори ГМ-1) да изнесува 1.000 м<sup>3</sup> по нафтен дериват и 200 м<sup>3</sup> за ТНГ“, се заменуваат со зборовите: „треба да биде во согласност со важечките прописи за минимално-техничките услови за објекти за складирање на сирова нафта, нафтени деривати, биогорива или горива за транспорт“.

(2) Со парична казна од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе се казни одговорното лице на правното лице корисник на квалификувани доверливи услуги, за прекршокот од ставот (1) на овој член.

#### Член 69

(1) Со парична казна од 1.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе се казни правното лице кое има регистрирана шема за електронска идентификација, ако:

1) шемата на електронска идентификација не ги исполнува условите од членот 11 од овој закон и

2) не ги преземе потребните технички и организациски мерки за управување со ризиците кои би можеле да ја нарушаат сигурноста и безбедноста при обезбедување на овие услуги согласно со членот 18 од овој закон.

(2) Со парична казна од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе се казни одговорното лице на правното лице, за прекршокот од ставот (1) на овој член.

#### Член 70

(1) Со парична казна од 7.000 до 15.000 евра во денарска противвредност ќе се казни правното лице давател на квалификувана доверлива услуга, ако не постапи по наредба на овластеното лице за надзор во рок определен согласно со членот 65 од овој закон.

(2) Со парична казна од 1.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе се казни одговорното лице на правното лице давател на квалификувана доверлива услуга, за прекршокот од ставот 1 на овој член.

#### Член 71

(1) Со парична казна од 7.000 до 15.000 евра во денарска противвредност ќе се казни јавен орган кој нема да ја признае важноста или ќе ја оспори доказната сила на електронскиот документ изготвен согласно со овој закон или дигитализиран документ создаден согласно со членот 10 од овој закон, само затоа што тоа е електронски документ.

(2) Со парична казна од 1.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе се казни функционерот кој раководи со јавниот орган, односно овластеното лице

на правното лице кое врши јавни овластувања доколку ја оспорува доказната сила на електронските документи или документите издадени согласно со овој закон, само затоа што се издадени или употребени во електронски формат.

#### Член 72

(1) За прекршоците утврдени со овој закон, прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

#### IX. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

#### Член 73

Подзаконските акти чие донесување е утврдено со овој закон ќе се донесат во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 74

(1) Електронските потписи издадени до денот на започнувањето на примената на овој закон, согласно со Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис („Службен весник на Република Македонија“ број 34/2001, 6/2002, 98/2008 и 33/15) продолжуваат да важат се до истекот на нивната важност.

(2) Правните лица кои вршеле дејност до денот на започнувањето на примената на овој закон, согласно со Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис, со започнувањето на примената на овој закон ќе продолжат да ги издаваат електронските потписи и ќе ги обезбедуваат услугите согласно со Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис („Службен весник на Република Македонија“ број 34/2001, 6/2002, 98/2008 и 33/15).

#### Член 75

(1) Давателите на доверлива услуга кои вршат дејност врз основа на Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис се должни да го усогласат своето работење со одредбите на овој закон во рок од една година, сметано од денот на донесувањето на подзаконските акти определени со овој закон.

(2) Во периодот до усогласување со одредбите на овој закон, давателите на доверлива услуга од ставот (1) на овој член ги обезбедуваат услугите за издавање на сертификати за електронски потписи и временски жигови согласно со Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис („Службен весник на Република Македонија“ број 34/2001, 6/2002, 98/2008 и 33/15).

(3) Давателите на доверлива услуга кои вршат дејност врз основа на Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис, а кои нема да го усогласат своето работење во рок од една година од денот на донесувањето на подзаконските акти предвидени со овој закон нема да бидат запишани во Регистарот за шеми за електронска идентификација и за доверливи услуги.

#### Член 76

Овој закон престанува да важи со пристапувањето на Република Северна Македонија во Европската Унија.

#### Член 77

Со денот на започнувањето на примената на овој закон престанува да важи Законот за податоците во електронски облик и електронски потпис („Службен весник на Република Македонија“ број 34/2001, 6/2002, 98/2008 и 33/15).

## Член 78

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“, а ќе започне да се применува во рок од една година од денот на донесувањето на подзаконските акти определени со овој закон.

## L I GJ PËR DOKUMENTE ELEKTRONIKE, IDENTIFIKIM ELEKTRONIK DHE SHËRBIME KONFIDENCIALE (\*)

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Lënda

##### Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohet krijimi, deponimi dhe përpunimi i dokumenteve elektronike, identifikimi elektronik dhe shërbimet konfidenciale.

(2) Me këtë ligj rregullohet edhe përdorimi i dokumenteve elektronike, nënshkrimi elektronik dhe vula elektronike dhe shërbimet konfidenciale në procedura administrative dhe gjyqësore.

(3) Lëndë e rregullimit të këtij ligji janë kushtet me të cilat pranohen mjetet për identifikim elektronik të lëshuara prej personave fizikë dhe juridikë që bëjnë pjesë në kuadër të skemës së regjistruar ose të njohur për identifikim elektronik.

#### Qëllimi

##### Neni 2

(1) Qëllimi i këtij ligji është sigurohet mbrojtje e mjetave për identifikim elektronik dhe siguri gjatë sigurimit të shërbimeve konfidenciale.

(2) Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i nënshkrimeve elektronike, vulave elektronike, vulave kohore elektronike, dokumenteve elektronike, shërbimeve për dërgesë elektronike me rekomandim, shërbimeve për kontrollim të autenticitetit të ueb faqeve, si dhe ruajtja e nënshkrimit ose vulës elektronike dhe validizimin e tyre.

#### Përkufizime

##### Neni 3

(1) Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë domethënien si vijon:

1) format i të dhënavë elektronike janë të dhëna të krijuara në formë elektronike, të përshtatshme për përpunim elektronik dhe transferim nëpërmjet sistemeve elektronike komunikuese;

2) transakcion elektronik është aktivitet ndërmjet dy ose më shumë palëve, që bëhet në mënyrë elektronike;

3) dokument elektronik është secila përbajtje e deponuar në formë elektronike, veçanërisht dokumente tekstuale ose audio, vizuelle ose audio-vizuale;

4) produkt është harduer, softuer ose komponentët përkatës të harduerit ose softuerit të parapara për t'u shfrytëzuar gjatë sigurimit të shërbimeve konfidenciale;

5) interoperabilitet është aftësia e dy ose më shumë sistemeve ose komponentëve të tyre për këmbimin e të dhënavës dhe lehtësimin e përdorimit të përbashkët të të dhënavës dhe diturisë;

6) organ publik është organ shtetëror, organ i administratës shtetërore, njësi e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrje publike, ente, organizata dhe persona juridikë të cilëve u janë deleguar autorizime publike në pajtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;

\* Me këtë ligj bëhet harmonizim me Reguloren (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit prej 23 korrik 2014 për identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale për transakcione elektronike në tregun e brendshëm dhe për shfuqizimin e Direktivës 1999/93/BE me CELEX numër 32014R0910

7) autentikimi është proces elektronik i cili mundëson identifikim elektronik të personit fizik ose juridik ose që mundëson vërtetim të origjinës dhe integritetit të të dhënavës në formë elektronike;

8) të dhëna për identifikim të personave janë përbledhje e të dhënavës në bazë të të cilave është e mundur vetëm të identifikohet identiteti i personit juridik, personit fizik ose personit të autorizuar të personit juridik;

9) identifikimi elektronik është proces i shfrytëzimit të të dhënavës për identifikimin e personave në formë elektronike të cilët në mënyrë unikate e përfaqësojnë personin fizik ose juridik ose personin e autorizuar të personit juridik;

10) mjete për identifikim elektronik janë mjete materiale ose jomateriale të cilat përbajnë të dhëna për identifikim të personave, kurse shfrytëzohen për autentikim tek shërbimet elektronike;

11) lëshues i mjetit për identifikim elektronik është person juridik i cili i plotëson kushtet e caktuara në këtë ligj për lëshues të mjeteve për identifikim elektronik;

12) skemë për identifikim elektronik është sistem për identifikim elektronik sipas të cilët mjetet për identifikim elektronik u lëshohen personave fizikë ose juridikë ose personit të autorizuar në personin juridik;

13) shërbim konfidencial është shërbim elektronik gjatë transakcioneve elektronike, që përbëhet prej:

- lëshimit, validimit dhe verifikimit të nënshkrimeve elektronike, vulave elektronike ose vulave kohore elektronike, shërbime për dërgesë elektronike me rekomandim, si dhe certifikata në lidhje me këto shërbime ose

- krijim, validim dhe verifikim të certifikatave për autenticitet të ueb faqeve ose

- ruajtje të nënshkrimeve elektronike, vulave ose vërtetimeve në lidhje me këto shërbime.

Shërbimet konfidenciale mund të janë të pakualifikuara dhe të kualifikuara.

14) dhënës i shërbimit konfidencial është person juridik i cili siguron një ose më tepër shërbime konfidenciale;

15) pala e prekur është person fizik ose juridik i cili ka interes juridik nga identifikimi elektronik ose shërbime konfidenciale;

16) shërbimi i kualifikuar konfidencial është lloji i shërbimit konfidencial që i plotëson kushtet e përcaktuarë me këtë ligj që kanë të bëjnë me shërbimin e kualifikuar konfidencial;

17) dhënës i shërbimit të kualifikuar konfidencial është dhënës i shërbimit konfidencial që siguron një ose më tepër shërbime të kualifikuar konfidenciale dhe statusi i të cilët dhënës i shërbimi të kualifikuar konfidencial është ndarë nga ana e ministrit për Shoqëri Informatike dhe Administratë me regjistrim në Registrin e skemave për identifikim elektronik dhe të shërbimeve konfidenciale.

Dhënës i shërbimit të kualifikuar konfidencial është person juridik të cilët i janë ndarë autorizime publike, në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

18) nënshkrim elektronik është përbledhje e të dhënavës në formë elektronike që i bashkëngjitet ose është në lidhje logjike me të dhëna tjera në formë elektronike, me çka sigurohet siguri e origjinës dhe integritetit të të dhënavës të shoqëruara ose të lidhura;

20) të dhëna për përpunim të nënshkrimit elektronik janë të dhëna unike të cilat shfrytëzohen nga ana e nënshkruesit për krijim të nënshkrimit elektronik;

21) të dhëna për validim janë të dhënat që përdoren për validim të nënshkrimit elektronik ose vulës elektronike;

22) certifikatë për nënshkrim elektronik është vërtetim elektronik që i lidh të dhënat për validim të nënshkrimit elektronik me person fizik dhe që e konfirmon së paku emrin ose pseudonimin e atij personi;

23) certifikatë për vulë elektronike është vërtetim elektronik që i lidh të dhënat për validim të vulës elektronike me personin juridik dhe që e konfirmon emrin e personit juridik;

24) nënshkruar është person fizik që krijon nënshkrim elektronik;

25) krijues është vulë elektronike e personit juridik që krijon vulë elektronike dhe e njëjtë në aspekt të këtij është përcaktuar edhe si vulosës;

26) mjet për krijim të nënshkrimit elektronik ose vulë elektronike është mjet teknik, përkatesisht softuer ose harduer me konfiguracion, që përdoret për të krijuar nënshkrim elektronik ose vulë elektronike;

27) validim është procedura për kontrollim dhe vërtetim se nënshkrimi elektronik ose vula elektronike janë valide;

28) nënshkrim i avancuar elektronik është nënshkrim elektronik që i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj që kanë të bëjnë me nënshkrim të avancuar elektronik;

29) nënshkrim i kualifikuar elektronik është nënshkrim i avancuaravancuar elektronik që është i krijuar prej mjetit përpunim të nënshkrimit të kualifikuar elektronik dhe që bazohet në certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik;

30) mjete për krijim të nënshkrimit ose vulës së kualifikuar elektronike janë mjete që i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj, ndërsa që cilat kanë të bëjnë me mjetet për krijim të nënshkrimit ose vulës së kualifikuar elektronike;

31) certifikatë e kualifikuar për nënshkrim elektronik është certifikatë për nënshkrim elektronik e lëshuar nga dhënesi i shërbimit të kualifikuar konfidencial dhe i cili i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse të cilat kanë të bëjnë me certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik;

32) nënshkrim i avancuar elektronik është vulë elektronike që i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj të cilat kanë të bëjnë me nënshkrim të avancuar elektronik;

33) vulë e kualifikuar elektronik donë të thotë vulë e avancuar elektronike që është përpunuar prej mjetit përpunim të vulës së avancuar elektronike dhe që bazohet në certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike;

34) të dhëna për përpunim të vulës elektronike janë të dhëna unike të cilat shfrytëzohen nga ana e krijuesit të vulës elektronike me qëllim të krijimit të vulës elektronike;

35) certifikatë e kualifikuar për vulë elektronike është certifikatë për vulë elektronike të lëshuar nga dhënesi i shërbimit të kualifikuar konfidencial dhe i cili i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse të cilat kanë të bëjnë me certifikatë të kualifikuar për vulë elektronike;

36) certifikatë për autenticitet të ueb faqes është vërtetim që mundëson të konfirmohet autenticiteti i ueb faqes së caktuar dhe e lidh ueb faqen me personin fizik ose juridik të cilin i është lëshuar certifikata për autenticitet të ueb faqe;

37) certifikatë e kualifikuar për autenticitet të ueb faqes është certifikatë për autenticitet të ueb faqes të lëshuar prej dhënesit të shërbimit të kualifikuar konfidencial dhe që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse të cilat kanë të bëjnë me certifikatë të kualifikuar për autenticitet të ueb faqe;

38) vulë e përkohshme elektronike është përmbledhje e të dhënavë në formë elektronike që lidhet me të dhëna tjera në formë elektronike me kohë konkrete dhe paraqet dëshmi se të dhënat e lidhura kanë ekzistuar në momentin konkret;

39) vulë e kualifikuar e kohore elektronike është vulë kohore elektronike që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse që kanë të bëjnë me vulë kohore të kualifikuar elektronike;

40) dërgesë elektronike me rekomandim është shërbim që mundëson transferimin e të dhënavë ndërmjet palëve të treta në mënyrë elektronike dhe siguron dëshmi në lidhje me transferimin e të dhënavë, duke përfshirë dëshmi për dërgesë dhe pranimin e të dhënavë, kurse gjatë kësaj e mbroj transferimin e të njëjtave nga rreziku i humbjes, vjedhjes, dëmtimit ose ndryshimeve të palejuara;

41) dërgesë e kualifikuar elektronike me rekomandim është shërbim për dërgesë elektronike me rekomandim që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse të cilat kanë të bëjnë me dërgesën e kualifikuar elektronike me rekomandim;

42) konverzion është ndryshim i formës ose formatit të dokumentit prej një forme ose formati në formë apo format tjetër, ashtu që përbajtja e dokumentit mbetet e pandryshuar;

43) digitalizim është proces i konvertimit të dokumentit forma e të cilat nuk është elektronike në dokument të digjitalizuar;

44) dokument i digjitalizuar është dokument elektronik që është i krijuar me digjitalizim të dokumenteve origjinale në formë të shkruar;

45) deponim elektronik i dokumenteve është ruajtje e dokumenteve në formë elektronike, për të cilat saktë është përcaktuar koha e ruajtjes së atyre dokumenteve, në pajtim me kohën e ruajtjes së dokumenteve në formë të shtypur, për të cilat koha e deponimit është konfirmuar me vulë elektronike kohore;

46) deponim i kualifikuar elektronik i dokumenteve është ruajtje e dokumenteve elektronike, të cilat gjatë deponimit të tyre janë konfirmuar me nënshkrim apo vulë të kualifikuar elektronike dhe vulë të kualifikuar të përkohshme;

47) shenjë për besim në shërbim konfidencial është shenjë e cila është qartë e identifikueshme dhe që sugeron qartë se shërbimin konfidencial e siguron dhënës konkret i shërbimit konfidencial;

48) shenjë për besim në shërbim të kualifikuar konfidencial është shenjë e cila është qartë e identifikueshme dhe që sugeron qartë se shërbimin e kualifikuar konfidencial e siguron dhënës konkret i shërbimit të kualifikuar konfidencial;

49) trup për vlerësim të përputhshmërisë është person juridik i akredituar të bëjë vlerësimin të harmonizimit për plotësim të kushteve që kanë të bëjnë me dhënës të shërbimit të kualifikuar konfidencial dhe të shërbimeve të kualifikua konfidenciale të cilat i njëjti i siguron;

50) laborator për testim është person juridik i akredituar që të bëjë vlerësimin e harmonizimit të mjetave për lëshim të identifikimit elektronik, nënshkrimeve elektronike ose vulave elektronike me kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Shprehjet që përdoren në këtë ligj domethënë e të cilave nuk është përkufizuar në paragrafin (1) të këtij nenit, kanë domethënë të caktuar me ligj tjetër.

## Zbatimi i ligjit

### Neni 4

(1) Dispozitat e këtij ligji aplikohen edhe për parandalimin e larjes së parave, nëpërmjet identifikimit të shfrytëzesit të shërbimeve konfidenciale, konfirmim të identitetit të tij në bazë të përpunimit të dokumenteve, të dhënavë ose informatave të pranuara prej burimit të sigurt dhe të pavarur, duke përfshirë edhe mjetet për identifikim elektronik, shërbime përkatëse konfidenciale.

(2) Dispozitat nga ky ligj që kanë të bëjnë me shërbime konfidenciale nuk aplikohen në suaza të sistemit të mbyllur ose sistem të dedikuar për grup të kufizuar të pjesëmarrësve, përdorimi i të cilave mund të përcaktohet me marrëveshje ose me akt të brendshëm, kurse sistem i cili nuk ka ndikim mbi persona të tretë ose nuk shkakton obligime për palë të treta jashtë atij sistemi.

### **Përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale**

#### **Neni 5**

(1) Dhënesi i shërbimit konfidential gjatë përpunimit të të dhënave personale tek të cilat ka qasje gjatë kryerjes së veprimitarës vepron në pajtim me dispozitat nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale.

(2) Gjatë kryerjes së transacionit elektronik, shfrytëzuesi mund të përdor edhe pseudonim, nëse përdorimi i pseudonimit i cili është përdorur nuk është në kundërshtim me dispozitat e ndonjë ligji tjeter.

### **II. DOKUMENTI ELEKTRONIK**

#### **Veprimi juridik i dokumentit elektronik**

#### **Neni 6**

(1) Dokumenti elektronik ka fuqinë e njëjtë juridike dhe dëshmuese sikur edhe forma e shkruar e dokumentit, në pajtim me ligj.

(2) Dokumenti elektronik nuk mund të kontestohet si dëshmi në procedurë administrative ose gjyqësore, vetëm për shkak se është krijuar në formë elektronike.

(3) Kur me ligj është përcaktuar formë me shkrime e dokumenteve ose akteve, dokumenti elektronik konsiderohet si dokument ose akt në formë të shkruar.

#### **Krijimi i dokumentit elektronik**

#### **Neni 7**

(1) Dokument elektronik krijuhet me shfrytëzimin e një ose më shumë teknologjive informatike dhe komunikuese në dispozicion dhe të përdorshme, përvëç nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj tjeter.

(2) Dokumenti elektronik si material arkivor krijuhet në formë që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, kurse është i përshtatshëm përgatitje për deponim elektronik të sigurisë.

#### **Origjinali dhe kopja**

#### **Neni 8**

(1) Çdo ekzemplar i shumëzuar elektronik i ndonjë dokumenti konkret elektronik konsiderohet si origjinal.

(2) Dokument elektronik i krijuar me digitalizim të dokumentit burimor forma fillostarte e të cilat nuk është elektronike, konsiderohet si kopje e dokumentit origjinal.

(3) Kur dokumenti elektronik është i riprodhuar në formë të letrës konsiderohet si kopje e dokumentit origjinal.

#### **Digjitalizimi i dokumenteve**

#### **Neni 9**

(1) Dokumenti i digjitalizuar ka të njëjtën fuqi juridike dhe dëshmuese sikur dokumenti origjinal, nëse:

1) digjitalizimi i dokumentit është bërë nën mbikëqyrje ose nga ana e:

- personit fizik ose personit të autorizuar që ka krijuar dokumentin që është lëndë e digjitalizimit ose

- personave të cilat janë të autorizuar të menaxhojnë me dokumente në të cilat gjenden nënshkrime, dorëshkrime ose procesverbale, në pajtim me dispozitat nga fusha e punës arkivore dhe në zyrë ose

- personave të cilët janë të autorizuar me ligj ta konfirmojnë dokumentin e digitalizuar dhe

2) autenticiteti i dokumentit të digitalizuar me dokumentin original është e konfirmuar me vulë të kualifikuar elektronike ose nënshkrim të kualifikuar elektronik të personave nga pika 1) të këtij nenit ose personit të cilit i janë transferuar kompetencat në bazë të të cilave është miratuar dokumenti.

#### **Verifikimi i formës së shtypur të dokumentit elektronik**

#### **Neni 10**

Dokumenti elektronik i riprodhuar në cilën do media të shtypit ka fuqinë e njëjtë juridike dhe dëshmuese sikur dokumenti original elektronik, nëse:

1) shumëzimi i dokumentit elektronik është bërë nën mbikëqyrje ose nga ana e personit fizik ose personit të autorizuar të personit juridik që ka krijuar dokumentin dhe

2) shtypja e dokumentit është bërë në mënyrë që autenticiteti i dokumentit elektronik me dokumentin e shtypur vërtetohet me nënshkrim me dorë të personit fizik ose personit të autorizuar të personit juridik.

### **III. IDENTIFIKIMI ELEKTRONIK**

#### **1. Skema për identifikim elektronik**

#### **Kushte që duhet t'i plotësojnë skemat për identifikim elektronik**

#### **Neni 11**

Skemat për identifikim elektronik duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1) të përfshijnë vërtetim për të dhënat për identifikimin e personave të cilëve u janë lëshuar mjete për identifikim elektronik, të cilët në mënyrë unike e përcaktojnë personin juridik ose fizik;

2) të garantojnë siguri që lëshuesi i mjetit për identifikimin elektronik siguron të dhëna identifikuase në kuadër të mjeteve për identifikim elektronik që korrespondojnë me personin të cilat i është lëshuar mjeti për identifikim elektronik;

3) t'i plotësojnë kushtet për nivelin e sigurisë në të cilin është klasifikuar skema për identifikim elektronik, nga neni 13 i këtij ligji.

#### **Pajtimi për identifikim**

#### **Neni 12**

Procedura për lëshim të identifikimit elektronik ngrihet me kërkeshë paraprake të personit fizik ose personit juridik i cili është subjekt i identifikimit pranë lëshuesit të mjetit për identifikim elektronik përvëç nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.

#### **Nivele të sigurisë së skemave për identifikim elektronik**

#### **Neni 13**

Skemat për identifikim elektronik janë të klasifikuara sipas nivelit të sigurisë së mjeteve për identifikim elektronik të cilat janë të lëshuara në kuadër të asaj skeme edhe atë:

1) nivel i ulët i sigurisë siguron shkallë të kufizuar të sigurisë së identitetit të kërkuar ose të konfirmuar të personit dhe karakterizohet me udhëzim drejt specifikimeve, standardeve dhe procedurave përkatëse teknike, duke përfshirë edhe kontolle teknike, qëllimi i të cilave është zgogëlim i rrezikut nga keqpërdorimi ose ndryshimi i identitetit;

2) nivel i konsiderueshëm i sigurisë siguron shkallë të konsiderueshme të sigurisë së identitetit të kërkuar ose të konfirmuar të personit dhe karakterizohet me udhëzim drejt

specifikimeve, standardeve dhe procedurave përkatëse teknike, duke përfshirë edhe kontolle teknike, qëllimi i të cilave është zvogëlim i rrezikut nga keqpërdorimi ose ndryshimi i identitetit dhe

3) nivel i lartë i sigurisë siguron shkallë më të lartë të sigurisë së identitetit të kërkuar ose të konfirmuar të personit se sa mjetet për identifikim elektronik me nivel të sigurisë "konsiderueshëm" dhe karakterizohet me udhëzim drejt specifikimeve, standardeve dhe procedurave përkatëse teknike, duke përfshirë edhe kontolle teknike, qëllimi i të cilave është zvogëlim i rrezikut nga keqpërdorimi ose ndryshimi i identitetit. Regjistri për dhënësit e shërbimeve konfidenciale dhe të skemave për identifikim elektronik

#### Neni 14

(1) Dhënësi i shërbimeve konfidenciale në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dorëzon kërkesë për regjistrim në Regjistrin e dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe të skemave për identifikim elektronik (në tekstin e mëtejmë Regjistri), të cilin e udhëheq Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Në Regjistër detyrimisht regjistrohen skemat për identifikim elektronik të cilat i përdorin organet publike.

(3) Në Regjistër pas kërkesës së dorëzuar paraprakisht nga ana e organit publik ose personit privat juridik mund të regjistrohen edhe skema për identifikim elektronik që janë krijuar nga organet publike dhe skema të cilat kanë krijuar nga persona juridikë private.

(4) Skemat e krijuara nga organet publike regjistrohen në Regjistër në bazë të vendimit për regjistrim të dorëzuar nga ana e ministrit të Shoqërisë Informatike dhe Administratës, e pas kërkesës së parashtruar paraprake për regjistrimin e skemës nga ana e organit publik.

(5) Skemat e krijuara nga persona privatë juridikë detyrimisht duhet t'i përshtaten nivelin të lartë për siguri që të regjistrohen në Regjistër.

(6) Regjistri nga paragrafi 1 i këtij neni në veçanti i përmban këto informata për dhënësin e konfidenciale shërbimit konfidential:

- emrin e personit juridik,
- informata për kontakt siç janë: adresa, numri i telefonit dhe posta elektronike,
- lloji i shërbimeve që i siguron lëshuesilëshuesi i skemës për identifikim elektronik
- mjetet për identifikim elektronik të cilat shfrytëzohen në kuadër të skemës dhe
- niveli i sigurisë.

(7) Në Regjistër regjistrohen edhe dhënësit e shërbimit të kualifikuar konfidential.

(8) Dhënësit e shërbimeve konfidenciale dhe skemave të identifikimit elektronik mund të shlyhen nga Regjistri, nëse:

- ndërpresin plotësimin e kushteve përçaktuara me këtë ligj;

- nuk mënjanohen mangësitë e këtij ligji pas sugjerimit paraprak për mënjanimin e mangësive në afatin e paraparë me vendimin për mënjanimin e parregullsive të lëshuar në pajtim me këtë ligj, ose

- në raste të tjera të përcaktuara me ligjin për shlyerjen e personave juridikë nga evidenca e organit kompetent.

(9) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës e përcaktion përbajtjen dhe mënyrën e menaxhimit të Regjistrit nga paragrafi 1 i këtij nemi, si dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës për regjistrim, dokumentacionin e nevojshëm si shjojcë e kërkesës, formularin e kërkesës dhe mënyrën e publikimit të të dhënave nga Regjistri, varësisht nga lloji i besueshmërisë së shërbimit.

#### Përdorimi i skemave për identifikim elektronik në tregtinë elektronike dhe komunikimin me organ publik

##### Neni 15

(1) Për identifikim elektronik të personit i cili e udhëheq procedurën para organit publik, detyrimisht përdoret skema e identifikimit elektronik që është e regjistruar në Regjistrin e nenit 14 të këtij ligji (në tekstin e mëtejmë; skema e regjistruar për identifikim elektronik).

(2) Për identifikim elektronik të personave që marrin veprime lidhur me aktivitetet e sektorit privat, duke përfshirë edhe tregtinë elektronike, me dëshirë personale mund të përdoret edhe skema e regjistruar ose skema për identifikim elektronik e cila është e regjistruar në Regjistrin e nenit 14 të këtij ligji.

#### Përgjegjësi për dëmin nga përdorimi i skemave të regjistruarar për identifikim elektronik

##### Neni 16

(1) Lëshuesi i skemës së regjistruar për identifikim elektronik është përgjegjës për dëmin i cili mund të shkaktohet për shkak të asaj që skema nuk i plotëson kushtet e këtij ligji.

(2) Dëmi i shkaktuar si pasojë e procedurës së zbatuar gabimisht për validim është përgjegjësia e palës që e udhëheq procedurën, nëse dëmi është shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia.

(3) Bara për dëshmimin e dëmit të shkaktuar është në anën e personit që ka theksuar kërkimin e kompensimit të dëmit.

(4) Lëshuesi i paragrafit (1) të këtij neni është i obliguar të jetë i siguruar nga dëmi eventual që mund të shkaktohet.

(5) Shumë më të ulët të sigurimit nga dëmi eventual i shkaktuar nga lëshuesi do ta përcaktojë ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

#### Kërkesë për përcaktimin e plotësimit të kushteve për nivelet e sigurisë së skemave

##### Neni 17

(1) Kërkesë për përcaktimin e plotësimit të kushteve për nivelet e sigurisë të skemave është shtojeë që i bashkëngjitet kërkesës në Regjistrin e nenit 14 të këtij ligji.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban këto informata:

1) mënyra e dëshmimit dhe verifikimit të identitetit të personit fizik ose juridik që kërkon lëshimin e mjetit për identifikim elektronik;

2) mënyra e lëshimit të mjeteve për identifikim elektronik;

3) mekanizmat për autentikim, përmes të cilës personi fizik ose juridik, duke pëdorur edhe mjetet e identifikimit, e përcaktton identitetin e vet për palën e prekur;

4) kushtet që duhet t'i plotësojnë pjesëmarrësit tjerë të kyçur në procedurë për lëshimin e mjeteve për identifikim elektronik;

5) karakteristikat teknike dhe të sigurisë së mjeteve për identifikim elektronik që lëshohen në kuadër të skemës;

6) masat teknike dhe të organizimit të cilat i plotëson lëshuesi i mjeteve për identifikim elektronik me qëllim të sigurimit të interoperabilitetit të skemave për identifikim elektronik në pajtim me standarde nationale dhe ndërkombëtare në këtë sferë;

7) raporti për nivelin e sigurisë së skemës për identifikim elektronik nga trupi për vlerësimin e përputhjes dhe

8) të dhëna për lëshuesin e skemës për identifikim elektronik.

## Kushte të sigurisë që duhet t'i plotësojnë lëshuesilëshuesit e skemave pér identifikim elektronik

### Neni 18

(1) Lëshuesi i skemës pér identifikim elektronik është i obliguar t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme teknike, fiziqe dhe organizuese pér ballafaqim me rreziqet të cilat do të mundeshin ta rrezikonin sigurimin e këtyre shërbimeve në mënyrë të sigurt.

(2) Matat teknike, fizike dhe të organizimit duhet të sigurojnë që niveli i sigurisë së rrezikut është niveli i parashikuar i sigurisë së skemës pér identifikim elektronik, duke pasur parasysh zgjidhje më të reja teknologjike, në veçanti masat pér pengimin e incidenteve të sigurisë dhe pér përkufizimin e efekteve të dëmshme të incidenteve të mundshme, si dhe pér informimin e palëve të prekura nga efektet e padëshiruara të incidenteve të sigurisë.

(3) Procedurat dhe standartet pér plotësimin e masave teknike, fizike dhe organizuese pér sigurinë e skemave pér identifikim elektronik i përcaktion ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(4) Vlerësimin e nivelit të sigurisë në skemën e identifikimit elektronik e vlerëson trupi pér vlerësim të përputhshmërisë e cila është e akredituar të kryejë certifikimin sipas standardeve, të përcaktuara në aktin nënligor nga paragrafi (3) të këtij nenit.

2. Bashkëpunimi tejkufitar në sferën e identifikimit elektronik

### Interoperabiliteti i sistemeve teknike

### Neni 19

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës bashkëpunon me institucione kompetente ndërkombëtare pér çështje lidhur me interoperabilitetin ndërkufitar të skemave pér identifikim elektronik dhe ndërmerr masa në kuadër të kompetencave të veta me qëllim të përcaktimit të nivelit më të lartë të interoperabilitetit të skemave pér identifikim elektronik të nivelit nacional, me qëllim të integrimit të tyre dhe interoperabilitetit në skemat e pranuara ndërkombëtarisht pér identifikim elektronik.

### Regjistrimi i skemave pér identifikim elektronik të lëshuara nga persona të huaj juridikë

### Neni 20

(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës mund të regjistrojë në Regjistrin e dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe të skemave pér identifikim elektronik edhe persona të huaj juridik që janë të regjistruar në nivel të Bashkimit Evropian ose të vendeve anëtare të unionit, ndërsa i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligji.

(2) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës mund të regjistrojë në Regjistër edhe skema pér identifikim elektronik të cilat përshtaten në nivelin e lartë të sigurisë, nëse ajo skemë shfrytëzohet nga ana e vendit anëtar të Bashkimit Evropian.

## IV SHËRBIME KONFIDENCIALE

### 1. Dispozita të përgjithshme pér shërbime konfidenciale

#### Lloji i shërbimeve konfidenciale

### Neni 21

(1) Shërbimet konfidenciale janë shërbime të cilat janë të përcaktuara si konfidenciale konfidenciale në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Shërbime konfidenciale të kualifikuara janë:

1) dhënia e certifikatave të kualifikimit pér nënshkrim elektronik;

2) dhënia e certifikatave të kualifikimit pér vulë elektronike;

3) dhënia e certifikatave të kualifikuara pér autenticitetin e ueb faqeve;

4) shërbimi i kualifikuar konfidencial i ruajtjes së nënshkrimeve të kualifikuara elektronike;

5) shërbimi i kualifikuar konfidencial i ruajtjes së vulës së kualifikuar elektronike;

6) validimi i kualifikuar i nënshkrimit të kualifikuar elektronik;

7) validimi i kualifikuar i vulës së kualifikuar elektronike;

8) shërbimi i kualifikuar konfidencial i lëshimit të vulës së kualifikuar elektronike;

9) shërbimi i kualifikuar konfidencial i dorëzimit të rekomanduar elektronik dhe

10) shërbimi i kualifikuar konfidencial pér depozitim elektronik të dokumenteve.

(3) Dhënësi i shërbimit elektronik ose dhënësi i shërbimit të kualifikuar elektronik mund të sigurojë një ose më shumë shërbime të cekura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

#### Përgjegjësia e dhënësve të shërbimeve konfidenciale

### Neni 22

(1) Dhënësi i shërbimit konfidencial është përgjegjës pér mbrojtjen e cila është shkaktuar si pasojë e mosveprimit më pajtim me këtë ligj, nëse dëmi është shkaktuar me qëllim ose nga pakujdesia.

(2) Barra e dëshmimit të qëllimit ose pakujdesia e dhënësit të shërbimit konfidencial është pér personin fizik ose juridik i cili kërkon kompensim të dëmit nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Kur dhënësi i shërbimit konfidencial në mënyrë përkatëse dhe paraprakisht i informon shfrytëzesit e shërbimeve konfidenciale lidhur me përfkufizimet pér përdorimin e shërbimeve konfidenciale të cilat i sigurojnë edhe kur këto sigurime janë të njoitura pér palën e tretë, dhënësit e shërbimeve konfidenciale nuk janë përgjegjës pér dëmin i cili del nga shfrytëzimi i shërbimeve të cilët i tejkalojnë përfkufizimet e cekura.

(4) Dhënësi i kualifikimeve të shërbimeve konfidenciale duhet të jetë i siguruar nga dëmi ose të sigurojë mjete financiare në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj të cilat vlejnë si përgjegjësi e dëmit nga përdorimi i skemave pér identifikim elektronik.

#### Përgjegjësia e shfrytëzesve të shërbimeve konfidenciale

### Neni 23

Shfrytëzesi i shërbimeve konfidenciale është i obliguar t'i ruajë mjetet dhe të dhënat pér lëshimin e nënshkrimit elektronik ose vulës nga qasja e paautorizuar dhe përdorimi dhe është i obliguar t'ë njëjtat t'i shfrytëzojë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

#### Kushtet që duhet t'i përbushin dhënësit e shërbimeve konfidenciale

### Neni 24

(1) Dhënësi i shërbimeve të pakualifikuara konfidenciale, është i obliguar ta informojë Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës pér kryerjen e veprimitarës më së voni në afat prej 15 ditësh llogaritur nga dita e fillimit të kryerjes së veprimitarës.

(2) Dhënësi i shërbimit të pakualifikuar konfidencial është i obliguar që në njoftim, krahas të dhënavë themelore pér personin juridik, t'i theksojë edhe llojin e shërbimeve, standartet teknike të cilat i zbaton dhe deklaratë se do t'i respektojë kushtet pér kryerjen e veprimitarës.

(3) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës i regjistrin në Regjistrin e shërbimeve konfidenciale dhe dhënësi i shërbimeve të pakualifikuara të paragrafit (2) të këtij neni, në bazë të njoftimit të dorëzuar nëse i njëjtë i përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni.

(4) Dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar para se të fillojë ta kryejë veprimtarinë e vet eshtë i obliguar të dorëzojë kërkesë të përcaktuar në nenin 17 të këtij ligji për regjistrim në Regjistrin e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(5) Dhënësi i shërbimeve konfidenciale eshtë i obliguar t'i ndërmarrë masat e nevojshme teknike dhe organizuese për menaxhim me rreziqe që do të mund ta rrezikon sigurinë gjatë sigurimit të shërbimeve konfidenciale.

(6) Masat teknike dhe organizative sigurojnë që niveli i sigurisë të përshtatet në shkallën e rrezikut, duke pasur parasysh zgjidhjet më të reja të arritshme teknologjike.

(7) Dhënësi i shërbimit konfidencial, pa prolongim dhe më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i kuptimit, do ta lajmërojë organin kompetent për çfarëdo çrrregullimi të sigurisë dhe zvogëlim të integritetit të shërbimit që kanë ndikim të konsiderueshëm mbi sigurinë e shërbimeve konfidenciale ose mbrojtjen e të dhënavë personale që i përpunojnë në kuadër të sigurimit të shërbimit.

(8) Në rast kur çrrregullimi i sigurisë eshtë i lidhur me mbrojtjen e të dhënavë personale, dhënësi i shërbimit konfidencial e informon edhe organin kompetent për mbrojtjen e të dhënavë personale.

(9) Nëse çrrregullimi i sigurisë ose humbja e integritetit të shërbimeve konfidenciale mund të ndikojë negativisht te shfrytëzuesit e shërbimeve konfidenciale, dhënësi i shërbimit konfidencial eshtë i obliguar menjëherë, më së voni në afat prej 24 orëve ta informojë shfrytëzuesin e shërbimit konfidencial.

(10) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës e informon opinionin, direkt ose me kërkesë të dhënësit të shërbimit konfidencial që ta bëjë të njëjtë, nëse e konfirmon se çrrregullimi i sigurisë ose humbja e integritetit të shërbimeve konfidenciale eshtë i rrezikuar interesit publik.

(11) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës bashkëpunon me institucionet kompetente ndërkombëtare lidhur me shkëmbimin e informatave për sigurinë dhe integritetin e shërbimeve konfidenciale në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **Kompetenca e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për shërbime konfidenciale dhe skema për identifikim elektronik**

##### **Neni 25**

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në pajtim me këtë ligj i kryen këto detyra:

1) mban Regjistër të dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe të skemave për identifikim elektronik;

2) i përcjellë rekondimet e raporteve për kontrollin dhe plotësimin e kushteve për sigurimin e shërbimit konfidencial të kualifikuar;

3) kryen mbikëqyrje mbi punën e dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe lëshuesve të skemave për identifikim elektronik;

4) inicon mbikëqyrje para trupit për vlerësimin e përputhshmërisë mbi dhënësin e shërbimeve konfidenciale;

5) zbaton kontroll të jashtëzakonshëm të plotësimit të kushteve për sigurimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuar dhe skema, në pajtim me ligjin;

6) bashkëpunon me organin kompetent për mbrojtjen e të dhënavë personale dhe e informon pa shtyje nëse e kupton se dhënësi i shërbimeve konfidenciale nuk i respekton dispozitat e mbrojtjes së të dhënavë personale;

7) e konfirmon ekzistimin dh zbatimin e rregullt të planeve për ndërprerjen e kryerjes së veprimtarisë të dhënësit të shërbimeve konfidenciale, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën të dhënat i dhanë ose i ka marrë do të janë të arritshme me qëllim të sigurimit të vazhdimesisë së shërbimeve ose të shërbjejë si provë në procedurë gjyqësore;

8) bashkëpunon me organet e supervizionit të Komisionit Evropian.

#### **Kompetenca të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës në suaza të bashkëpunimit tejkufitar**

##### **Neni 26**

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në suaza të bashkëpunimit tejkufitar dorëzon raporte në Komisionin Evropian për aktivitetet e veta në pajtim me rregullativën eIDas, duke filluar nga data e hyrjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut si shtet në kuadër të organeve kompetente në nivel të Bashkimit Evropian ose pas aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

#### **Trupi kompetent për akreditim**

##### **Neni 27**

(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me mendim paraprak të Institutit për Akreditim të Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton metodologji për akreditim të trupave për vlerësim të përputhshmërisë dhe laboratorë për testimin e mjeteve që i përfshinë edhe standartet e përcaktuara nga ana e ministrit për Shoqëri Informatike dhe Administratë.

(2) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës mban listë të trupave të akredituar për vlerësimin e përputhshmërisë dhe laboratorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Akreditimi i kryer nga ana e organit kompetent për akreditim nga vendi anëtar i Bashkimit Evropian pranonet edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

2. Dispozita të përgjithshme për shërbime konfidenciale të kualifikuar

#### **Vendosja e raportit ndërmjet dhënësit të shërbimit konfidencial të kualifikuar dhe shfrytëzuesve**

##### **Neni 28**

(1) Shërbimi konfidencial i kualifikuar sigurohet në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet dhënësit të shërbimit konfidencial të kualifikuar dhe shfrytëzuesit të njëjtës, marrëveshje e cila nënshkruehet me kërkesë paraprake nga ana e shfrytëzuesit.

(2) Dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar, para lidhjes së marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij neni, në mënyrë të qartë dhe të padykuptimtë e informon personin i cili e dorëzon kërkesën për shfrytëzimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikua për të gjitha rr Ethanat e rendësishme që kanë të bëjnë me shfrytëzuesit e shërbimit, në veçanti për:

1) dispozitat dhe rregullat lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikua;

2) çfarëdo kufizime për shfrytëzimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikua dhe

3) masat që duhet t'i ndërmarrë shfrytëzuesi i shërbimeve konfidenciale të kualifikua dhe teknologjia e nevojshme për shfrytëzimin e sigurt të shërbimeve konfidenciale të kualifikua.

## Kushte për sigurimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara

### Neni 29

(1) Dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar duhet t'i plotësojë kushtet si vijonë:

1) të ketë persona të punësuar të cilët posedojnë profesionalizëm, përvojë dhe kualifikime për zbatimin e procedurave administrative dhe menaxhuese, të cilat i plotësojnë standartet vendase dhe ndërkontrollare dhe të cilët kanë kaluar trajnim në sferën e sigurisë së informatikës;

2) të jetë i siguruar nga përgjegjësia profesionale për dëmin ose të ketë mjete financiare të siguruara për kompensim të dëmit të shkaktuar si rezultat të sigurimit të shërbimeve konfidenciale të kualifikuara;

3) të shfrytëzojë sisteme të sigurta dhe prodhime të cilat janë të mbrojtura nga ndryshimet e paautorizuara dhe garantonjë siguri teknike dhe konfidencë në proceset që i përkrahin;

4) të shfrytëzojë sisteme të sigurta për depozitimin e të dhënavë që i janë besuar, ashtu që të dhënët duhet të jenë në formë e cila duhet të verifikohet si vijon:

- se të dhënët do të jenë publikisht të arritshme vetëm me pëlqim paraprak nga personi për të cilin kanë të bëjnë këto të dhëna,

- se vetëm persona të autorizuar mund të bëjnë regjistrimin ose ndryshimin e të dhënavë të ruajtura,

- se të dhënët e ruajtura mund t'i nënshtronen kontrollit për autenticitet.

5) të ndërmarrë masa kundër falsifikimit, vjedhjes ose qasjes së paautorizuar në të dhëna;

6) t'i ruajë dhe të ketë mundësi t'i bëjë të arritshme në periudhë përkatëse kohore, madje edhe pas ndërprerjes së kryerjes së veprimtarisë, të gjitha informata relevante të lidhura me të dhënët të cilat janë krijuar ose të zbatuara nga ana e dhënësit të shërbimeve konfidenciale të kualifikuara, në veçanti për sigurimin e provave në procedurë gjyqësore dhe me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve. Depozitimi i këtyre të dhënavë mund t'i bëhet në formë elektronike;

7) të ruajë baza të të dhënavës në kohë, të sakta dhe të mbrojtura mirë për certifikatat e lëshuara elektronike të kualifikuara, nëse dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar jep certifikata;

8) të azhurnohet plani për ndërprerjen e kryerjes së veprimtarisë me të cilën sigurohet vazhdimësi në sigurimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara për shfrytëzuesit e tyre;

9) të ndërmarrë masa teknike dhe organizuese përpunimin e të dhënavë personale në pajtim me ligjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar eshtë i obliguar t'i miratojë këto akte:

1) kushte të përgjithshme për sigurimin e shërbimeve të cilat janë të arritshme;

2) procedura dhe etapa të cilat dhënësi i shërbimeve konfidenciale të kualifikuara i shfrytëzon që të sigurohet dhënia e shërbimeve në pajtim me dispozitat dhe kushtet e përgjithshme të përmendura në pikën 1) të këtij paragrafi.

(3) Kusht për kryerjen e veprimtarisë së shërbimit konfidencial të kualifikuar eshtë regjistrimi në Regjistrin e shërbimeve konfidenciale dhe skema për identifikim elektronik.

## Sigurimi nga përgjegjësia profesionale

### Neni 30

Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës e përcakton shumë minimale ose llojin e mbulimit të sigurimit nga rreziku nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga ana e dhënësit të shërbimit konfidencial të kualifikuar.

## Identifikimi i shfrytëzuesit të shërbimeve konfidenciale të kualifikuara

### Neni 31

(1) Dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar i verifikon të dhënët për personin fizik ose juridik para lëshimit të certifikatës së kualifikuar, në pajtim me ligjin.

(2) Kontrollin e të dhënavë nga paragrafi 1 i këtij nenii dhënësi i shërbimeve konfidenciale të kualifikuara e kryen direkt ose përmes personit të autorizuar në pajtim me ligjin, në këtë mënyrë:

1) përmes pranisë personale të personit fizik ose të përfaqësuesit të autorizuar të personit juridik ose

2) nga largësia, duke përdorur mjete për identifikim elektronik, për të cilat para lëshimit të certifikatës së kualifikuar eshtë siguruar prania fizike e personave fizikë ose të përfaqësuesit të autorizuar në personin juridik dhe që i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji lidhur me nivelin e sigurisë së skemës për identifikim elektronik të përshtatura për "konsiderueshëm" ose "lartë" ose

3) përmes certifikatës për nënshkrim të kualifikuar elektronik ose përvull elektronike të lëshuar në pajtim me pikën 1) ose 2) të këtij paragrafi ose

4) Përmes përdorimit të metodave tjera për identifikim, të pranuara në nivel nacional, që sigurojnë siguri të barabartë në kuptimin e besueshmërisë së pranisë fizike. Trupi për vlerësimin e përputhshmërisë e vërteton nivelin e barabartë të sigurisë;

5) me mënyrën e identifikimit, të përdorur në vendin anëtar të Bashkimit Evropian.

(3) Në rast të ndryshimit të të dhënavë nga paragrafi 1 i këtij nenii, personi fizik ose juridik eshtë i obliguar pa shtyrje, ndërsa më së voni në afat prej shtatë ditëve duke llogaritur nga dita e ndryshimit, ta informojë dhënësin e shërbimit të kualifikuar për ndryshimin e shkaktuar.

(4) Për identifikimin dhe shfrytëzimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara, dhënësi i shërbimit konfidencial të kualifikuar mund të kryejë verifikim duke e shfrytëzuar sistemin e vet ose ta integrojë sistemin e vet në mënyrë interoperabile për shkak të verifikimit në distancë, regjistra për persona juridikë ose persona të tjerë, kur të ketë nevojë.

## Vlerësimi i kushteve për sigurimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara

### Neni 32

(1) Vlerësimi i përbushjes së kushteve për sigurimin e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara kryen trupi për vlerësimin të përputhshmërisë.

(2) Trupi për vlerësimin të përputhshmërisë eshtë kompetent për kryerjen e kontrolleve të përputhshmëri edhe për dhënësit e shërbimit të pakualifikuar konfidencial, me iniciativë paraprake të Ministritës së Shoqërisë Informatike dhe Administratës ose me kërkesë të dhënësit të shërbimit.

(3) Pas kryerjes së vlerësimit të përbushjes së kérkesave, trupi për vlerësimin të përputhshmërisë eshtë i detyruar të përgatisë raport për vlerësimin të përputhshmërisë.

(4) Vlerësimi i përputhshmërisë detyrimisht kryhet para fillimit të veprimtarisë së dhënësit të shërbimit të kualifikuar, si dhe të paktën një herë në çdo 24 muaj, për çdo dhënës të shërbimeve konfidenciale.

(5) Pas rapportit të përgatitur për vlerësimin e kryer të përputhshmërisë së kérkesave ose dhënësit të shërbimit të besuar të kualifikuar, trupi për vlerësimin të përputhshmërisë reportin e dorëzon te Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës menjëherë kurse më së voni në afat prej tri ditësh pune.

(6) Ministria mund tē kérkojë rivlerësim urgjent tē pérputhshmërisë nëse ekzistojnë parregullsi në sigurimin e shërbimeve konfidenciale tē kualifikuara ose nëse ka ndodhur incident i cili në masë tē konsiderueshme e ka rrezikuar ose prishur sigurinë e informacioneve.

(7) Cmimi i vlerësimit tē pérputhshmërisë, duke pérfsirë rivlerësimin pér raste urgjente, janë në barrë tē dhënësit tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar.

(8) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratë e përcakton listën e standardeve që duhet tē plotësohen nga ana e trupit pér vlerësim tē pérputhshmërisë, përbajtjen e nevojshme tē raportit tē vlerësimit tē pérputhshmërisë, procedurën pér vlerësimin e harmonizimit me kérkesat, si dhe listë tē personave juridikë tē autorizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose në shtetet anëtare tē Bashkimit Evropian që mund tē kryejnë vlerësim tē pérputhshmërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### **Procedura pér regjistrim tē dhënësit tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar në Regjistër**

#### **Neni 33**

(1) Personi juridik që ka pér qëllim tē sigurojë shërbime konfidenciale tē kualifikuar, paraqet kérkesë tē Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës pér regjistrim në Regjistër, para se tē fillojë tē kryejë veprimitari dhënës i shërbimit tē kualifikuar konfidenciale.

(2) Në shtojcë tē kérkesës nga paragrafi 1 tē këtij neni, personi juridik i dorëzon edhe materialet e theksuara si informacione në kérkesë, duke pérfsirë raportin e vlerësimit te pérputhshmërisë në pajtim me nenin 32 tē këtij ligji.

(3) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administrata miraton aktvendim pér regjistrimin e aplikuesit në Regjistër, me te cilin dhënësit tē shërbimit konfidencial i jetet status i dhënësit tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit tē kérkesës, nëse e njëjtë është térështet dhe në përputhje me konstatimet e përbajtura në raportin e vlerësimit tē pérputhshmërisë.

(4) Me pérjashtim nga paragrafi (3) tē këtij neni, kur janë tē domosdoshme kontolle shtesë ose sigurim i provave shtesë pér tē cilat është e nevojshme periudhë më e gjatë, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës do ta vazhdojë afatin pér miratimin e aktvendimit pér regjistrim në Regjistër jo më gjatë se 60 ditë nga afati i përcaktuar në paragrafin (3) tē këtij neni.

(5) Gjatë vendimmarjes, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës mund tē kérkojë dorëzimin e dëshmive shtesë si dhe zbatimin e kontrolleve shtesë tē masave teknike dhe organizative dhe kontroll tē kapaciteteve tē sigurisë së aplikuesit dhe tē shërbimeve, në pajtim me ligjin.

(6) Nëse aplikuesi ose shërbimet e theksuara në kérkesë nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara me këtë ligj, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës miraton vendim pér refuzimin e kérkesës pér regjistrim në regjistër pas kalimit tē afatit tē përcaktuar në paragrafin (3) ose paragrafit (4) tē këtij neni.

### **Ndërprerja e kryerjes së veprimitarisë së dhënësit tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar**

#### **Neni 34**

(1) Dhënësi i shërbimit konfidencial tē kualifikuar i cili ka pér qëllim tē ndërpresë kryerjen e kësaj veprimitarie, është i detyruar t'i njoftojë shfrytëzuesit e shërbimeve konfidenciale tē kualifikuar dhe Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, më së voni se tre muaj para përfundimit tē planifikuar tē kryerjes së veprimitarisë.

(2) Dhënësi i shërbimit tē kualifikuar që do ta ndërpresë kryerjen e kësaj veprimitarie, është i detyruar tē sigurojë ofrues tjetër tē shërbimeve konfidenciale tē kualifikuar i cili do tē vazhdojë t'i kryejë këto shërbime pér shfrytëzuesin e shërbimeve tē kualifikuar konfidenciale dhe pér masat e ndërmarrë menjëherë, respektivisht deri sa rrjedh afati i përcaktuar në paragrafin (1) tē këtij neni do ta njoftojë Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(3) Dhënësi i shërbimit tē kualifikuar konfidencial është i detyruar ta paraqesë dokumentacionin e plotë dhe tē gjitha mjetet e nevojshme teknike në pajtim me ligjin në lidhje me sigurimin e shërbimeve nga ana e dhënësit tjetër tē kualifikuar tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar ndaj tē cilët e bart detyrimin pér kryerjen e një ose më shumë shërbimeve konfidenciale.

(4) Nëse dhënësi i shërbimit tē kualifikuar konfidencial nuk vepron në pajtim me detyrimin e përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 tē këtij neni, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës do tē kérkojë nga dhënësi i shërbimit tē kualifikuar tē dorëzojë dokumentacionin e plotë dhe pajisjet, duke pérfsirë procedurat pér veprim me tē njëjtat. (5) Ministria pérkohësish do t'i ruaj dokumentacionin dhe pajisjet, deri në sigurimin e dhënësit tjetër tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar me tē cilët do tē vazhdojë kryerjen e këtyre shërbime pér kontabilitet, pér kryerjen e këtyre shërbime pér shfrytëzuesit, pér llogari tē dhënësit tē shërbimit tē kualifikuar konfidencial i cili pushon ta kryejë këtë veprimitari.

(6) Mënyrën dhe procedurën pér ruajtjen e dokumentacionit dhe pajisjes, i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(7) Në rast tē ndalimit tē pérkohshëm tē kryerjes së veprimitarisë, dhënësi i shërbimit konfidencial, certifikatat e kualifikuar tē lëshuara para ditës së hyrjes në fuqi të ndalesës, mbeten në vlefshmëri.

### **Lista e dhënësve tē shërbimeve tē kualifikuar konfidenciale**

#### **Neni 35**

(1) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës e publikon listën e dhënësve tē shërbimeve konfidenciale tē kualifikuar si dhe listë tē shërbimeve tē kualifikuar konfidenciale që i sigurojnë në ueb faqen e tyre në formë elektronike tē përshtatshme pér pëpunim automatik.

(2) Lista nga paragrafi 1 tē këtij neni është e nënshkruar me nënshkrim elektronik ose vuloset me vulë elektronike tē Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(3) Të dhënat në listën e dhënësve tē shërbimeve tē kualifikuar konfidenciale rrjedhin nga Regjistri i dhënësve tē shërbimeve konfidenciale dhe tē skemave pér identifikim elektronik, si dhe tē dhënavet tē marra me shfrytëzimin e mjeteve automatike.

(4) Formën dhe mënyrën e publikimit tē listës nga paragrafi 1 tē këtij neni e përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

### **Shenja pér konfidencë tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar**

#### **Neni 36**

(1) Shenja pér konfidencë tē shërbimit konfidencial tē kualifikuar (në tekstin e mëtejmë: si shenjë pér konfidencë) është shenjë që është e thjeshtë, e identifikueshme dhe qartë sugjeron në shërbimin konfidencial tē kualifikuar, forma e secilës, përbajtja dhe logoja e tē cilave përcaktohen nga paragrafi (3) tē këtij neni.

(2) Dhënesit e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara kanë të drejtë të përdorin shenjën për konfidencë për shërbime konfidenciale të kualifikuara për të cilën janë të regjistruar dhe janë të detyruar ta lidhin me listën e dhënesve të kualifikuar të shërbimeve konfidenciale.

(3) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës përcakton formën, strukturën, madhësinë dhe logon e shenjës për konfidencë të shërbimit konfidencial të kualifikuar.

### Njoftje tejkufitarë e dhënesve të shërbimeve konfidenciale

#### Neni 37

(1) Dhënesit të shërbimit konfidencial të regjistruar me seli në shtet të huaj do t'i njihet statusi i dhënesit të shërbimeve konfidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nëse është regjistruar në Regjistrin e dhënesve të shërbimeve konfidenciale dhe skemave të identifikimit elektronik.

(2) Dhënesit e shërbimeve konfidenciale të cilat janë themeluar nga shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe të regjistruar në Listën e shërbimeve konfidenciale të Bashkimit Evropian mund të punojnë dhe të sigurojnë shërbime në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa regjistrim paraprak në Regjistrin e dhënesve të shërbimeve konfidenciale dhe skemave për identifikim elektronik.

(3) Dhënesit e shërbimeve konfidenciale të kualifikuara të regjistruara me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilat janë të regjistruara në Regjistrin e dhënesve të shërbimeve konfidenciale të kualifikuara janë siguruar nga ana e dhënesve të shërbimeve konfidenciale të kualifikuar të siguruara nga ana e dhënesit të kualifikuar konfidenciale të themeluar në Bashkimin Evropian, në bazë të marrëveshjes së lidhur paraprake mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bashkimit Evropian.

(4) Me marrëveshjen e theksuar në paragrafin 3 të këtij nenii në veçanti garantonhet se:

(a) kërkuesat e aplikueshme për dhënesit të shërbimeve konfidenciale të kualifikuar të themeluara në Bashkimin Evropian dhe për shërbime të kualifikuar konfidenciale që ata i sigurojnë janë plotësuar nga ana e dhënesit të shërbimeve konfidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

(b) shërbimet e kualifikuar konfidenciale të siguruara nga ana e dhënesve të kualifikuar të shërbimeve konfidenciale të themeluara në Bashkimin Evropian, të pranuara si juridikisht ekuivalente të siguruara nga ana e shërbimeve konfidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

### V. NËNSHKRIMI ELEKTRONIK DHE VULA ELEKTRONIKE

#### 1. Nënshkrimi elektronik i avancuar

### Kushtet të cilat duhet t'i plotësojë nënshkrimi elektronik i avancuar

#### Neni 38

Nënshkrimi elektronik i avancuar duhet:

- 1) të jetë në mënyrë unike e lidhur me nënshkruasin;
- 2) të mundësojë identifikimin e nënshkruesit;
- 3) të jetë i krijuar me të dhëna për krijimin e një nënshkrimi elektronik që nënshkruesi, me nivel të lartë të konfidencës, mund t'i shfrytëzojë vetëm nën kontrollin e tij;

- 4) të jetë i lidhur me të dhënat e nënshkruara në mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mëvonshëm i tyre është e dukshëm.

### 2. Vula elektronike e avancuar

### Kushtet të cilat duhet t'i plotësojë vula elektronike e avancuar

#### Neni 39

Vula elektronike e avancuar duhet:

- 1) të jetë në mënyrë unike e lidhur me krijuesin e vulës;
- 2) të mundësojë identifikimin të krijuesit të vulës;
- 3) të jetë e krijuar me të dhënat për krijimin e nënshkrimit elektronik që krijuesi i vulës, me nivel të lartë të konfidencës, mund t'i shfrytëzojë vetëm nën kontrollin e tij;

- 4) të jetë i lidhur me të dhënat që i mbyllë në mënyrë të tillë që çdo ndryshim i mëvonshëm dhe e njëjtë është e dukshme.

### 3. Përbajtja e certifikatës së kualifikuar për nënshkrim elektronik dhe vulë

#### Neni 40

(1) Standardet që duhet t'i përbajnjë certifikatat e kualifikuar për nënshkrimin elektronik dhe përvulë elektronike i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Përveç standardeve nga paragrafi (1) të këtij neni, të cilat duhet të përfshijnë certifikatet e kualifikuar për nënshkrim elektronik dhe përvulë elektronike, mund të përbajnjë të dhëna shtesë që nuk do të ndikojnë në interoperabilitetit dhe njohjen e nënshkrimit të kualifikuar elektronik dhe të vulës të kualifikuar elektronike.

### Fuqia juridike dhe provuese e certifikatave të kualifikuar për nënshkrim elektronik dhe vulë

#### Neni 41

Certifikatat e kualifikuar për nënshkrimin elektronik dhe vulë të lëshuara nga dhënesit e kualifikuar të shërbimeve konfidenciale kanë të njëjtën forcë ligjore dëshmuese si dokumentet publike.

### Heqja ose pezullimi i certifikatës së kualifikuar elektronike për nënshkrim elektronik përvulë elektronike dhe përvulë autenticitetin në ueb faqe e internetit

#### Neni 42

(1) Dhënesi i shërbimit konfidencial të kualifikuar i cili lëshon certifikatën e kualifikuar për nënshkrim elektronik, përvulë elektronike dhe përvulë autenticitetin në ueb faqe, është i detyruar ta heqë certifikatën e kualifikuar të lëshuar nëse:

- 1) pronari i certifikatës për nënshkrimin elektronik të kualifikuar, përvulën elektronike ose autenticitetin në ueb faqe dorëzon kërkës për heqjen e certifikatës;

- 2) pronari i certifikatës e humb aftësinë e tij afariste ose ka pushuar së ekzistuar ose kanë ndryshuar rrethanat që ndikojnë në vlefshmërinë e certifikatës;

- 3) konstaton se mungojë të dhëna në certifikatë;

- 4) konstaton se të dhënat për krijimin e nënshkrimi elektronik të kualifikuar, përvulë të kualifikuar elektronike ose përvulë autenticitetin në ueb faqe ose sistemin e dhënesit të shërbimit konfidencial të kualifikuar është komprometuar në mënyrë që ndikon në sigurinë dhe konfidencën e certifikatave;

- 5) konstaton se të dhënat për krijimin e nënshkrimi elektronik, përvulë elektronike ose përvulë autenticitetin e ueb faqe ose sistemi nëpërmjet të cilës kryhet transaksion elektronik janë të eksposuar në rrezik, në mënyrë që ndikon në sigurinë dhe nënshkrimit elektronik, vulës elektronike ose ueb faqes dhe

- 6) ndodh pushim i personit juridik në kushte të përcaktua me ligj.

(2) Dhënesi i shërbimit konfidencial i cili e lëshon certifikatën për nënshkrim elektronik, vulë elektronike ose për autenticitet e ueb faqes e njofton shfrytëzuesin e shërbimit të kualifikuar të besuar për heqjen e certifikatës në afat prej 24 orëve nga marrja e kërkesës ose nga ndodhja e rrethanave të cilat janë bazë për heqjen e certifikatës.

(3) Nëse certifikata e kualifikuat për nënshkrimit të kualifikuar elektronik, për vulë elektronike ose për autenticitetin e ueb faqes së internetit përfundon pas lëshimit fillestar, atëherë e humb vlefshmërinë nga momenti i përfundimit dhe statusit të certifikatës së kualifikuar nuk mund të kthehet në asnjë rrethanë.

(4) Dhënesit e shërbimeve të kualifikuara konfidenciale të cilët lëshojnë certifikata të kualifikuara për secilën palë të prekur sigurojnë informacione për vlefshmërinë, suspenzionin ose heqjen e certifikatave të kualifikuara të lëshuara.

(5) Informacionet nga paragrafi 4 i këtij nenii vihen në dispozicion të secilës prej palëve të prekura të paktën për certifikatët individuale, në çdo kohë dhe pas skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tyre, në mënyrë automatike që është e sigurt, efikase dhe pa kompensim.

(6) Shfrytëzuesi i shërbimit të kualifikuar konfidencial është i detyruar të kërkojë anulimin e certifikatës së lëshuar për nënshkrinin elektronik të kualifikuar, për vulë të kualifikuar elektronike dhe për autenticitetin e ueb faqes së internetit nga botuesi i saj në rast të humbjes, dëmtimit ose rezikut të integritetit të të dhënave të certifikatës, ose nëse ndodh ndryshim në të dhënat për krijimin e certifikatave.

(7) Në rastin e suspenzionit të certifikatës për nënshkrimit të kualifikuar elektronik, për vulë elektronike dhe për autenticitetin e ueb faqes së internetit, i njëjtë e humb vlefshmërinë për kohëzgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së suspenzionit.

(8) Informacionet për suspenzion dhe kohëzgjatja për nënshkrimin elektronik të certifikatës së kualifikuar, për vulë elektronike ose për autenticitetin e ueb faqes ose për heqjen e të njëjtave do të futen në bazën e të dhënave të certifikatave të kualifikuara të lëshuara nga dhënesi ikonfidencial i kualifikuar besueshmë dhe të njëjtat do të janë të dukshme gjatë kontrollit të statusin të vlefshmërisë së certifikatës elektronike të kualifikuar.

#### **Evidencia e certifikatave të lëshuara dhe të anuluara për nënshkrim elektronik të kualifikuar, për vulë elektronike dhe për autenticitetin në ueb faqen e internetit**

##### **Neni 43**

(1) Lëshuesi i certifikatave të kualifikuara për nënshkrim elektronik, për vulë elektronike ose për autenticitet të ueb faqes së internetit, është i detyruar të ruaj dokumentacionin e plotë për certifikatat e kualifikuara të lëshuara dhe hequra për nënshkrimin elektronik, vulë elektronike ose për autenticitetin e ueb faqes, si dhe mjete për identifikimin dhe verifikimin elektronik në procedurat administrative, juridike dhe të tjera, së paku dhjetë vite pas skadimit të periudhës për të cilën është lëshuar certifikata ose pas heqjes së saj.

(2) Detyrimi nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë edhe me suspenzioni e certifikatave të kualifikuara për nënshkrim elektronik, për vulë elektronike ose autenticitet të ueb faqes.

(3) Të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të ruhen në formë elektronike.

#### **Mjetet për krijimin e nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulës së kualifikuar elektronike**

##### **Neni 44**

Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës i përcakton standartet teknike që duhet të përbushen, si dhe mënyrën e krijimit të nënshkrimeve të kualifikuara elektronike ose vulave të kualifikuara elektronike nga dhënesit e shërbimeve të kualifikuara konfidenciale.

#### **Përputhshmëria e mjeteve për krijim të nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulë elektronike të kualifikuar**

##### **Neni 45**

(1) Vlerësim i përbushjes së standardeve teknike në lidhje me mjetet për lëshimin e nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike kryen laboratori i akredituar.

(2) Laboratori lëshon certifikatën e përputhshmërisë me mjetet për krijimin e nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike dhe për të njëjtin njofton Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në afat prej shtatë ditësh, llogaritet nga dita e lëshimit të certifikatës për mjete.

(3) Standartet teknike që duhet të plotësohen, ndërsa të cilat i nënshtron vlerësimi i përbushjes së kërkesave teknike nga trupi i autorizuar përcaktohen me aktin e miratuar në bazë të nenit 44 të këtij ligji.

(4) Ministria mban listë të mjeteve për krijimin e nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulës elektronike të kualifikuar, në bazë të të dhënave të marra nga certifikatat nga laboratori.

(5) Laboratori pa prolongim, ndërsa më së voni në afat prej shtatë ditëve nga dita e ndryshimit të bërë është i detyruar ta njoftojë Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për lëshimin ose marrjen e vërtetimit përshtatshmëri të mjeteve për krijimin e nënshkrimeve të kualifikuara elektronike dhe vulave të kualifikuara elektronike .

(6) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës përcakton përbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së listës nga paragrafi 4 i këtij neni, mënyrën e paraqitjes së kërkesës për regjistrim në listë, dokumentet e nevojshme me kërkesën, si dhe mënyrën e regjistrimit në listë.

(7) Përbajtja e vërtetimit përshtatshmëri të mjeteve për krijimin e nënshkrimeve të kualifikuara elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike dhe mënyrën e lëshimit të tij e përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(8) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilat janë të kualifikuara në laboratorët e akredituar në vend-anëtar të Bashkimit Evropian njihen dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4. Shërbimi i kualifikuar konfidencial për vlefshmëri të nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulës elektronike të kualifikuar

#### **Vlefshmëria e nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulës elektronike të kualifikuar**

##### **Neni 46**

(1) Procesi i vlefshmërisë së nënshkrimit të kualifikuar elektronik ose vulës elektronike të kualifikuar zbatohet me qëllim që të përcaktohet:

1) nëse certifikata që ka të bëjë me nënshkrim ose vulë të kualifikuar elektronike në kohën e nënshkrimit ose krijimit e vulës paraqet certifikatë elektronike të kualifikuar;

2) нёсе certifikata e kualifikuar ёштë лешуар nga dhënës i shërbimeve të kualifikua konfidenciale dhe ka qenë i vlefshëm në kohën e nënskrimit ose vulosjes;

3) нёсе të dhënat e vlefshmërisë të nënskrimit ose vulës janë të përshtatshme me të dhënat e dhëna të palës së prekur;

4) нёсе përmbledhja e vetme e të dhënave në certifikatën e kualifikuar që përfaqëson nënskruesin ose krijesin e vulës që i ёштë dhënë palës së prekur janë të sakta;

5) нёсе нё rast të shfrytëzimit të pseudonimit në kohën e nënskrimit ose vulosjes e njëjtë ёштë e qartë në palën e prekur,

6) нёсе nënskrimi elektronik ose vula elektronike ёштë krijuar me mjetet për krijimt të një nënskrimi elektronik të kualifikuar ose vulës elektronike të kualifikuar;

7) нёсе integriteti i të dhënave që ёштë nënskruar apo vulosur nuk ёштë komprometuar;

8) нёсе i plotësojnë kushtet e parashikuara me nenet 38 dhe 39 të këtij ligji në kohën e nënskrimit ose vulosjes.

(2) Sistemi që përdoret për vlefshmëri të nënskrimit të kualifikuar elektronik ose nënskrim elektronik të palës së prekur dhe e siguron rezultatin e saktë të procesit të vlefshmërisë dhe mundëson identifikimin e të gjitha problemeve me kuptim të sigurisë.

#### **Kushte për sigurim të shërbimit të kualifikuar për vlefshmërinë e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulë elektronike e kualifikuar**

##### **Neni 47**

(1) Shërbimi i kualifikuar për vlefshmërinë e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulës të kualifikuar elektronike mund të sigurohet vetëm nga dhënësi i kualifikuar i shërbimeve konfidenciale dhe atë:

1) procesi për vlefshmëri të nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulës të kualifikuar elektronike ёштë zbatuar në pajtueshmëri me nenin 46 të këtij ligji;

2) palës së prekur i mundëson të marrë vërtetim nga procesi i vlefshmërisë në mënyrë të automatizuar, e cila ёштë e sigurt dhe efikase;

3) se vërtetimi nga procesi i vlefshmërisë nga pikë 2) e këtij paragrafi ёштë vulosur me vulë elektronike të avancuar ose të nënskruar me nënskrim elektronik të avancuar nga dhënësi konfidencial i kualifikuar i shërbimit.

(2) vërtetimi për vlefshmëri të nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulës të kualifikuar elektronike të leshuar nga dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial ka forcë të njëjtë juridike dhe dëshmuese si dokument publik.

(3) Standartet që duhet të përbajnë vërtetimet për vlefshmëri të nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulës së kualifikuar elektronike i përcakton Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

5. Shërbimi i kualifikuar konfidencial për ruajtjen e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike

#### **Kushtet për sigurimi të shërbimit të kualifikuar konfidencial për ruajtjen e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike**

##### **Neni 48**

(1) Shërbimi i kualifikuar konfidencial për ruajtjen e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulave të kualifikuara elektronike mund të sigurohet vetëm nga dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial që përdor procedurat dhe teknologjitet e posaçme për të vazhduar konfidencën e nënskrimit të kualifikuar elektronik ose

vulës të kualifikuar elektronike dhe pas kalimit të periudhës e vlefshmërisë të siguruar nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknologjike.

(2) Standartet që duhet të përbajnë vërtetim për vlefshmëri të nënskrimit të kualifikuar elektronik ose vulës së kualifikuar elektronike i përcakton Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

#### **Veprimi juridik i nënskrimit elektronik**

##### **Neni 49**

(1) Nuk mund të kontestohet forca dëshmuese e nënskrimit elektronik vetë për shkak se përdoret në formë elektronike ose sepse i plotëson kushtet për nënskrim elektronik të kualifikuar.

(2) Nënskrimi i kualifikuar elektronik ka të njëjtë fuqi juridike dhe dëshmuese si nënskrimi me dorë.

#### **Veprimi juridik i nënskrimit elektronik**

##### **Neni 50**

(1) Nuk mund të kontestohet forca dëshmuese e nënskrimit elektronik vetëm për shkak se përdoret në formë elektronike ose për shkak se i plotëson kushtet për nënskrimin elektronik të kualifikuar.

(2) Vula elektronike e kualifikuar ёштë bazë për prezumimin e integritetit të të dhënave dhe për saktësinë e origjinës së të dhënave me të cilat ёштë lidhur.

#### **6. Vula elektronike kohore**

#### **Kushtet që duhet t'i plotësojë vula e kualifikuar elektronike kohore**

##### **Neni 51**

(1) Vula e kualifikuar elektronike kohore i plotëson kushtet në vijim:

1) i lidhë datën dhe kohën me të dhënat në mënyrë të tillë që në mënyrë të arsyeshme mund të supozohet se mundësia e të dhënave të ndryshohen në mënyrë të pavërejtur ёштë përjashtuar;

2) bazohet në burim të saktë për kohën e lidhur me standard ndërkombe të përcaktuar për kohë;

3) ёштë vulosur me vulë elektronike të përparuar ose ёштë nënskruar me nënskrim elektronik të përparuar nga dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial.

(2) Standartet që duhet t'i plotësojnë vlat e kualifikua elektronike kohore përcaktohen nga Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

#### **Veprimi juridik i vulave elektronike kohore**

##### **Neni 52**

(1) Nuk mund të kontestohet forca dëshmuese e nënskrimit elektronik vetëm për shkak se përdoret në forme elektronike ose për shkak se i plotëson kushtet për vulën e kualifikuar elektronike kohore.

(2) Vula e kualifikuar elektronike kohore ёштë baza për prezumimin e saktësisë së datës dhe kohës që janë shënuar, si dhe integritetin e të dhënave për të cilat lidhet data dhe koha.

(3) Certifikata e kualifikuar për vulë elektronike kohore e leshuar nga dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial do të ketë të njëjtën forcë juridike dhe dëshmuese si dokument publik.

#### **7. Dorëzimi elektronik**

#### **Kushtet për kryerjen e dorëzimit të kualifikuar elektronik të rekomanduar**

##### **Neni 53**

(1) Dorëzimi elektronik i kualifikuar i rekomanduar i përbush kushtet në vijim:

1) тे сигуруhet непërmjet një ose më shumë dhënsve të shërbimeve të kualifikuara konfidenciale;

2) те сигуруjë nivel të lartë të sigurisë për identifikimin e dërguesit;

3) те сигуруjë identifikimin e marrësit përpara dërgimit të të dhënavë;

4) те garantojë siguri në procesin e dërgimit dhe pranimit të të dhënavë nепërmjet përdorimit të nënshkrimi elektronik të avancuar ose vulës elektronike të avancuar të dhënsit të shërbimit të kualifikuara konfidencial në mënyrë të tillë që të parandalojë mundësinë e ndryshimeve eventuale të të dhënavë që mbeten pa u vënë re;

5) те сигуруjë shkëmbim konfidencial të të dhënavë që janë të përshtatshme për qëllimin e dërgimit dhe pranimit të të dhënavë, nепërmjet të cilave mund të identifikohet qartë dërguesi i të dhënavë;

6) те garantojë siguri që koha dhe data e dërgimit, marrjes dhe ndryshimeve të mundshme të të dhënavë të tregohen qartë me përdorimin e vulës elektronike kohore;

7) те garantojë siguri që kushtet janë përbushur individualisht për secilin dhënes të shërbimeve për dorëzimin rekomandues elektronik në rastet kur të dhënat transmetohen ndërmjet dy ose më shumë dhënsive të shërbimeve për dorëzimin rekomandues elektronik.

(2) Standardet që i përbajnjë vërtetimet për dorëzimin rekomandues elektronik i përcakton Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

### Veprimi juridik i dërgimit të rekomanduar elektronik

#### Neni 54

(1) Nuk mund të kontestohet forca dëshmuese e të dhënavë të dërguara ose të pranuara nепërmjet dërgimit të rekomanduar elektronik vetëm pasi që janë në formë elektronike ose pasi që i plotësojnë kushtet për dërgim të rekomanduar elektronik të klasifikuar.

(2) Shfrytëzimi i dërgimit të klasifikuar elektronik të rekomanduar për pranimin ose dërgimin e të dhënavës eshtë bazë për prezumimin e integritetit të atyre të dhënavë, dërgimin e të njëjtave nga dërguesi i përcaktuar, pranimin e tyre nga pranuesi i përcaktuar, si dhe saktësinë e datës dhe kohës së dërgimit dhe pranimit të atyre të dhënavë të shënuara nga dhënesi i shërbimit dërgim të rekomanduar elektronik të klasifikuar.

(3) Vërtetimi për dërgimin e rekomanduar elektronik të klasifikuar i dhëne nga dhënesi i shërbimit të klasifikuar konfidencial ka forcën e njëjtë juridike dhe dëshmuese si dokument publik.

#### 8. Kontrolli i autenticitetit të ueb faqeve

### Certifikata e klasifikuar për autenticitet të ueb faqeve

#### Neni 55

Standardet të cilat duhet t'i plotësojë certifikata e klasifikuar për autenticitet të ueb faqeve i përcakton ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

### Forca juridike dhe dëshmuese e certifikatës së klasifikuar për autenticitet të ueb faqeve

#### Neni 56

Certifikata e klasifikuar për autenticitet të ueb faqeve e dhëne nga dhënesi i shërbimit të klasifikuar konfidencial ka forcën e njëjtë juridike dhe dëshmuese si dokument publik.

#### 9. Magazinimi elektronik i dokumenteve

### Përgatitja e dokumenteve për magazinim

#### Neni 57

(1) Përgatitja e dokumenteve për magazinim elektronik ka të bëjë me:

1) dokumente të cilat në mënyrë parimore janë krijuar në formë elektronike të përshtatshme për magazinim elektronik;

2) konversionin e dokumentit elektronik në formë të ndryshme të përshtatshme për magazinim elektronik;

3) digitalizimin i dokumenteve të krijuara në mënyrë burimore në formë e cila nuk është elektronike, e përshtatshme për magazinim elektronik.

(2) Në dokumentin e përgatitur për magazinim elektronik, mund të përfshihen edhe meta të dhëna, sipas zgjedhjes së personit i cili kryen përgatitjen e dokumenteve për magazinim elektronik ose për shkak të nevojave të vet procesit.

### Përgatitja e dokumenteve për magazinimin e sigurt elektronik dhe magazinimin e klasifikuar elektronik në mënyrë të sigurt

#### Neni 58

(1) Gjatë përgatitjes së dokumenteve për magazinimin e sigurt elektronik duhet të plotësohen këto kushte:

1) të garantojë siguri se të gjitha elementet themelore të përbajtjes së dokumentit original janë bartur në mënyrë të besueshme në dokumentin e përgatitur për magazinim elektronik, duke i marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e dokumentit, përkatesisht të rruhet integriteti i përbajtjes së dokumentit;

2) të garantojë siguri se do të rruhet përdorimi i dokumentit original;

3) të garantojë siguri se janë përfshirë të gjitha elementet e përbajtjes së dokumentit original që janë me rëndësi për autenticitetin e tij;

4) të garantojë siguri për integritetin e dokumentit original, si dhe për shtojcat e tij, në mënyrë që janë përdorur nënshkrimi elektronik ose vula dhe vula elektronike kohore;

5) të zbatojë kontroll të saktësisë dhe kualitetit gjatë procesit të konversionit, me qëllim që të mënjanohen çfarë do lloj gabimesh të cilat do të mund të shkaktohen nga ky proces;

6) të siguropet se për aktivitetet e ndërmarra në përgatitjen e dokumenteve për magazinim të sigurt elektronik mbahet evidencë e rregullt.

(2) Nëse afati i përcaktuar për ruajtjen e dokumenteve në pajtim me ligj eshtë më i gjatë se pesë vjet, atëherë dokumenti i përgatitur për magazinimin e sigurt elektronik duhet të jetë në format i cili eshtë i përshtatshëm përruajtje afatgjate.

(3) Përgatitja e dokumenteve për magazinimin elektronik të klasifikuar në mënyrë të sigurt duhet:

1) të garantojë siguri se të gjitha elementet themelore të përbajtjes së dokumentit original janë bartur në mënyrë të besueshme në dokumentin e përgatitur për magazinim elektronik, duke i marrë parasysh natyrën dhe qëllimin e dokumentit, përkatesisht të rruhet integriteti i përbajtjes së dokumentit;

2) të garantojë siguri se do të rruhet përdorimi i dokumentit original;

3) të garantojë siguri se janë përfshirë të gjitha elementet e përbajtjes së dokumentit original që janë me rëndësi për autenticitetin e tij;

4) të garantojë siguri se për integritetin e dokumentit original, si dhe për shtojcat e tij, janë përdorur nënshkrimi elektronik i klasifikuar ose vula elektronike e klasifikuar dhe vula elektronike kohore e klasifikuar;

5) të zbatojë kontroll të saktësisë dhe kualitetit gjatë procesit të konversionit, me qëllim që të mënjanohen çfarë do lloj gabime të cilat do të mund të shkaktohen nga ky proces;

6) të siguropet se për aktivitetet e ndërmarra në përgatitjen e dokumenteve për magazinim të sigurt elektronik mbahet evidencë e rregullt.

(4) Нёсе афати i пëрсактuar përruajtjen e dokumenteve në pajtim me ligj është me vlerë të përhershme, atëherë dokumenti i përgatitur për magazinimin elektronik të kualifikuar në mënyrë të sigurt duhet të jetë në format i cili është i përshtatshëm përruajtje afatgjate.

(5) Qeveria, me propozim të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës i përcakton kushtet më të afërtë për përgatitjen e dokumenteve për magazinimin elektronik dhe magazinim të kualifikuar elektronik dhe formatet e dokumenteve të cilat janë të përshtatshme për magazinim.

### **Magazinimi i sigurt elektronik dhe magazinimi i klasifikuar elektronik i sigurt i dokumenteve**

#### **Neni 59**

(1) Magazinim i sigurt elektronik i dokumenteve që në formën e tyre origjinale përbajnjë nënshkrim elektronik ose vulë, kurse me qëllim të vërtetohet integriteti dhe origjina e këtyre dokumenteve, duhet të përgatiten në mënyrë që gjatë kohës së magazinimit të tyre shfrytëzohen procedura të vendosura dhe zgjidhje teknologjike.

(2) Rruajtje elektronike e sigurt e dokumenteve të përgatitura në pajtim me nenin 58 të këtij ligji, në të cilin është vendosur nënshkrim ose vulë elektronike dhe vulë elektronike kohore në mënyrën e përcaktuar në nenin 58 paragrafin 1 pikën 4) të këtij ligji, me qëllim që të vërtetohet integriteti i dokumentit original, si dhe shtojcat e tij, bëhet në mënyrë që gjatë procedurës për magazinim shfrytëzohen zgjidhje teknologjike të vendosura.

(3) Magazinim i sigurt elektronik i klasifikuar i dokumenteve që në formën e tyre origjinale përbajnjë nënshkrim elektronik të klasifikuar ose vulë elektronike të klasifikuar, kurse me qëllim të vërtetohet integriteti dhe origjina e këtyre dokumenteve, duhet të përgatiten në mënyrë që gjatë kohës së magazinimit të tyre shfrytëzohen procedura të vendosura dhe zgjidhje teknologjike.

(4) Rruajtje e sigurt elektronike e dokumenteve të përgatitura në pajtim me nenin 58 të këtij ligji, në të cilin është vendosur nënshkrim i klasifikuar elektronik ose vulë e klasifikuar elektronike dhe vulë e klasifikuar elektronike kohore në mënyrën e përcaktuar në nenin 58 paragrafi 2 pikë 4) të këtij ligji, me qëllim që të vërtetohet integriteti i dokumentit original, si dhe shtojcat e tij.

(5) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës përcakton metodologji përzbatimin e procedurave dhe zgjidhjeve teknologjike.

### **Shërbime për magazinim elektronik dhe magazinim elektronik të klasifikuar të dokumenteve**

#### **Neni 60**

(1) Shërbime për magazinim elektronik të dokumenteve i siguron dhënës i shërbimeve konfidenciale, i cili ka marrë masa përkatëse teknike dhe organizative nëpërmjet së cilave garanton siguri të magazinimit elektronik të dokumenteve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Dhënësi i shërbimeve për magazinim elektronik të dokumenteve mund të kufizohet në magazinimin e dokumenteve të cilat në formën e tyre origjinale përbajnjë nënshkrim elektronik ose vulë.

(3) Për dokument i cili ruhet në korniza të shërbimeve të magazinimit elektronik të dokumenteve ekziston supozim për autenticitet të dokumentit original, për të cilin dhënësi i shërbimit të magazinimit elektronik të dokumenteve lëshon certifikatë përkatëse, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(4) Nëse dokumenti është ruajtur me shfrytëzimin e shërbimeve për magazinim elektronik të dokumenteve, kështu që periudha e magazinimit është më e gjatë nga periudha e përcaktuar e ruajtjes së dokumentit original në

pajtim me rregullat nga sfera e punës arkivore, atëherë dokumenti original mund të asgjësohet, përvèç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj.

(5) Shërbime për magazinim të klasifikuar elektronik të dokumenteve i siguron dhënës i shërbimit të klasifikuar konfidencial, i cili ka marrë masa përkatëse teknike dhe organizative nëpërmjet të cilave garanton siguri të magazinimit elektronik të klasifikuar të dokumenteve, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(6) Dhënësi i shërbimeve për magazinim të klasifikuar elektronik të dokumenteve mund të kufizohet në magazinimin e dokumenteve në të cilat forma e tyre origjinale përmban nënshkrim elektronik të klasifikuar ose vulë elektronike të klasifikuar.

(7) Për dokument i cili ruhet në korniza të shërbimeve të magazinimit të klasifikuar elektronik të dokumenteve, në qarkullimin e drejtë konsiderohet autentik me dokumentin original, për të cilin dhënësi i shërbimit magazinim i klasifikuar elektronik i dokumenteve lëshon certifikatë përkatëse, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(8) Nëse dokumenti është ruajtur me shfrytëzimin e shërbimeve për magazinim të klasifikuar elektronik të dokumenteve, kështu që periudha e magazinimit është më e gjatë se periudha e përcaktuar e ruajtjes së dokumentit original, atëherë dokumenti original mund të asgjësohet, përvèç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj.

(9) Ministri për Shoqëri Informatike dhe Administratë i përcakton standartet për magazinim elektronik dhe magazinim të klasifikuar elektronik të dokumenteve.

### **VI. AUTORIZIME ELEKTRONIKE**

#### **Registri i autorizimeve**

##### **Neni 61**

(1) Për autorizim të të drejtave në formë elektronike nëpërmjet të të autorizuarit para çdo personi të tretë, dhënësi i autorizimit mund të autorizojë të autorizuar nëpërmjet regjistrat elektronik të autorizimeve.

(2) Autorizimi jepet me shfrytëzimin e identifikimit elektronik të dhënësit të autorizimit dhe me nënshkrimin e autorizimit me nënshkrim të klasifikuar elektronik.

(3) Dhënësi i autorizimit i përcakton veprimtaritë për të cilat i lëshon autorizimin, vëllimin dhe afatin e vlefshmërisë së tij.

(4) Dhënësi i shërbimit të klasifikuar konfidencial përlëshim të certifikatës së klasifikuar për nënshkrim elektronik i cili e ka lëshuar certifikatën e klasifikuar për nënshkrim elektronik të dhënësit të autorizimit e mban Regjistri i autorizimeve.

(5) Personat nga paragrafi 4 të këtij neni e vërtetojnë çdo shkresë në regjistër me vulë të klasifikuar elektronike dhe vulë të klasifikuar elektronike kohore.

(6) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës e përcakton përbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrat dhe kontrollin e vlefshmërisë së autorizimeve.

#### **Forma me shkrim**

##### **Neni 62**

Autorizimet e evidentuara në regjistrin e autorizimeve në pajtim me nenin 61 të këtij ligji kanë të njëjtën fuqi juridike dhe fuqi dëshmuese si forma me shkrim e autorizimeve të verifikuara notare.

#### **Revokimi i autorizimit**

##### **Neni 63**

Revokimi i autorizimit kryhet me deklaratë për revokim të autorizimit, e dhënë në të njëjtën mënyrë dhe nën kushtet e njëjtë si autorizim i regjistruar.

**Mbajtja, rruajtja dhe qasja te registri i autorizimeve**

Neni 64

(1) Regjistri i autorizimeve nuk ka karakter të librit publik.

(2) Dhënësit e autorizimit, personat e autorizuar dhe palët e prekura kanë qasje vetëm në të dhënat që kanë të bëjnë me autorizimin përkatës në lidhje me to. nga Regjistri i autorizimeve të nenit 61 të këtij ligji,

**VI. MBIKËQYRJA****Mbikëqyrja ndaj dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe dhënësve të shërbimit të kualifikuar konfidencial**

Neni 65

(1) Mbikëqyrje ndaj zbatimit të këtij ligji kryejnë nëpunësit administrativë në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, me autorizim paraprak nga ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

(2) Personat e autorizuar nga paragrafi 2 i këtij nenii kryejnë mbikëqyrje ndaj plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë ligi dhe dispozitat e miratuara për zbatimin e këtij ligji.

(3) Formën dhe përbajtjen e procesverbalit dhe të urdhrit kundërvajtës i përcaktion ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

**Vëllimi i autorizimeve për kryerje të mbikëqyrjes**

Neni 66

Personat nga nenii 65 të këtij ligji mund të:

1) urdhërojnë mënjanim të parregullsive me caktim të afatit në të cilat parregullsitë do të mënjanohen;

2) urdhërojnë të ndalohet përdorimi i infrastrukturës jo përkatëse dhe procedurave me caktimin e afatit në të cilin dhënësi i shërbimit konfidencial është i detyruar të sigurojë procedura përkatëse dhe infrastrukturë përkatëse;

3) përkohësisht të ndalohet sigurimi i shërbimeve, deri në momentin e sigurimit të procedurave dhe infrastrukturës përkatëse nga dhënësi i shërbimit konfidencial;

4) urdhërojnë marje të përkohshme të disa ose të gjitha certifikatave të lëshuara nga dhënësi i shërbimit konfidencial, nëse ekziston dyshim i arsyeshëm për veprim jo përkatës ose falsifikim.

**VIII. DISPOZITAT KUNDËRVAJTESE**

Neni 67

(1) Me dënim me para prej 5.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë me denarë do të dënohet dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial - personi juridik, nëse:

1) nuk i merr masat organizuese dhe teknike të nevojshme për menaxhim me rreziqet të cilat e kërcënojnë sigurinë gjatë sigurimit të shërbimeve konfidenciale;

2) pa prolongim, kurse më së voni në afat prej 24 orësh nga momenti i të kuptuarit, nuk e njofton Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për çdo shkelje të sigurisë ose humbje të integritetit shërbime që kanë ndikim të rëndësishëm në sigurimin e shërbimeve konfidenciale ose mbrojtjen e të dhënavë personale të cilat përpunohen në korniza të shërbimeve;

3) gjatë shkeljes së sigurisë ose humbjes së integritetit të shërbimeve, pa prolongim, nuk e njofton shfrytëzuesin e shërbimeve konfidenciale, nëse ekziston kërcënim për sigurinë ose humbjen e integritetit të shërbimeve konfidenciale ose nëse mund të ndikojë negativisht në shfrytëzuesit e shërbimeve konfidenciale;

4) para lidhjes së marrëveshjes nga nenii 28 paragrafi 1 i këtij ligji nuk e njofton personin që e ka parashtruar kërkesën për shfrytëzimin e shërbimeve të kualifikuar konfidenciale për të gjitha rrëthanat relevante që ndikojnë në shërbim në pajtim me nenin 28 paragrafin 2 i këtij ligji;

5) nuk i plotëson kushtet nga nenii 29 i këtij ligji;

6) gjatë lëshimit të certifikatave të kualifikuarë për shërbime konfidenciale, nuk i kontrollon informacionet për identitetin e personit fizik ose juridik të përbajtura në certifikatën e kualifikuar në pajtim me nenin 31 paragrafin 2 të këtij ligji;

7) nuk e kontrollon harmonizimin me kushtet para fillimit të sigurimit të shërbimeve të kualifikuarë në besim ose së paku një herë në çdo 24 muaj;

8) para se të fillojë me kryerjen e veprimitarë dhënës i shërbimit të kualifikuar konfidencial nuk është regjistruar në Regjistrin e dhënësve të shërbimeve konfidenciale dhe në skemat të identifikimit elektronik;

9) i cili ka për qëllim të pushojë të kryejë këtë veprimitari, është i detyruar për qëllimin ta njoftojë çdo shfrytëzues të shërbimeve të kualifikuar konfidenciale dhe Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, më së voni tre muaj para ndërprerjes së planifikuar të veprimitarë;

10) në rast të ndërprerjes së veprimitarë dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial nuk i dorëzon të gjitha mjetet e nevojshme teknike në lidhje me sigurimin e shërbimeve për dhënës tjetër të shërbimit të kualifikuar konfidencial ndaj të cilit e bart detyrimin për kryerje të një ose më shumë shërbimeve konfidenciale ose te Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë;

11) në rast të ndërprerjes së veprimitarë dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial nuk e dorëzon të gjithë dokumentacionin dhe pajisjen e në lidhje me sigurimin e shërbimeve për dhënës tjetër të shërbimit të kualifikuar konfidencial ndaj të cilit e bart detyrimin për kryerje të një ose më shumë shërbimeve konfidenciale ose te Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë;

12) certifikatat për nënshkrim ose vulë të kualifikuar elektronike nuk i përmbanë të gjitha të dhënat e theksuara në nenin 47 paragrafin 1 të këtij ligji;

13) dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial përlëshimin e certifikatave për nënshkrim ose vulë të kualifikuar elektronike nuk i revokon certifikatat e lëshuara në rastet e theksuara në nenin 42 paragrafin 1 të këtij ligji;

14) dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial përlëshimin e certifikatave për nënshkrimin ose vulë të kualifikuar elektronike nuk i njofton shfrytëzuesit e shërbimeve të kualifikuar konfidenciale për anulimin e certifikatës në afat prej 24 orësh nga pranimi i njoftimit ose paraqitja e rrëthanave për të cilat revokohet certifikata;

15) dhënësi i shërbimit të kualifikuar konfidencial përlëshimin e certifikatave për nënshkrim ose vulë të kualifikuar elektronike nuk e ruan dokumentacionin e plotë për certifikatat e lëshuara dhe të revokuara për nënshkrimin ose vulën e kualifikuar elektronike, si dhe mjetet për identifikimin dhe verifikimin elektronik në procedurat administrative, juridike dhe procedura të tjera, së paku dhjetë vjet pas skadimit të vlefshmërisë së certifikatës;

16) magazinimi elektronik i sigurt dhe magazinimi elektronik i kualifikuar i dokumenteve nuk është zbatuar në pajtim me nenin 58 të këtij ligji;

(2) Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i shqiptohet dënim me para nga 1.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë në denarë personit përgjegjës të personi juridik dhënës i shërbimit të kualifikuar konfidencial.

(3) Me dënim me para prej 5.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë në denarë do të dënohet dhënësi i shërbimi të pakualifikuar konfidencial, nëse nuk e njofton Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për kryerjen e veprimitarë, në pajtim me nenin 24 të këtij ligji.

(2) Пër кundërvajtjen nga paragrafi 3 i këtij neni do t'i shqiptohet dënim me para nga 1,000 deri në 5,000 euro në kundërvlerë në denarë personit përgjegjës te personi juridik dhënës i shërbimit të pakualifikuar konfidencial.

#### Neni 68

(5) Ndihami juridike primare jep klinika ligjore në pajtim me programin për arsim, të miratuar nga ana e fakultetit juridik, kurse me qëllim të realizimit të mësimdhënies praktike për studentët e fakultetit juridik. Gjatë dhënës së ndihmës juridike primare, klinika ligjore bashkëpunon me avokatët e regjistruar në Regjistrin avokatëve, si dhe me Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Ministri i Drejtësisë e përcakton mënyrën e bashkëpunimit nga paragrafi (5) të këtij neni pas mendimit paraprak të Ministrit së Arsimit dhe Shkencës dhe Odës së Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

##### KREU II.

#### TË DREJTA DHE OBLIGIME TË PJESËMARRËSVE NË PROCEDURËN PËR NDIHMË JURIDIKE PRIMARE

##### Neni 8

Obligime të dhënës së ndihmës juridike primare

(1) Dhënësit janë të obliguar të jatin ndihmë juridike primare dhe të bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Gjatë dhënës së ndihmës juridike primare nga paragrafi (1) i këtij neni, dhënësi e informon personin e interesuar për të drejtat dhe obligimet e shfrytëzuesve të ndihmës juridike falas dhe për procedurën për realizim të ndihmës juridike primare dhe dytësore, pa asnjë kopësim.

(3) Dhënësi ka për obligim personit t'i ndihmojë ta plotësojë kërkuesën për ndihmë dytësore juridike si dhe deklaratën për gjendjen e tij pronësore dhe gjendjen financiare të anëtarëve të familjes së vet, me të cilën parashtron ato dokumente të cilat vetëm personi i posedon dhe mund t'i sigurojë, ndërsa që kanë të bëjnë me çështjen juridike për zgjidhjen e të cilës kerkohet ndihmë juridike. Ministria me detyrë zyrtare i siguron edhe të gjitha dokumentet e nevojshme perj institucioneve kompetente.

(4) Нë bazë të takimit të parë me personin dhe dokumentacionin e përgjithshëm të siguruar, dhënësi më së voni në afat prej dy ditëve prej takimit do të përpilojë mendim të shkurtër me shkrim për lëndën të cilin do ta bashkëngjitet me shkresat dhe do ta kompletojë kërkesën për ndihmë dytësore juridike.

(5) Shoqata ose klinika ligjore në afat prej katër ditëve nga pranimi i kërkesës, të njëjtën e parashtron në seksionin rajonal të Ministrisë që gjendet në rajonin në të cilin personi ka vendbanim ose vendqëndrime.

(6) Dhënësit mbajnë evidencë për ndihmën juridike primare që e kanë dhënë.

(7) Shoqata për të dhënat që kanë të bëjnë me ndihmën juridike primare që është dhënë është e detyruar të parashtrojë raporte mujore në Ministrinë. Klinika ligjore është e obliguar të parashtrojë raporte në çdo gjashtë muaj tek Ministria.

(8) Për ndihmën juridike primare që është dhënë shoqata dhe klinika ligjore kanë të drejtë për kompensim në pajtim me nenin 12 të këtij ligji.

(9) Ministria e Drejtësisë i përcaktion përbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për të dhënat që kanë të bëjnë me ndihmën juridike primare që është dhënë nga paragrafi (6) i këtij neni, si dhe përbajtjen e raporteve nga paragrafi (7) i këtij neni.

#### Neni 9

#### **Përgjegjësia e dhënësve të ndihmës juridike primare**

(1) Nëse është shkaktuar dëm gjatë dhënes së ndihmës juridike primare nga ana e personit të autorizuar zyrtar të Ministrisë (në tekstin e mëtejshmë: personi i autorizuar zyrtar) kompensimi i dëmit bie në barrë të buxhetit të Ministrisë.

(2) Shoqata është përgjegjëse për ndihmën juridike primare që është dhënë.

(3) Nëse është shkaktuar dëm gjatë dhënes së ndihmës juridike primare nga ana e shoqatës, kompensimi i dëmit bie në ngarkim të shoqatës.

(4) Klinika ligjore është përgjegjëse për ndihmën juridike primare që është dhënë.

(5) Nëse është shkaktuar dëm gjatë dhënes së ndihmës juridike primare nga ana e klinikës ligjore, kompensimi i dëmit bie në ngarkim të fakultetit juridik në të cilin si njësi organizative gjendet klinika ligjore.

#### Neni 10

#### **Registrimi dhe shlyerja e dhënësve të ndihmës primare juridike në Regjistr**

(1) Shoqata do të registrohet në Regjistrin e shoqatave të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike primare që e udhëheq Ministria nëse i plotëson këto kushte:

- të jetë i registruar në Regjistrin e shoqatës së Regjistrat qendror të Republikës së Maqedonisë më së paku pesë (5) vjet para dorëzimit të kërkesës,

- të ketë të punësuar ose angazhuar jurist të diplomuar me provimin e dhënë të jurisprudencës,

- Në statutin e shoqatës si njëra nga qëllimet e themelimit të ceket dhënia e ndihmës primare juridike në sferën në të cilin është themeluar,

- të ketë të lidhur marrëveshje për sigurimin e përgjegjësisë për dëmin e mundshëm gjatë dhënes së ndihmës juridike primare me shumë më të ulët prej 100.000,00 denarë të policës së sigurimit,

- të ketë dorëzuar kërkesa vjetore të tatimit për tre vitet para vitit të miratimit të kërkesës për regjistrim,

- të plotësojë kushte minimale hapësinore dhe kushte teknike të cilat garantojnë sigurim të papenguar të ndihmës primare juridike dhe

- të ketë realizuar më së paku tre projekte për sigurimin e ndihmës juridike ose këshillit juridik.

(2) Shoqata e cila është e interesuar për dhënien e ndihmës juridike primare në Ministri dorëzon kërkesë për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni.

(3) Formën dhe përbajtjen e kërkesës për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni e përcaktion ministri

(4) Klinika ligjore do të regjistrohet në Regjistrin e fakulteteve juridike të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike primare që e mban Ministria, pas dorëzimit të kërkesës për regjistrim, nëse:

- është njësi organizuese e fakultetit juridik në universitetin e themeluar në pajtim me ligjin,

- është në përbërje të universitetit i cili është i radhitur mes shtatë universiteteve të para në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(5) Ministria në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së dorëzuar për regjistrim nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni ka obligim:

- të vlerësojë nëse dhënësi i cili e ka dërguar kërkesën me dokumentet e nevojshme i plotëson kushtet për regjistrim të parapara me paragrafin (1) përkatesisht paragrafin (4) të këtij neni,

- të miratojë aktvendim për regjistrim me të cilin do ta miratojë kërkesën dhe do të kryej regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni ose të miratojë aktvendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën për regjistrim.

(6) Nëse Ministria konfirmon se nuk i janë dorëzuar të gjitha provat e nevojshme për miratimin e aktvendimit për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni, të njëjtat do t'i kërkojë dhënësi në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për regjistrim në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni.

(7) Kërkesa për dorëzimin e të dhënavë plotësuesë e ndërpërt afatin për veprim të Ministrisë të përcaktuar në paragrafin (5) të këtij neni, deri në ditën e pranimit të të dhënavë të kérkuara, në afatin e paragrafit (8) të këtij neni.

(8) Nëse të dhënat e kérkuara nga dhënësi nuk dorëzohen në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për plotësimin e të dhënavë, afati i përcaktuar në paragrafin (5) të këtij neni, vazhdon të rrjedhë dhe në të njëjtën Ministria është e obliguar të miratojë vendim me të cilin do ta refuzojë kérkesën për regjistrimin e dhënësit në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni.

(9) Ministria e mban Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni në formë të shkruar dhe elektronike dhe e publikon dhe azhurnon në ueb faqen e vet në çdo tre muaj.

(10) Ministria me aktvendim do ta shlyejë dhënësin nga Regjistrin, nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) të këtij neni, nëse:

- vërtetohet se gjatë kohës së dhënes ose më së voni një vit pasi që ndihma juridike është dhënë, dhënësi nuk i ka plotësuar obligimet në pajtim me dispozitat e dhëna nga dispozitat e këtij ligji ose

- dhënësi më tej nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (1) përkatesisht paragrafi (4) i këtij neni.

(11) Kundër aktvendimit të Ministrisë me të cilën refuzohet kërkesa për regjistrimin e dhënësit në Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni, si dhe kundër aktvendimit për shlyerjen e dhënësit të Regjistrat mund të ngritet kontest administrative para gjykates kompetente.

(12) Nëse Ministria me aktvendim e shlyen dhënësin nga Regjistrin nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) i këtij neni, gjithashtu mund të ngritet kërkesë të re për regjistrim pas skadimit të 12 muajve nga dita e miratimit të aktvendimit për shlyerje.

(13) Formën, përbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrat nga paragrafi (1) dhe paragrafi (4) të këtij neni e përcaktion ministri.

(14) Kushtet minimale hapësinore dhe teknike nga paragrafi (1) alineja 6 e këtij neni i përcaktion ministri.

## Neni 11

**Financimi i shoqatave dhe klinikave ligjore si dhënës të ndihmës juridike primare**

(1) Mjetet e kompensimit për dhënien e ndihmës juridike primare nga ana e shoqatave të autorizuara dhe klinikave ligjore ndahen në bazë të konkursit publik.

(2) Konkursin publik e publikon Ministria në ueb faqen e vet dhe e njëjtë zgjatë 30 ditë nga dita e publikimit, në tremujorin e parë të vitit rrjedhës, në kuadër të zbatimit të mjeteve të cilat janë për atë dedikim të miratuara në kuadër të buxhetit të Ministrisë për vitin rrjedhës.

(3) Në konkursin publik përmenden: priorititet e konkursit, numri i përgjithshëm i mjeteve të cilat ndahen, dokumentet e nevojshme, afatet për zbatimin e procedurës të konkursit publik, periudha kohore prej së paku një vit në të cilën kryhet dhënia e ndihmës primare juridike, kriteret e vlerësimit të kërkeseve, si dhe llojet e harxhimeve të parapara për dhënien e ndihmës primare juridike të cilat do të ndahen nga Ministria.

(4) Shpalljen dhe realizimin e konkursit publik nga paragrafi (1) i këtij neni, e realizon Komisioni për shpërndarjen e mjeteve nga shoqata të autorizuara dhe klinika ligjore për dhënien e ndihmës primare juridike (në tekstin e mëtejmë: komisioni) i formuar nga ministri i Drejtësisë, që përbëhet nga tre anëtarë dhe zëvendës të tyre nga radhët e të punësuarve të nëpunësve shtetërorë administrativë.

(5) Komisioni në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkeseve i shqyrt俊 kërkesa, përgatit dhe dorëzon mendim për ministrin e Drejtësisë në të cilën është e përmendor rang lista për të gjitha fletëparaqitjet e pranuara.

(6) Gjatë vlerësimit të fletëparaqitjeve do të merren parasysh këto kritere për ndarjen e mjeteve financiare për shoqëritë e paraqitura të autorizuara dhe klinikat ligjore:

- dobi shoqërore nga projekti i propozuar për dhënien e ndihmës juridike përmes qëllimeve të qarta dhe të realizueshme,

- vlerësim i harmonizimit të qëllimeve të projekteve të cilat përbëhen në lehtësimin e qasjes në drejtësi, me priorititet e përcaktuara në konkursin publik si dhe mënyrën në të cilën ndihma e siguruar juridike do të mundësojë realizimin e ndihmës për ata të cilët dedikohen,

- përvoja në sigurimin e ndihmës primare juridike të shoqatave përkatësish klinikave ligjore si dhe personat të cilët e sigurojnë,

- rajonin në të cilin jepet ndihma primare juridike me qëllim të qasjes së barabartë rajonale të ndihmës juridike falas,

- arsyeshmëria dhe lartësia e harxhimeve të parapara për dhënien e ndihmës primare juridike.

(7) Në bazë të mendimit të paragrafit (5) të këtij neni ministri i Drejtësisë miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve në pajtim me konkursin publik.

(8) Kundër aktvendimit të paragrafit (7) të këtij neni mund ngrihet kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(9) Në afat prej 30 ditëve nga plotfuqishmëria e aktvendimit nga paragrafi (7) i këtij neni, ministri i Drejtësisë lidh marrëveshje me shoqatat përkatësish fakultetet juridike në të cilat njësi organizative janë klinikat ligjore me të cilat rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella. Nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes deri në kohëzgjatjen e saj, dhënësve nuk u takon kompensim në pajtim me nenin 12 të këtij ligji.

(10) Në çdo tre muaj dhënësit e paragrafit (9) të këtij neni dorëzojë raport të detajuar narrativ dhe finansiar për aktivitet e realizuara dhe harxhimet e bëra së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar.

(11) Nëse vërtetohet se mjetet e pranuara për dhënien e ndihmës juridike primare i harxon pa dedikim ose ndihmën juridike primare nuk e jep në pajtim me ligjin dhe konkursin publik ose nuk e ka filluar realizimin e punës së caktuar në afatin e paraparë në marrëveshje, Ministria e ndërpret sigurimin e mëtejmë të mjeteve, e prish marrëveshjen dhe në afat prej 30 ditëve ngrë procedurë përkthimin e mjeteve tashmë të ndara në Buxhetin e Ministrisë dhe kompensimin e dëmit.

(12) Mënyrën e shpalljes dhe realizimit të konkursit publik, kontrollin e dokumenteve të dorëzuara, mënyrën e vlerësimit gjatë notimit të kërkesa, kryerjen e kontrollit dhe harxhimin e mjeteve i përcaktion ministri i Drejtësisë.

(13) Shoqatat dhe klinikat ligjore të regjistruara në regjistrin nga neni 10 paragrafët (1) dhe (4) të cilat financohen në pajtim me këtë nen pranojnë kompensim në pajtim me dispozitat e nenit 12 të këtij ligji.

## Neni 12

**Kompensimi i shoqatës dhe klinikës ligjore si dhënës të ndihmës juridike primare**

(1) Shoqata dhe klinika ligjore të cilat nuk financohen në pajtim me nenin 11 të këtij ligji, kanë të drejtë në kompensim për ndihmën juridike primare të dhënë falas për çdo lëndë veçmas për të cilën është lejuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.

(2) Shoqata dhe klinika ligjore kanë të drejtë në kompensim dhe për ndihmën e dhënë juridike të nenit (6) alineja 5 dhe 6 të këtij ligji për këto persona:

- shfrytëzuesit e të drejtës së ndihmës në para të mbrojtjes sociale,

- pranues të pensionit invalidor dhe

- viktima të dhunës në familje dhe të bazuar gjinore.

(3) Kompensimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni llogaritet në bazë të listës së harxhimeve përvëllimin e punës së kryer, në pajtim me Tarifën e kompensimit të harxhimeve për punë të shoqatave dhe klinikave ligjore për dhënien e ndihmës juridike primare.

(4) Ministri e përcakton formularin për listën e harxhimeve dhe tarifën nga paragrafi (3) të këtij neni.

(5) Ministria në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të listës së harxhimeve nga paragrafi (3) të këtij neni, ka për obligim që të njëjtën ta shqyrtojë dhe të miratojë aktvendim me të cilin lejohet ose nuk lejohet pagesa.

(6) Nëse vlerëson se nevojiten të dhëna plotësuese që të miratohet aktvendimi për pagesë, Ministria do të kërkojë nga shoqata dhe klinikat ligjore në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të listës së harxhimeve, ndërsa në afat e paragrafit (5) të këtij neni, ndërpitet deri në ditën e pranimit të të dhënavë plotësuese të kërkua.

(7) Nëse nuk i merr të dhënat e kërkua nga shoqata dhe klinika ligjore në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesa për të dhënat plotësuese, Ministria në afat e paragrafit (5) të këtij neni, që vazhdon të rrjedhë do të miratojë aktvendim me të cilin nuk miratohet pagesa.

(8) Ministria do të miratojë aktvendim me të cilin nuk do të paguhet kompensimi nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse konstaton se ndihma juridike primare nuk është dhënë në pajtim me nenin 8 të këtij ligji.

(9) Kundër aktvendimeve të paragrafëve (5), (7) dhe (8) të këtij neni, shoqata dhe klinika ligjore mund të ngrenë kontest administrativ para gjykatës kompetente.

**Sekcioni 3****NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE****KREU I.****HARXHIME, SHTRIRJA DHE E DREJTA  
E NDIHMËS JURIDIKE DYTËSORE**

Neni 13

**Dispozita të përgjithshme**

(1) Ndhima juridike dytësore miratohet për personin i cili ka nevojë për ndihmë juridike dytësore nga avokati për punë konkrete juridike dhe që nuk ka mundësi t'i paguajë harxhimet e procedurës për shkak të gjendjes së tij financiare dhe kërkesa e të cilët është e arsyeshme.

(2) Ndhima dytësore juridike përfshinë përfaqësimin në procedurë para gjykatës, organit shtetëror, Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe personave të cilët kryejnë autorizime publike në pajtim me nenin 14 të këtij ligji, si dhe lirim nga harxhimet në pajtim me dispozitat e parapara me këtë dhe me ligj tjetër.

(3) Në procedurën e ndihmës juridike dytësore Ministria bashkëpunon me Odën e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejmë: Odën e Avokatëve), organet e jurisprudencës, si dhe me qendrën për punë sociale, organet shtetërore dhe institucionale tjera juridike të cilat në pajtim me ligjin janë të obliguara pa asnjë kompensim të Ministrisë të kryejnë dorëzimin e të dhënavë të nevojshme për sigurimin e ndihmës juridike dytësore në ç'rast të dhënat dorëzohen në pajtim me dispozitat përmbytjen e të dhënavë personale.

(4) Personi i autorizuar zyrtar për çdo kërkesë të dorëzuar veçmas për ndihmë juridike dytësore sjell vërtetim me të cilin kërkesa miratohet ose sjell akt si informatë publike me të cilin informohet kërkesi (në tekstin e mëtejmë: njofit) se kërkesa refuzohet.

(5) Me vërtetimin me të cilin miratohet ndihma juridike dytësore:

- autorizohet avokati i emëruar për dhëni e ndihmës juridike dytësore,
- lirohet shfrytëzuesi nga taksa gjyqësore dhe harxhime të ndërlidhura me procedurën para gjykatës në pajtim me ligjin,
- lirohet shfrytëzuesi nga harxhimet përmbytjen e të dhënavës së administrativë.

(6) Ekspertiza nga paragrafi (5) alineja 3 e këtij nenit, sigurohet përmes Byrosë së Ekspertizës Gjyqësore në pajtim me Ligjin përmbytje.

(7) Harxhimet për sigurimin e ndihmës juridike dytësore në pajtim me procedurat e parapara me këtë ligj sigurohen nga mjetet e Buxhetit të Ministrisë.

(8) Nëse shfrytëzuesi i ndihmës juridike dytësore ka sukses në kontest dhe gjykata e obligon anën e kundërt që t'i kompensojë harxhimet e procedurës plotësisht ose pjesërisht në pajtim me dispozitat e ligjit që e rregullojnë procedurën gjyqësore, në atë rast gjykata në shqiptimin e aktvendimit gjyqësor e obligon anën e kundërt që shumën e harxhimeve të procedurës ta paguajë në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Kreditor për arkëtimin e harxhimeve në procedurën e ekzekutimit të paragrafit (8) të këtij nenit në pajtim me Ligjin përmbytje shfrytëzuesi i ndihmës juridike dytësore në pajtim me këtë ligj nuk i përfshinë harxhimet të cilat shfrytëzuesi i ndihmës juridike dytësore në pajtim me këtë ligj nuk ka sukses në procedurën kontestimore.

(10) Ndhima juridike falas në pajtim me këtë ligj nuk i përfshinë harxhimet të cilat shfrytëzuesi i ndihmës juridike dytësore në pajtim me këtë ligj nuk ka sukses në procedurën kontestimore.

(11) Ndhima juridike dytësore i përshinë ato harxhime në procedurë që janë shkaktuar pas ditës së miratimit të kërkesës për ndarjen e ndihmës juridike falas.

**Neni 14  
Shtrirja e ndihmës juridike dytësore**

(1) Ndhima juridike dytësore miratohet për përfaqësimin në të gjitha shkallët në procedurë gjyqësore civile, procedura administrative dhe konteste administrative.

(2) Ndhima juridike dytësore miratohet për përfaqësimin në procedurën e debatit për trashëgimi para noterit nëse e njëjtë ka të bëjë me pronën e nenit 19 të këtij ligji.

(3) Ndhima juridike dytësore miratohet për përpilimin e parashtresave të debitorit para përmbaruesit kompetent, kur përmbarimi realizohet me shitjen e patundshmërisë të nenit 19 paragrafi (1) alineja 1 të këtij ligji dhe janë plotësuar kushtet përmbytje të miratimin e ndihmës juridike.

(4) Ndhima juridike dytësore nga paragrafi (1) i këtij nenit nuk miratohet në rastet e parapara me dispozitat e neneve 17 dhe 22 të këtij ligji.

**Neni 15  
Të drejtë për ndihmë juridike dytësore**

Të drejtë të dorëzim të kërkesës për ndihmën juridike dytësore ka:

- personi shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- shtetas i huaj me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose personi pa shtetësi i cili ligjërisht qëndron në Republikën e Maqedonisë së Veriut,

- personi i cili ka të drejtë për ndihmë juridike të siguruar nga Republika e Maqedonisë së Veriut në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

- kërkesat e të drejtës së azilit.

**Neni 16  
Kërkesa për ndihmë juridike dytësore**

(1) Procedura për ndihmën juridike dytësore fillon me paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga personi i interesuar në njësinë rajonale të Ministrisë që ndodhet në rajonin ku personi ka vendbanim ose vendqëndrim.

(2) Kërkesa parashtron personalisht, përmes postës ose përmes shoqatës së autorizuar.

(3) Personi plotëson dhe paraqet kërkesë të veçantë për ndihmë juridike dytësore për secilën çështje juridike individualisht për zgjidhjen e së cilës dëshiron të ngrejë procedurë në pajtim me nenin 14 të këtij ligji.

(4) Formularin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore nga paragrafi (1) të këtij nenit e përcakton ministri.

(5) Ministria, shoqata dhe klinika ligjore personit të interesuar i ndihmojnë në plotësimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore në pajtim me dispozitat e nenit 8 të këtij ligji.

(6) Personi është i detyruar të jepë të dhëna të sakta për çështjen juridike për të cilën kërkon ndihmë juridike dytësore, për gjendjen e tij financiare dhe gjendjen financiare të anëtarëve të familjes me të cilët jeton, si dhe të dorëzojë kopje të dokumenteve që e vërtetojnë të dhënat e theksuara në kërkesën për ndihmën juridike dytësore, si dhe kopjet nga dokumentet të cilat Ministria nuk mund t'i sigurojë sipas detyrës zyrtare, kurse të cilat kanë të bëjnë me çështjen juridike në pajtim me ligjin.

(7) Personat nga nenii 15 tē kētij ligji kanē tē drejtē tē paraqesin kērkesë pēr ndihmē juridike dytēsore nē cilēndo fazē tē procedurēs pēr udhēheqjen e secilēs kanē nevojē pēr ndihmēn juridike dytēsore.

(8) Procedura pēr kērkesën pēr ndihmē juridike dytēsore eshtē urgjente.

**KREU II.  
KUSHTET PĒR MIRATIMIN E NDIHMĒS  
JURIDIKE DYTĒSORE**

Neni 17

**Kushtet e pērgjithshme pēr miratimin e ndihmēs  
juridike dytēsore**

(1) Kērkuesi i ndihmēs juridiike dytēsore (nē tekstin e mētejmē: kērkuesi) ka tē drejtē tē marrē ndihmē juridiike dytēsore, nēse pēr shkak tē gjendjes sē tij financiare nuk mund t'i realizojē me Kushtetutēn e Republikēs sē Maqedonisē sē Veriut dhe me ligi tē drejtat e garantuara, pa e rrezikuar mbajtjen e tij dhe mbajtjen e anētarēve tē familjes sē tij me tē cilēt jeton nē ekonomi familjare tē pērbashkēt.

(2) Gjendja financiare e kērkuesit dhe anētarēve tē familjes sē tij pērcaktohet nē bazē tē deklaratēs me shkrim tē gjendjes financiare (nē tekstin e mētejmē: deklaratē) e dhēnē nga kērkuesi i ndihmēs juridiike qē eshtē pjesē e kērkuesēs pēr ndihmē juridiike dytēsore.

(3) Kērkuesit i miratoher ndihma juridiike dytēsore nēse:

- i plotēson kushtet pēr tē hyra dhe pronē tē parashikuara me nenin 18 dhe nenin 19 nga ky ligi ose
- i plotēson kushtet e parashikuara si pērjashtim pēr miratimin e ndihmēs juridiike nga nenii 20 tē kētij ligi.

(4) Kērkuesit do t'i miratoher ndihmē juridiike dytēsore nēse krahas kushtete nga paragrafi (3) tē kētij neni, kērkesa pēr ndihmē juridiike dytēsore eshtē e arsyeshme nē pajtim me nenin 21 tē kētij ligi.

(5) Nēse nē deklaratēs me shkrim pēr gjendjen financiare, parashtruesi i kērkuesēs paraqet tē dhēna tē pasakta pēr gjendjen e tij financiare ose gjendjen financiare tē anētarēve tē familjes sē tij me qēllim qē t'i jepet ndihmē juridiike dytēsore, kērkesa pēr ndihmē juridiike dytēsore tē refuzohet, kurse parashtruesi i kērkuesit nuk do tē mund tē paraqesē kērkuesē tē re pēr ndihmē juridiike dytēsore para kalimit tē 12 muajve nga dita e marrjes sē aktvendimit.

(6) Gjatē pērcaktimit tē gjendjes financiare tē parashtruesit tē kērkuesēs dhe anētarēve tē familjes sē tij, nuk merren parasysh tē ardhurat dhe prona e atyre anētarēve tē familjes qē paraqiten si palē kundērshtare nē procedurēn pēr zgjidhjen e sē cilēs kērkuesi parashtron kērkese pēr ndihmē juridiike dytēsore.

Neni 18

**Kushtet pēr tē hyra tē kērkuesit**

(1) Konsiderohet se gjendja financiare e parashtruesit tē kērkuesēs dhe anētarēve tē familjes sē tij eshtē rrezikuar me shpenzimet e procedurēs nēse:

- tē ardhurat mujore tē kērkuesit i cili jeton vetēm nuk e tejkalon shumēn e rrogēs neto minimale nē Republikēn e Maqedonisē sē Veriut, tē pērcaktuar me dispozitat nga fusha e rrogēs minimale,

- tē ardhurat mujore tē kērkuesit qē jeton nē familje tē pērbashkēt me anētarēt e familjes sē tij nuk e tejkalon shumēn e rrogēs minimale neto nga paragrafi (1), alineja 1 tē kētij neni, dhe tē ardhurat mujore tē secilit anētar tē familjes tjetër nuk e tejkalon shumēn prej 20% tē rrogēs neto minimale tē pērcaktuar me dispozitat nē fushēn e rrogēs minimale,

(2) Si tē ardhura mujore tē kērkuesit tē ndihmēs juridiike dhe anētarēve tē familjes sē tij konsiderohen:

- neto rroga,
- pensioni i realizuar nē Republikēn e Maqedonisē sē Veriut ose jashtē vendit,
- kompensimi me para nē bazē tē papunēsisē,
- tē hyra tē paraqitura ose realizuara neto nē Drejtorinē e tē Hyrave Publike,
- tē ardhura nga pērkrahja financiare nga sfera e bujqësia dhe zhvillimit rural qē janē realizuar nē vitin paraprak,

- pagesē invaliditeti ushtarak ose civil,
- tē hyra nga puna e pērkohshme jashtē vendit;
- tē hyra tē realizuara nga instrumente financiare;
- tē hyra nga prona
- mjete parash tek bartesi i qarkullimit pagesor,
- mbajtje ligjore dhe

- dhurata pēr tē cilat obliguesit tatimorē janē tē detyruar tē paguajnē tatim tēmbli tē ardhura nga veprimtari nē pajtim me dispozitat e Ligjit pēr tatim mbi tē ardhura.

(3) Si tē hyra nga paragrafi (2) tē kētij neni, nuk konsiderohen:

- kompensim parash pēr ndihmē dhe kujdes nga person tjetër,

- shtesē prindērore pēr fēmijē,
- shtesē fēmijērōre dhe shtesē e veçantē,
- kompensim pēr dēmtim trupor,
- ndihmē sociale nē para,
- ndihmē e pērhershme nē para
- ndihmē e njëhershme dhe ndihmē nē naturē,
- kompensim nē para pēr shpenzimet e personit tē akomoduar dhe kompensim pēr kujdesin e personit nē familje pērkujdesēse,

- ndihmē financiare tē njëhershme pēr tē porsalindur,

- mbajtje ligjore pēr fēmijē qē harmonizohet me rritjen e shpenzimeve pēr jetesē pēr vitin paraprak, tē publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës, nē janar pēr vitin rrijedhës,

- ndihmē me para pēr banim social,

- kompensimi pēr regjistrues pēr kryerjen e aktiviteteve lidhur me zbatimin e regjistrimit tē popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave nē Republikēn e Maqedonisē sē Veriut tē bartesit dhe anētarēve tē ekonomisë familjare,

- bursē,

- mjetet e miratuara nga institucioni kompetent pēr mijekim jashtē vendit;

- shtesē pēr shurdhëri,

- shtesē pēr verbëri dhe mobilitet,

- kompensim i pagës pēr punën me kohë tē shkurtuar

pēr shkak tē kujdesit tē fēmijës me pengesa trupore ose mentale dhe

- ndihmē me para tē personit qē deri nē moshën 18 vjeçare ka pasur status tē fēmijës pa prindër dhe kujdes prindëror.

(4) Gjatē pērcaktimit tē tē ardhurave si bazē pēr miratimin e ndihmēs juridiike dytēsore tē merren parasysh tē ardhurat neto mujore dhe tē hyrat tē pērmendura nē paragrafin (2) tē kētij neni, qē i ka marrē kērkuesi i ndihmēs juridiike dhe anētarët e familjes sē tij me tē cilēt jeton nē familje tē pērbashkēt nē gjashtë muajt e fundit para paraqitjessë kērkuesēs pēr ndihmē juridiike dytēsore.

(5) Nēse tē ardhurat nuk mund tē pērcaktohen nē pajtim me paragrafin (4) tē kētij neni, pēr shkak tē tē ardhurave tē parregullta mujore tē kērkuesit dhe anētarëve tē familjes sē tij, atëherë llogariten tē ardhurat e pērkohshme pēr periudhën prej 12 muajsh para muajt nē tē cilin eshtë parashtruar kērkesa pēr ndihmē juridiike dytēsore.

**Neni 19  
Kushtet pēr pronēn e kērkuesit**

(1) Ndihma juridiike dytēsore do t'i jepet miratoher parashtruesit tē kērkuesēs, nēse nē bazē tē deklaratēs sē paraqitur pēr gjendjen financiare tē kērkuesit dhe anētarëve tē familjes sē tij, pērcaktohet se:

- Kerkuesi i ndihmës juridike dhe anëtarët e familjes së tij kanë në pronësi vetëm objekt një banesor ose banesë si pjesë e veçantë e ndërtuesës në të cilën jetojnë,

- krahas pronës të theksuar në alinenë 1 të këtij paragrafi, kerkuesi dhe anëtarët e familjes së tij kanë një ose më shumë parcela kadastrale të lidhura fizikisht me sipërfaqe të përgjithshme jo më madhe se 300 m<sup>2</sup> në qytetin e Shkupit ose 500 m<sup>2</sup> në komunat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, respektivisht një ose më shumë parcela kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme jo më të madhe se 5000 m<sup>2</sup> në mjediset rurale dhe

- kerkuesi i ndihmës juridike dhe anëtarët e familjes së tij kanë vetëm një automjet motorik të regjistruar kapaciteti i motorit të cilil nuk është më e madhe se 1 200 centimetër kub.

(2) Si pronë në kuptim të këtij ligji nuk do të konsiderohen:

- sendet të cilat në pajtim me Ligjin për përbarim, janë përjashtuar nga përbarimi,

- të ardhurat nga prona që sipas këtij ligji merren parasysh gjatë përcaktimit të të ardhurave të kerkuesit të ndihmës juridike ose anëtarëve të familjes së tij.

- automjeti motorik i regjistruar të cilin kerkuesi e shfrytëzon për transport të personit invalid anëtar të ekonomisë familjare dhe

- toka natyrore jopjellore (gurore, lugina dhe tjera), si dhe livadhe, kulloza, kallamishte dhe moçale të klasës 5, 6, 7 dhe 8, në pajtim me Ligjin për kadastër të patundshmërive.

Neni 20

### Miratimi i ndihmës juridike dytësore pa përcaktimin e gjendjes financiare

(1) Me përjashtim të nenit 18 dhe nenit 19 të këtij ligji, ndihma juridike dytësore do të miratohet pa përcaktuar gjendjen financiare të parashtruesit të kerkuesës dhe anëtarëve të familjes së tij nëse:

- kerkuesi është i vendosur në familje përkujdesëse, njësia banimi për jetesë të organizuar me mbështetje ose në institucion për mbrojtje sociale, me vendim të Qendrës për Punë Sociale (në tekstin e mëtejmë: rrëthana të veçanta),

- kerkuesi ka nevojë për ngritje dhe përfaqësim në procedurën për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna në familje para gjykatës kompetente, ose

- kerkuesi, për shkak të fatkeqësisë elementare, të fuqisë madhore ose rrëthanave të tjera që janë jashtë kontrollit të tij gjendet në situatë financiare që e pengon atë të sigurojë në mënyrë të pavarur mbrojtjen e të drejtave të tij.

(2) Në rastin nga paragrafi (1) alineja 2 dhe 3 të këtij neni, ndihma juridike dytësore do të miratohet vetëm nëse parashtruesi i kerkuesës do të paraqesë vërtetim që është evidentuar si viktimi e dhunës në familje, respektivisht dokumentacion nga organ kompetent se papritur u gjet në pozicionin financiar e cila ka ndodhur në gjashtë muajt e fundit para parashtrimit të kerkuesës për ndihmë juridike dytësore dhe nëse puna juridike për të cilën kërkon ndihmë juridike dytësore dhe nëse çështja juridike për të cilën kërkohet ndihmë juridike dytësore është e lidhur me faktin se parashtruesi i kerkuesës së ndihmë juridike dytësore është gjetur në gjendje e cila e ka penguar të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të tij.

Neni 21

### Arsyeshmëria e kerkuesës

(1) Gjatë vlerësimit nëse do të miratohet ndihma juridike dytësore, krahas kushteve të neneve 18 dhe 19, respektivisht 20 të këtij ligji, është e nevojshme të përcaktohet nëse kerkesa është e arsyeshme.

(2) Kerkesa do të konsiderohet e paarsyeshme në rastet si vijojnë:

- kur shihet qartë se kerkesa e kerkuesit është e pabazuar për shkak të mungesës së faktave juridike në bazë të të cilave mund të ndërmerrin veprime juridike,

- kur bëhet fjalë për keqpërdorim të dukshëm të së drejtës për ndihmë juridike falas,

- çështja juridike për të cilën është kerkuar ndihma juridike është dukshëm e paarsyeshme,

- nëse pritshmëritë dhe kerkesat e kerkuesit padyshim janë në kundërshtim me rezultatet në çështje me gjendje faktike të njëjtë apo të ngashme për çështjet e njëjtë juridike dhe

- kur kerkesat e kerkuesit janë në kundërshtim me moralin.

Neni 22

### Baza për refuzimin e ndihmës juridike dytësore

Kerkesa për ndihmë juridike dytësore do të refuzohet nëse:

- kerkuesi nuk hyn në kategoritë e parashikuara në nenin 15 të këtij ligji,

- çështja juridike për të cilën kërkohet ndihma juridike nuk është paraparë si çështje juridike për të cilën miratohet ndihma juridike në përputhje me këtë ligj,

- kerkesa nuk është e arsyeshme në pajtim me nenin 21 të këtij ligji,

- kerkuesi nuk ka paraqitur kerkesën për ndihmë juridike dytësore në kohën e duhur në pajtim me nenin 25 paragrafi (5) të këtij ligji,

- organi kompetent për zgjidhjen e çështjes konkrete juridike ka ndihmuar kerkuesin dhe ka theksuar mundësitet për zgjidhjen e të njëjtës, ia ka përgatitur dokumentet e nevojshme për mbrojtje ose i ka ofruar ndihmë në mënyrë tjetër që tregon se ndihma juridike dytësore nuk është më e nevojshme,

- kerkuesi paraprakisht ka realizuar të drejtën për ndihmë juridike dytësore dhe më pas me aktvendim të Ministrisë ka qenë i detyruar t'i paguajë shpenzimet lidhur me ndihmën juridike dytësore të pajustifikuar, por nuk e ka bërë këtë në afatin e paraparë dhe shumë,

- ka të bëjë me punët doganore dhe tatimore,

- ka të bëjë me kerkesën për ofendim dhe shpifje,

- ka të bëjë për kompensim të dëmit jo material, përvëç në rastet për viktima të veprave penale, si dhe në rast të vdekjes ose invaliditeti të rëndë në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhënie obligative,

- ka të bëjë me kundërvajtjet,

- i referohet shërbimeve publike dhe komunale të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe Ligjin për veprimtarit komunale,

- shpenzimet për dhëni e ndihmës juridike janë joproportionalisht të larta në krahësim me vlerën e kontestit,

- nuk kanë kaluar gjashtë muaj nga dita e miratimit të aktvendimit për ndërprerjen e dhëni së ndihmës juridike për kerkuesin e ndihmës juridike në pajtim me nenin 26, paragrafi 1, alineja 4 e këtij ligji,

- nuk kanë kaluar 12 muaj nga dita e miratimit të aktvendimit për ndërprerjen e dhëni së ndihmës juridike për kerkuesin të ndihmës juridike në pajtim me nenin 26, paragrafi 1, alineja 7 e këtij ligji,

- avokati ka dorëzuar mendim të arsyetuar se nuk është pa rezultat vazhdimi i procedurës për të cilën është aprovar më parë ndihma juridike dytësore, e cila i referohet çështjes së njëjtë juridike dhe bazës juridike, ose

- çështje pronësore në procedurë administrative.

## KREU III.

## PROCEDURA PËR KËRKESËN PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE

Neni 23  
Procedura për shqyrtimin e kërkesës

(1) Personi i autorizuar zyrtar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës është i detyruar:

- t'i marrë të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin nëse kërkesë i plotëson kushtet për aprovimin e ndihmës juridike dytësore të përcaktuar në Seksionin 3 kreu II të këtij ligji,

- të shqyrtojë dhe të përcaktojë nëse kërkesë i plotëson kushtet për miratimin e ndihmës juridike dytësore të përcaktuar në Seksionin 3 kreu II të këtij ligji dhe

- të përgatitë vërtetim me të cilin miratohet ose njoftim me të cilin refuzohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe

- ta organizojë takimin e parë ndërmjet avokatit dhe shfrytëzuesit të ndihmës juridike dytësore dhe datën e mbajtjes ta theksojë në vërtetim.

(2) Personi i autorizuar zyrtar kryen kontroll të të dhënavë të dhëna në deklaratën me shkrim për gjendjen financiare të kërkesës dhe anëtarëve të familjes së tij tek organet kompetente që disponojnë me të dhënat për të ardhurat dhe pronën e personave fizikë. Nëse personi i autorizuar zyrtar konstaton se janë të nevojshme të dhëna shtesë, në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, do të kërkojë të dhëna shtesë nga kërkesë i ndihmës juridike dytësore në pajtim me ligjin.

(3) Kërkimi i të dhënavë nga paragrafi (2) të këtij neni, e ndërtet afatin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, deri në ditën e pranimit të të dhënavë të kërkuara.

(4) Nëse, kërkesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për të dhëna shtesë nga paragrafi (2) të këtij neni, të njëjtat nuk i dorëzon, në afatin nga paragrafi (1) të këtij neni, i cili vazhdon të rrjedhë, personi i autorizuar zyrtar do të sjellë njoftim me të cilin kërkesa për ndihmë juridike dytësore refuzohet.

(5) Organet kompetente që disponojnë të dhëna për të ardhurat dhe pronën e kërkesës të ndihmës juridike dytësore dhe anëtarët e familjes së tij, në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, janë të detyruar t'i dorëzojnë të dhënat e kërkuara në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënavë personale paprolongim, kurse më së voni në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për të dhëna.

(6) Vërtetimi me të cilin miratohet, respektivisht njoftimi me të cilin refuzohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore dorëzohet te kërkesi.

(7) Vërtetimi me të cilin miratohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore dorëzohet edhe te avokati.

(8) Kërkesë mund të paraqesë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit, te Ministria kundër njoftimit me të cilin nuk miratohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore.

(9) Nëse ndodhin ndryshime thelbësore në gjendjen financiare, kërkesë mund përsëri të paraqesë kërkesë për ndihmë juridike dytësore për të njëjtën çështje juridike dhe në të njëjtat baza juridike për të cilat personi i autorizuar zyrtar ka miratuar njoftim me të cilin e refuzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore, përvëç kur kërkesë nuk i ka dorëzuar të dhënat shtesë në kohë në afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni.

(10) Kërkesa për ndihmë juridike dytësore nuk do të shqyrtohet, nëse:

- kërkesë jep deklaratë me shkrim se e tërheq kërkesën e paraqitur për ndihmë juridike dytësore, për të cilën personi i autorizuar zyrtar do ta njoftojë kërkesën se nuk do ta shqyrtojë kërkesën e tij ose

- konstatohet se kërkesi ka vdekur pas parashtrimit të kërkesës.

(11) Ministria mban evidencë për të dhënat që kanë të bëjnë me zgjidhjen e kërkesave të parashtruara për ndihmë juridike dytësore.

(12) Personi i autorizuar zyrtar për të dhënat që kanë të bëjnë në zgjidhjen e kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike dytësore është i detyruar të përgatisë raporte në çdo gjashtë muaj.

(13) Ministri i Drejtësisë i përcakton përbajtjen, formën dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për të dhënat në lidhje me zgjidhjen e kërkesave të paraqitura për ndihmë juridike si dhe përbajtjen e raporteve nga paragrafi (12) të këtij neni.

(14) Ministri i Drejtësisë e përcakton mënyrën e veprimit për kërkesën për ndihmë juridike dytësore.

Neni 24  
Procedura për kundërshtim në Ministri

(1) Nëse është parashtruar kundërshtim kundër njoftimit për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, Ministria është e obliguar ta vlerësojë kundërshtimin dhe pa vonesë, dhe më së voni brenda afatit prej dhjetë ditëve nga dita e marrjes së kundërshtimit, të miratojë vendim për miratim ose refuzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore që ia paraqet kërkesët në përpunje me dispozitat e parashikuara në Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(2) Aktvendimi me të cilin miratohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore i dërgohet edhe avokatit.

(3) Kundër aktvendimit të Ministrisë që e refuzon kërkesën për ndihmë juridike dytësore kërkesë mund të ngrejë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(4) Nëse ndodhin ndryshime thelbësore në gjendjen financiare, kërkesë mund të paraqesë përsëri kërkesë për ndihmë juridike dytësore në të njëjtën çështje juridike dhe për të njëjtën baza ligjore për të cilën Ministria ka miratuar aktvendim për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, përvëç kur kërkesë nuk i ka dorëzuar të dhëna shtesë në kohë në afatin e përcaktuar në nenin 23 paragrafi (4) të këtij ligji.

(5) Procedura në gjykatën kompetente nga paragrafi (3) I këtij neni është urgjente.

Neni 25  
Procedura urgjente për kërkesën për ndihmë juridike dytësore

(1) Nëse nga kërkesa për ndihmë juridike dytësore dë dokumentacioni i paraqitur përcaktohet se ka nevojë urgjente për dhienin e ndihmës juridike ose për veprimet për punë juridike konkrete janë përcaktuar afate të shkurtra nga gjykata ose organi tjetër kompetent, përkatësisht ligj, atëherë në afat prej dy ditëve nga dita e marrjes së kërkesës e njëjtë miratohet, duke i marrë parasysh dispozitat nga nenet 21 dhe 22 të këtij ligji, si dhe deklaratën mbi gjendjen financiare të kërkesës pa e kontrolluar atë me autoritetet kompetente.

(2) Vërtetimi me të cilin miratohet kërkesa për ndihmë juridike dytësore i dorëzohet kërkesit.

(3) Vërtetimi nga paragrafi (2) i këtij neni i paraqitet edhe avokatit.

(4) Afate të shkurtra nga paragrafi (1) i këtij neni do të konsiderohen afatet e përcaktuara nga gjykatat ose organet e tjera kompetente, përkatësisht ligj që nuk janë më të gjata se 15 ditë nga momenti kur afati fillon të rrjedhë.

(5) Kërkesë në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar kërkesën ta paraqesë i njëjtë, përkatësisht jo më vonë se dy ditë nga dita kur ka kuptuar për afatin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Pas miratimit të vërtetimit për aprovimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, personi i autorizuar zyrtarështë i detyruar të shqyrtojë dhe të përcaktojë, në afat prej 15 ditëve, nëse kërkuesi plotëson kushtet për dhënien e ndihmës në pajtim me nenin 18 dhe nenin 19 të këtij ligji.

(7) Nëse personi zyrtar i autorizuar konstaton se kërkuesi nuk i plotëson kushtet për dhënien e ndihmës juridike dytësore do të veprojë në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

Neni 26

### **Ndërprerja e ndihmës juridike dytësore të miratuar**

(1) Ministria do të miratojë aktvendim me të cilin ndërpritet ndihma juridike dytësore në rastet e mëposhtme:

- me kërkësë të shfrytëzuesit;

- kur përdoruesi i ndihmës juridike ka vdekur, përvëç nëse të gjithë anëtarët e familjes së tij me të cilët ka jetuar në një familje të përbashkët plotësojnë kushtet për aprovimin e ndihmës juridike dytësore dhe kanë interes juridik në zgjidhjen e çështjes juridike, janë të gatshëm të vazhdojnë procedurën në të cilën eshtë miratuar ndihma juridike dhe nëse eshtë një çështje ligjore që mund të trashëgohet, ndërsa për të hyrë në vendin e përdoruesit në procedurë e informojnë Ministrinë brenda 15 ditëve nga dita e vdekjes së përdoruesit;

- nëse avokati dorëzon mendim të arsyetuar se eshtë e papranueshme të sigurohet ndihma e mëtejme juridike dytësore;

- kur shfrytëzuesi për shkaqe të paarsyeshme dhe në vazhdimësi nuk takohet me avokatin në kohën dhe vendin e caktuar paraprakisht dhe për këtë nuk e ka njoftuar avokatin ose refuzon të bashkëpunojë në procesin e marrjes së ndihmës juridike dytësore ose në procesin e dhënies së ndihmës juridike dytësore;

- nëse vërtetohet se shfrytëzuesi pas miratimit të vendimit për dhënien e ndihmës juridike dytësore nuk i plotëson më kushtet për aprovimin e ndihmës juridike dytësore të përcaktuar me seksionin 3, kapitullin II të këtij ligji;

- nëse vërtetohet se shpenzimet e ndihmës juridike dytësore të miratuar janë në mënyrë të pabarabartë më të larta në krahasim me vlerën e kontestit ose

- nëse gjatë periudhës së përdorimit të ndihmës juridike dytësore konstatohet se përdoruesi ka dhënë të dhëna të rreme për të marrë ndihmë juridike dytësore.

(2) Ministria për rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, ka të drejtë nëse konstaton se eshtë e nevojshme të kërkohen të dhëna shtesë.

(3) Ministria ia dorëzon aktvendimin për ndërprerjen e ndihmës juridike dytësore shfrytëzuesit dhe avokatit të caktuar.

(4) Kundër vendimit të Ministrisë për ndërprerjen e përdorimit të ndihmës juridike dytësore shfrytëzuesi mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(5) Procedura në gjykatën kompetente nga paragrafi (4) i këtij neni eshtë urgjente.

Neni 27

### **Kompensimi i mjetave të paguara për ndihmë juridike dytësore të fituar në mënyrë të paarsyeshme**

(1) Personi të cilit i eshtë siguruar dhe e ka shfrytëzuar ndihmën juridike dytësore ka për obligim plotësisht t'i kompensojë mjetet e paguara për ndihmën juridike dytësore të fituar në mënyrë të pabazuar në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse:

- ka dhënë të dhëna të rrëshme me qëllim që të marrë ndihmë juridike dytësore ose

- nuk i ka respektuar obligimet nga neni 28 i këtij ligji.

(2) Ministria pas përcaktimit të ekzistimit të ndonjë nga shkaqet nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 30 ditësh nga dita e përcaktimit të tyre do të miratojë aktvendim për kompensim të shpenzimeve të paguara për ndihmë juridike dytësore të fituar në mënyrë të paarsyeshme.

(3) Në aktvendimin nga paragrafi (2) i këtij neni, Ministria do ta theksojë shumën të cilën shfrytëzuesi duhet ta paguajë dhe llogarinë në të cilën mjetet duhet të paguhen.

